

ETIKA

Revistë edukative-kulturore

Shqipëri: 150 Lek

Kosovë: 1 Euro

Maqedoni: 60 Den

Europa: 2 Euro

Maj 2010 • Numri: 26 • E përmuajshme

MES frikës dhe shpresës



EDITORIAL

...dhe nuk munda, nuk doja të ndahesha nga ai takim aq i afërt! E ndjeva të më ngjitej me këmbëgulje në hojëzat e mushkërive një aromë që e njihja para se të isha ngjizur njeri. Nuk doja të ndahesha prej atje...nuk munda...! Mu aty për herë të parë mu bashkuan dy gjysma të një së tërë..., mu aty për herë të parë ndjeva të më rrihte një zemër e plotë! Mu aty, më pranë se asnjëherë Zotit tim, putha me mall kokërriza rëre...dhe Zotin e kam dëshmitar; mu aty për herë të parë dëshirova të jem një kokërrizë rëre që pati puthur gjurmën Tënde!

Sa më kishtë marrë malli...

Sot diçka ndryshe e ndjeva të më digjte vaji në grykë, e kuptova se nuk mund të quhem ndryshe veçse një fukara që pret t'i falin një sexhadë të shtrirë në tokën Tënde, një sexhadë që mbart ato kokërriza krenare rëre që të patën puthur këmbët...Dhe sot diçka ndryshe të ndjeva në brendësi-në time të varfër...

Ardhja Jote pati ftuar ecejaket e beharit...dhe dielli për të parën herë ngrohu si ylli më i madh, atë ditë kur erdhe Ti... Ka kaq shekuj që ngrohemi me rrezatime të akullta, sepse Ti ke ikur, e nga pas të ndoqi behari që solle atë muaj prill...

O Behar i jetës sime! Që atëherë dielli na rrezaton ftohtësi!

O "Ah" i shpirtit tim!

E kuptova pse Ti nuk e zbukuron madhërueshëm gjumin e gjithsecilit, se je aq i pastër! Dhe mos eja, mos eja në ëndrrën time, mos eja! Deri atëherë kur sytë e mi të bëhen të denjë për nurin Tënd; Ti mos eja!

O shpëtimtar i dy botërave të mia! Sot, qava nga malli për Ty, për sytë e tu të pagjumë, për këmbët tua që enjtëshin ndërsa Ti kërkoje të ishim umeti yt; qava pët lotët e tu ndërsa ti përgjërroheshe që ne të ishim të falur...

O melodi e harmonisë sime! Sot vrapova pas ca tingujve të dashuruar me Ty dhe dëshirova të isha pjellë e një kallamishteje...

Ëndërrova tek më prisnin trupin e qullët, ndjeva të thahesha nën diell, të shpohesha me hekur të skuqur...

Ëndërrova të isha fyell, të puthja buzët e një artisti...e fryma e atij që më përkëdhelte brendësi-në të përkthente dashurinë time duke të dhuruar qindra selame...

Do të lexoni:



- Ahmet Tashgetiren / 4** Midis frikës dhe shpresës
- Prof. dr. Metin Izeti / 8** Qasje religjioze religjionit
- Harun Jahja / 12** Rrëfenja e Ademit (a.s.) në Kuran
- Nexhat Ibrahimimi / 14** Nyja e ndërmjetësimit në Islam
- Hivzi Zeqiri / 18** Njeriu ndërmjet frikës dhe shpresës
- Mr. Zymer Ramadani / 20** Rëndësia dhe roli i duasë në jetën e përditshme
- Xhafer Durmush / 24** Çdo shtëpi është një fole virtutyti
- Abdullah Hoxhiq / 26** Urat e jo muret
- Verzana Nikshiqi / 29** ...Shkëputur ditarit
- /30** Një ajet

4

Ahmet Tashgetiren /
Midis frikës dhe shpresës



12

Harun Jahja /
Rrëfenja e Ademit (a.s.) në Kuran



20

Mr. Zymer Ramadani /
Rëndësia dhe roli i duasë në jetën e përditshme



Viti: V | Numri: 26 | Maj 2010

Administrator i Progresi botime:

Shuaqip Bashhan
bashan43@hotmail.com
+355 69 20 76768

Drejtor & Kryeredaktor:

Alban Kali
albankali@yahoo.com
+355 69 24 23989

Përkthyesit:

Adelina Muça / Alban Kali
Elona Sytari / Evans Drishti
Fatmir Hadri / Fatmir Sulaj / Ilir Hoxha

Redaktor letrar:

Shpëtim Kelmendi

Redaktor gjuhësor:

Ma. Irida Hoti

Dizajn - Grafik:

Bledar Xama
bledar_xama@hotmail.com

Për artikuj

e-mail: revistaetika@progresibotime.com
e-mail: kosova@progresibotime.com
e-mail: maqedoni@progresibotime.com

32

Osman Nuri Topbash /
Parimet e moralit të lartë -2-



42

Naim Drijaj /
Frika ndaj Allahut xh.sh.



52

Familja /
Profeti dhe nipërit e tij



/31 Një hadith

Osman Nuri Topbash /32 Parimet e moralit të lartë -2-

Mr. sci. Flamur Sofiu /38 Njohja e të ndaluarës dhe të lejuarës është çështje e domosdoshme në Islam

Naim Drijaj /42 Frika ndaj Allahut xh.sh.

Muhamed Sytari /44 Haxhi Faik Hoxha një jetë plot besim e përkushtim

Ilir Rruga / 46 Historia e djaloshit trim që dëshironte të bënte një tatuazh

Mr. Abas Jahja /48 Veglat muzikore në Islam dhe ndikimi i tyre në muzikën perëndimore

Mag. Ermal Nurja / 50 Ditari i Daut Boriçit

Familja / 52 Profeti dhe nipërit e tij

Teknologji / 54 Photoshop mbush 20 vjet

Shëndeti / 56 Peshku mbron diabetikët nga dëmtimet në veshka

Aktualitet / 58 Maqedoni, propozohet që zv. Presidenti të jetë shqiptar



Midis frikës dhe shpresës

Ahmet Tashqetiren

Allahu Teala, në Kuranin Famëllartë urdhëron: *“Pa dyshim, miqtë e Allahut nuk do të kenë arsye për t’u frikësuar dhe as për t’u dëshpëruar. (Të tillë janë) ata që besojnë dhe që (i) frikësohen (Allahut). Ata i pret lajmi i mirë në këtë jetë dhe në tjetrën. S’ka ndryshim në fjalët e Allahut; kjo është fitorja madhështore.”* (Junus 10/62-64) Pra, për miqtë e Allahut ka **“sukses të madh”**. S’ka hidhërim dhe as frikë. Ky është premtimi hyjnor dhe në premtimin e Allahut nuk ka kurrfarë dredhie.

Mirëpo, kur lexojmë përsëri në Kuranin Famëllartë dhe veçanërisht ajetin që gjendet më përpara: **“Nuk ka frikë për miqtë e Allahut”**, pra ajetin: **“(Ata janë) Të cilët besuan dhe ishin të ruajtur”**, (Junus 10/63) vërejmë se

miqtë e Allahut janë përshkruar dhe dalluar me cilësitë e **“Besimit dhe Devotshmërisë”**. Fjalës **“Devotshmëri”** pranë kuptimit **“Frikë ndaj Allahut”**, i është dhënë edhe kuptimi **“Ndjenja e frikës për humbjen e dashurisë së Allahut dhe respekti i thellë për Allahun”**.

Në Kuran ka shumë ajete të ngjashme me këto. Pra, të mirat si: **“Shpëtimi në botën tjetër dhe dhurata e xhennetit si pasojë e fitimit të kënaqësisë së Allahut”** janë përmendur gjithmonë bashkë me **“Devotshmërinë dhe frikën ndaj Allahut”**. Le t’i lexojmë këto ajete parë nga ky këndvështrim:

“... Allahu është i kënaqur ndaj tyre, dhe ata janë të kënaqur prej Tij. E kjo është për atë, që i ka pasur frikën

Zotit të vet.” (Bejjine 98/8)

“O njerëz! Frikësojuni Zotit tuaj dhe frikësojuni Dytës, kur prindi nuk do të mund ta ndihmojë aspak fëmijën e vet, e as fëmija nuk do të mund ta ndihmojë sado pak prindin e vet! Premtimi i Allahut është vërtet i sigurt, prandaj mos e lini jetën e kësaj bote t’ju mashtrojë dhe as djallin mos e lini t’ju mashtrojë për Allahun.” (Lukman 31/33)

“Me të vërtetë, ata që dridhen nga frika e Zotit të tyre, që besojnë në shpalljet e Zotit të tyre, që nuk i shoqërojnë asgjë (në adhurim) Zotit të tyre, dhe që, kur japin atë që japin, zemrat e tyre i kanë plot frikë, ngaqë do të kthehen te Zoti i tyre, ata nxitojnë të bëjnë vepra të mira dhe për këto punë janë të parët.” (El-Mu’minun 23/57-61)

“...e kush rubet dhe përmirësohet, për ta s’ka as frikë dhe ata s’kanë përse të pikëllohen.” (El-Araf 7/35)

“Ata që thanë: Allahu është Zoti ynë dhe qëndruan besnikërisht, për ta nuk ka frikë dhe ata nuk do të pikëllohen.” (El-Ahkaf 46/13)

“...e kush besoi dhe u përmirësua, ata nuk kanë as frikë as brengë.” (El-En’am 6/48)

Ata që i lexojnë ashtu siç duhet këto ajete, kanë arritur në përfundimin se, për të arritur kënaqësinë e Zotit, për të arritur qetësinë dhe gëzimin e pafund, duhet që në këtë botë të ndjesh një farë frike, rrëqethje zemre dhe duhet të jesh i mbushur me devotshmëri.

Kësaj i është shtuar edhe dimensionin e **“Dashurisë për Allahun”**.

Më vonë ka hyrë në skenë dhe **“Dashuria e Allahut ndaj robit të Tij”**... (Juhibbuhum dhe juhubbuhuneh...)

Pastaj vjen lajmi se **“Allahu ia ka ngjeshur mëshirën vetvetes”**.

Më vonë vjen lajmi se **“...vetëm populli jobesimtar e humb shpresën në Allahun”**. (El-Jusuf 12/87)

Pastaj birit të njeriut i arrin lajmi, **“...dhe luteni Atë duke pasur frikë (dënimin) dhe duke shpresuar (mëshirën)”**.


Thirrje për dashuri, respekt, frikë, shpresë, mëshirë... Të gjitha janë grumbulluar.

Dhe nga kjo ka dalë një ndjesi jetësore që bën pjesë në lavjerrësin e **“Hauf dhe Reca - Frikës dhe Shpresës”** së zemrës. Dashuria që ndodhet në lëkundjet e këtij lavjerrësi, ka formuar një burim energjie, e cila e ushqen forcën e njeriut.

Ata, të cilët e kuptojnë më mirë këtë realitet, janë ata që kanë ndjerë më shumë frikë dhe shpresë.

Për këtë arsye, dhe në Kuran **“Miqte e Allahut”** përmenden bashkë me **“frikën”** dhe **“shpresën”**.

Dhe për këtë, fusha e ndjenjave midis **“frikës dhe res-**



pektit” shihet më shpesh në botën e tasavvufit dhe tek ata njerëz që tregojnë disiplinë personaliteti.

Nëse shihni me kujdes jetën e tyre, do të vini re qartësisht një lloj frike dhe një shpresë që buron nga thellësitë.

Ata e kanë përqafuar rrugën e Allahut në mënyrë të atillë, saqë mendojnë se do të jetojnë edhe humbjen e madhe, por edhe sepse çmimin e madh do ta marrin ata vetë.

Në veprën El-Luma¹ transmetohet një thënie që i atribuohet njerit prej sufive:

“Frika dhe shpresa janë dy krahët e amelit (punës) dhe pa to nuk mund të fluturohet.”

Ndërsa Suhreverdi, në veprën “Auarifu’l Maarif” transmeton këtë thënie nga Mutarrifi:

“Nëse do të peshohej frika dhe shpresa e besimtarit, do të dilnin njësoj.”

Nëse e shohim më nga afër se si kuptohet “Frika” dhe “Shpresa” në botën e sufive, përballemi me këto vlerësimet:

Zunnun Mësri: *“Nëse ai që e do me të vërtetë Allahun nuk e ujit zemrën e tij me frikë, nuk mund të pijë nga gota e dashurisë së Tij.”*

Fudajl bin Iyad: *“Nëse të pyesin se, a ke frikë Allahun dhe përgjigjesh me ‘jo’ ke bërë mohim e nëse përgjigjesh me ‘po’ ke gënjyer, sepse cilësia jote nuk është cilësia e atij që ka frikë Allahun.”*

Sulejman Darani: *“Edhe nëse duhet që rob i jetë midis frikës dhe shpresës, është më mirë që zemra e tij të rrahe gjithmonë me frikë, sepse zemra në të cilën nuk ndodhet frikë, shkatërrohet.”*

Kannad: *“Tregues i frikës është, të mos i japësh zemrës*

1. El-Luma (Tasavvufi Islam) Vepra e Ebu Nasr Serraxh Tusi

arsye dhe shpresë me fjalë të tilla si “mbase më vonë”.

Ibën Xhel-la: “Sipas meje, njerëzit që me të vërtetë e kanë frikë Allahun janë ata që nuk kanë frikë tjetër kënd përveç Tij.”

Vasëti: “Të mëdhenjtë kanë frikë nga privimi, ndërsa të vegjlit nga dënimi. Frika e të mëdhenjve është më e mprehtë, sepse disa gjëra që i përkasin egos, e ndalojnë të zotin në arritjen e vlerës së mirësisë, me qëllim që të vazhdojnë ekzistencën e tyre në ego.”

Ebu Nasr Serraxh Tusi: “Shpresa është e lidhur me gjendjen e frikës...Shpresa dhe dashuria kërkojnë frikë.” Me këtë ai shpreh se “frika” tek njeriu është më e theksuar. Edhe këto fjalë i përkasin Tusi: “Gjendjen e frikës e përmendim bashkë me dashurinë, sepse gjendja e afërsisë kërkon frikën dhe dashurinë. Midis sufive ka nga ata që synojnë afërsinë e Allahut dhe frika në zemrën e tyre është më e madhe, por ka edhe nga ata që dashurinë e kanë më të madhe. Kjo gjendje ndryshon në varësi të përcaktimit hyjnor të bindjes, diturisë dhe frikës, të cilat Allahu ia ka dhënë një zemre.” (el-Lüma, Islam Tasavvufu, Tusi, Tercüme ve sorular cevaplar: Prof. Dr. Hasan Kamil Yılmaz, Erkam Yay.)

Qoftë nga frika e dënimit, qoftë nga frika e humbjes së afërsisë së Allahut, pëlqimit dhe dashurisë, frika mbetet një institucion shpirtëror që luan një rol shumë të rëndësishëm në ndërtimin e personalitetit të një besimtari.

Mirëpo, menjëherë pranë saj zë vend edhe “Shpresa”, si një element shpirtëror nxitës i të njëjtit nivel.

Resulullahu (s.a.) urdhëron kështu: “Nëse do të peshohej frika dhe shpresa e besimtarit, do të ishin të njëjta.”

Ahmed b. Ata: “Frika dhe shpresa janë dy frerë të egos, me anë të të cilave egoja do apo s’do qëndron në rrugë të drejtë, është e sigurt dhe nuk rrëmbëhet nga humbja e shpresës.”

Vasiti e shpjegon kështu marrëdhënien midis frikës dhe shpresës:

“Ashtu siç shihet rregulli i universit në ndërrimin e natës e të ditës, dhe bukuria e ditës kuptohet vetëm me errësirën e natës, ashtu është edhe frika me shpresën. Ndonjëherë zemra bie në errësirën e frikës dhe ngelet peng, ndonjëherë troket derën e shpresës dhe çlirohet. Në fakt, dashuria, frika dhe shpresa janë terma me kuptime të afërta. Një nga sufritë thotë kështu: “Dashuria që nuk përmban frikë, është e mbushur plot me fatkeqësi. Edhe frika që nuk përmban shpresë, është po ashtu e mbushur me fatkeqësi. Por edhe shpresa që nuk përmban frikë, e tillë është.”

Ebu Bekir Verraku: “Shpresa është një qetësim që vjen prej Allahut në zemrat e njerëzve që e kanë frikë Atë. Nëse nuk do të ishte shpresa, ata do të shkatërroheshin dhe do t’u ikte mendja nga koka.”

Shah el Kirmani: “Shpresa është gjendja në të cilën

mund të shohësh me syrin e të bukurës shfaqjet madhështore...Shpresë është afrimi i zemrës ndaj mirësisë së Allahut Teala.”

Ebu Abdullah b. Hafif: “Shpresa është qetësimi i zemrës pasi ka parë bujarinë e Allahut i cili e ushqen me shpresë çdo gjë.”

Sipas një transmetimi, një arab endacak shkon te Profeti (s.a.) dhe e pyet:

-Kush do t’i gjykojë të gjitha krijesat?

Resulullahu (s.a.) u përgjigj: “Allahu”.

Endacaku pyeti përsëri:

-Ai vetë personalisht?

Resulullahu (s.a.) i tha: “Po”.

Pas kësaj endacaku buzëqeshi lehtë, ndërsa Resulullahu (s.a.) e pyeti: Përse buzëqeshë? Endacaku iu përgjigj: “S’ka dyshim se ai që është bujar dhe i fuqishëm fal, dhe kur gjykon tregon tolerancë.” (Ebu Davud, Sunnet, 23-Avarif, s. 620)

Shpresa ndahet në tre lloje:

1. Të shpresosh në shpërblimin e Allahut.

2. Të shpresosh në mëshirën e gjerë të Allahut.

3. Të mos shpresosh prej askujt përveç Allahut.

Në një ndodhi që e ka treguar Zunnuni, del në pah qëllimi i vërtetë i “shpresës”:

“Po sillesha vërdallë si i hutuar në një shkretëtirë dhe u përballa me një grua. Gruaja më pyeti:

-Kush jeni?

Unë iu përgjigja:

-Një njeri i gjorë.

Gruaja më tha: “A mundet të jetë i gjorë dhe i vetmuar dikush që është me Allahun?”

Domethënë sekreti qenka këtu... Ai që është me Allahun nuk ndien vetmi dhe nuk është i gjorë. Nuk e humb shpresën dhe ka frikë t’i ngrejë krye Atij. Shqetësohet se mos e humb pëlqimin e Tij, sepse Ai di çdo gjendje. Për këtë arsye, Shah el Kirmani thotë: “Shenja e shpresës është bindja dhe adhurimi i përsosur”, duke nënkuptuar se “Shpresa” nuk është një gjendje shpirtërore që e çon njeriun në humbje.

Në veprën “Auarif”, Suhreverdi e përcakton kështu maturinë e zemrës midis “Frikës dhe Shpresës”: “Frika dhe shpresa janë si dy krahë për besimin. Ai që i frikësohet Allahut, ka shpresë sa ka edhe frikë dhe ai që shpreson tek Allahu, ka frikë sa ka edhe shpresë, sepse frika kërkon besim dhe me besimin del në pah shpresa. Edhe shpresa kërkon besim dhe prej besimit lind frika.”

Me një kuptim të tillë, transmetohet se Lukmani e ka këshilluar kështu të birin e tij:

“Frikësoju Allahut pa kërkuar siguri. Shpresa tek Ai të jetë më e madhe se frika.” Ndërsa i biri e pyeti: “Unë kam vetëm një zemër. Si mund t’ia dal mbanë?” Ai iu përgjigj duke i thënë: “A nuk e di se besimtari ka dy zemra. Me një të frikësohet dhe me tjetrën shpreson, sepse të dyja janë prej urtësisë së besimit.” (Auarif s.620)

Këtu duhet të kujtojmë edhe hadithin e Resulullahut (s.a.):

“Nëse besimtari do ta dinte madhësinë dhe mënyrën e dënimit të Allahut, nuk do të shpresonte për xhenet. Por edhe mohuesi po ta kuptonte madhësinë dhe mënyrën e mëshirës së Allahut nuk do ta humbiste kurrë shpresën prej xhenetit të Tij.” (Muslim, Teube, 23)

“Xheneti është më afër lidhëzave të këpucëve tua. Edhe xhebenemi po ashtu.” (Buhari, Rika, 29)

Njeriu duhet të ketë më shumë “Shpresë” apo “Frikë”?

Përgjigjja e kësaj pyetjeje është pak e ndërlikuar. Mbase, mund të themi kështu: E rëndësishme është që ta meritosh shpresën. Për këtë duhet që frika të jetë e mjaftueshme. Domethënë, duhet të ketë shumë frikë që të ketë dhe shpresë. Mirëpo, meqenëse madhësia e shpresës është e lidhur me besimin, në të njëjtën kohë mund të përmbajë edhe frikën. E rëndësishme është që, dashuria për Allahun dhe besimi tek Ai ta kaplojë zemrën e njeriut.


Mbase çështjen e frikës dhe shpresës duhet ta shohim edhe pak nga pikëpamja e të nderuarit Musa Efendi. Këto janë ndjenjat që ia ka shprehur Musa Efendi në momentet e fundit të jetës së vet të afërme në letrat dhe bisedat që ka bërë:

“Lum për atë që e ka harxhuar jetën e tij në rrugën e Allahut dhe ka emigruar në botën tjetër me faqe të bardhë.”

“Megjithëse jam një njeri i moshuar, s’munda ta disiplinoj dot vetveten. Kam lexuar jetën e ndershme të të mëdhenjve të Islamit dhe nuk munda t’u ngjaj atyre. Mbas një jete plot gabime, shpresoj në faljen e Allahut Teala, sepse Ai është Rrahman dhe shumë falës.”

“...në vitin 1956 e pranuan të varfrin në këtë rrugë të lartë. Ata treguan një respekt të veçantë kundrejt të varfrit. Megjithëse kanë kaluar tridhjetë e tre vjet, nuk munda t’i shpëtoj nefsit tim. E gjithë jeta ime kaloj me gabime, harresa dhe pakujdesi. Me gjithë këtë, mendimi i mirë ndaj Allahut dhe dashuria për Të, gjithmonë më është shtuar. Të dashurit e Zotit tim i kam dashur me gjithë shpirt dhe armiq të Tij i kam urreyer.

...Jam shumë i pafuqishëm dhe i mbushur me të meta. Ngushëllimi im i vetëm është ajo se i dua të dashurit e Allahut me gjithë shpirt, madje më tepër se jetën time dhe çdo gjë tjetër.”




Në të gjitha këto shihet pasqyrimi i thellë i “frikës”. Por të gjithë dëshmojnë se kanë jetuar të pastër. Ishin rob të mirë dhe të pastër. Në adhurimet e tyre ishin të përpiktë, në duatë e tyre ishin të zjarrtë, në dhënien e tyre nuk shihje frikë nga harxhimi i pasurisë, në vepra ishin delikatë, respektonin të drejtën njerëzore dhe tregonin gjithë shfaqjen e një robi të mirë me maturinë e mirësisë...

Ky është një varg që vjen prej Resulullahut (s.a.), i cili ishte një Profet që falej derisa i ënjteshin këmbët. Ai që, edhe në momentet e sëmundjes së tij të rëndë tregonte kujdes të dilte në namazin me xhemat. Pse?

Përse këta njerëz që kanë qenë të vetëdijshëm ndaj “**mëshirës së pafundme**” të Zotit kanë treguar një emocion adhurimi kaq të madh?

Mbase nga nevoja e ndjenjës së të merituarit të “shpresës”... që të kapen pas shpresës...

Allahu na e mundësoftë të gjithëve të kemi ndjenja të tilla...!



Prof. dr. Metin Izeti

QASJE RELIGJIOZE RELIGJIONIT

«I dashur, dije që njeriu nuk është i krijuar për argëtim ose rastësisht, por është krijuar i përsosur dhe për një qëllim të lartë.»

GAZALI

Gazali, Ebu Hamid, *The Alchemy of Happiness*, Lahor, 1964, f.17.

Situata religjioze në botën e sotme karakterizohet me dy pika ekstremisht të kundërta me njëra - tjetrën: nga njëra anë radikalizmi dhe fanatizmi luftarak, që nuk e ka për gjë edhe vrasjen e njerëzve të pafajshëm në rrugë edhe pse mund t'i takojnë të njëjtit religjion, ndërsa nga ana tjetër neglizhenca fetare, si dhe besimi sinkretist herë pas here i stolitur me ezoterizmin dhe okul-

tizmin misterioz. Gjithnjë e më tepër njeriu bashkëkohor është i zënë me vetveten dhe me fatin personal. Ai ia nënshton fatit të tij vetjak obligimet shoqërore dhe solidaritetin e bashkësisë. Me kalimin e ditëve ai shndërrohet në narcis të vetmuar. Me modernen dhe postmodernen, njeriu përjetoi dy parime liberaliste: individualizmin dhe pluralizmin, të cilat deshëm apo jo

u inkadruan edhe në sendërtimin e idesë religjioze. Cilido që merr guximin të analizojë ngjarjet fetare, do të ballafaqohet me një katrahurë të autoritarizmit dhe të individualizmit brenda pluralitetit, si religjioz ashtu edhe fraksional e grupor. Kjo për arsye se në të shumtën e rasteve religjioni u bë maskë e qëndrimeve dhe e lëvizjeve joreligjioze. Këto lëvizje i hasim edhe në jetën tonë të përditshme, në trajtën e radikalizmit ose okultizmit, por i hasim po ashtu në njohjen e së vërtetës religjioze dhe qasjes ndaj të vërtetave të besimit dhe ortopraktikës fetare. Qasjet shkencore-teknologjike nga njëra anë, dhe ato mitologjike-tradicionale nga ana tjetër, ia humbën religjionit ndjesinë dhe aktualitetin kohor e hapësinor. Vlera e analizave joreligjioze ndaj religjionit është relative dhe e kushtëzuar, për shkak se religjioni mund të kuptohet vetëm nëpërmjet religjiozes dhe religjionit. Në hulumtimin fetar, subjekti dhe objekti duhet të jenë religjioze, gjë që do të thotë se subjekti duhet ta përjetojë fetaren. Subjekti që nuk është fetar e vret dhe e mbyt objektin religjioz të cilin e hulumton. Diskutimet apologjetike dhe juridike të fesë, janë shndërruar që moti në disiplina të vdekura që trajtohen si përkujtime të mundimshme të religjiozitetit të dikurshëm.

Ç'është thelbi i religjionit?

Cili është nervi bazë i tij dhe pse kemi nevojë për të?

Feja ose religjioni nuk është dije abstrakte, përkundrazi është gnosë (njohje), koncept i tërësishëm, konkret dhe organik i jetës personale dhe i botës përreth. Tradita konstituive e Islamit e konsideron religjionin si dhuratë hyjnore mbinatyrore, të mirëqenë, të lirë dhe jo të huazuar. Është mbinatyrore për shkak se burimin e ka në Zotin; është mirëqenëse për shkak se vjen si rezultat i mëshirës hyjnore e cila ka si qëllim vendosjen e aleancës me njeriun si krijesë-kurorë e krijimit hyjnor; është i lirë për shkak se rrjedh prej lirisë së pakufishme të Zotit dhe është jo e huazuar për shkak se nuk jepet me pretendim ose me qëllim që t'i kthehet, por që të ngjallë me butësi besnikërinë, mirësinë dhe dashurinë ndaj Zotit.¹ Ajeti kuranor që flet për ekskluzivitetin e pranueshmërisë fetare para Zotit, e karakterizon atë si nënshtrim absolut ndaj të Madhit, apo si përjetim i lirisë në skllavërinë e epiqendrës së qenësisë.² Ka të drejtë Dostojevski kur thotë: *unë jam realist dhe objektivist, i cili qëndron në shenjë të kalimit drejt universa-*



*lizmit religjioz, brenda hapësirës së përbotshme historike.*³

Ai e pranon traditën pereniale fetare, që për të, është i prezantuar në institucionalizimin e fesë brenda kishës, por që nga ana tjetër është avangardë ndaj individualizmit dhe akademizmit të thatë, në kontekstin e idesë për religjionin dhe prezencën e saj në shtigjet e kulturës e të shkencës botërore. Religjioni i nevojitet njeriut që ai të zbulojë konceptin e qenësisë personale dhe të historisë botërore, që të mund të ndërlihdë konceptin personal me atë të rendit botëror. Unë mendoj, thotë Dostojevski, se nëpërmjet religjionit, nëpërmjet gnosës (njohjes) do të mundësohet zbulimi i sekretit tim, do të më bëhet e qartë kush jam unë, prej nga kam ardhur; shpresoj se do të arrij ta kuptoj misterin e botës, me të cilën unë jam i lidhur në një mënyrë të drejtpërdrejtë, por të pakuptueshme për mua. Nëse nuk e kuptoj dot rendin dhe sistemin ekzistencial të botës, atëherë prezenca ime në histori do të jetë jointerese dhe e dëshpëruar, dhe nuk do ta di se për ç'arsye jetoj.⁴

3. Dostojevski, F.M., *Ruska Religjioza Filozofija* i F.M. Dostojevski, përgatiti: N. Berdjajev, Beograd 1982, f. 7.

4. Dostojevski ka qenë prej ndjekësve, siç thotë edhe vetë, i gnostikëve lindorë të kishës ortodokse siç janë Origeni, Klimenti i Aleksandrisë etj., të cilët kanë qenë të lidhur ngushtë me filozofinë pereniale dhe përvojën religjioze të pastër. Tek ta si edhe te Dostojevski, relacioni sublim fetar mes krijesës dhe Krijesit ka

1. Hafizović, Reshid, *Teoloski Traktati o Načelima Islamske Vjere*, Sarajevo 1996, f.9.

2. Al-i Imran, 3:19.

"Pasha kohën! Nuk ka dyshim se njeriu është në një humbje të sigurt. Me përjashtim të atyre që besuan, që bënë vepra të mira, që porositën njëri-tjetrit t'i përmbahen të vërtetës dhe që këshilluan njëri-tjetrit të jenë të durueshëm."

Vlerësimi i bërë nga ana e Dostojevskit në lidhje me religjionin dhe religjiozitetin, do të thotë subjektin e të cilit i komunikohet shpallja, është një klithmë që diku me zë e diku pa zë dëgjohej në të gjitha traditat fetare. Që nga humanizmi dhe renesanca, fetarët jetojnë brenda një shkëputje vullkanore ndërmjet kulturës e traditës amë shpirtërore e religjioze dhe kulturës moderne, si një paradigmë *sui generis* e botës bashkëkohore. Kjo joharmoni është ndjekur me kriza të shumta të identitetit që çdo person dhe grup fetar e ka përjetuar në trajta të ndryshme.

A kemi analizë diskursive të religjionit...?

Diskursi paraqet trajtën se si është analizuar një dije ose dukuri në shoqërinë konkrete historike dhe në institucionet shoqërore. Praktika diskursive, thotë Fuko (Michel Foucault) karakterizohet me ndarjen e fushës së objektit, përkufizimin e një perspektive kanonike në kontekst të lëndës njohëse, përcaktimin e trajtës së analizës së konceptit dhe teorisë. Praktika diskursive nuk është trajtë e thjeshtë e prodhimit të diskursit. Ajo formohet në tubimet teknike, në institucionet, në skemat e sjelljes, në llojet e përcjelljes, në format pedagogjike, të cilët imponohen dhe kultivohen së bashku me trajtësimin.⁵ Vendosija e ndërlidhjes diskursive të teologjisë ose filozofisë së religjionit si rrjedhë e tërë kësaj ortopraktikës fetare, do të paraqesë kontekstualizimin dhe identifikimin real të fesë në shoqërinë aktuale njerëzore. Ndërsa nga ana tjetër, do të dekontekstualizohet çdo element multiplikativ i identifikimit real të religjionit. Vetëm në këtë mënyrë ka mundësi

qenë i eksponuar realisht dhe pa institucionalizim e komenteve të anshme. Shih: Dostojevski, *po aty*, f. 17.

5. Fuko, Mishel, *Rijeçi i stvari*, Beograd, 1971, f.141-181; 383-425.

që religjioni të përfaqësojë ndjenjën dhe emocionimin fetar, si dhe zënie vend të kësaj ndjenje në kornizat e kulturës botërore.

Në të kundërtën, qasjet teorike të cilat nisen nga përfaqësimi i vetëm zinxhirëve të interpretimit, të cilat ndërtojnë formalizëm letrar e gjymtojnë diskursin fetar, i cili nuk ka mundësi të jetë "gjuhë" si ajo e letërsisë, jurisprudencës, apologjetikës.... Diskursi religjioz nuk është i organizuar sipas shembullit të gjuhës utilitare linguistike, por në të bëhet fjalë për një relacion të hapur dhe po ashtu sistematik ndërmjet:

1. Ortopraktikës fetare si hapësinore, kohore dhe shqisore (dukuri).

2. Dijes analitike, intelektuale, e cila përbën strukturën e zgjedhjes parapraktike, gjegjësisht sistemit konstituiv të dijes fetare.

3. Përmasa ndjesore transhendentale pa të cilën çdo praktikë dhe intelektualizëm religjioz do të ishte jo-fetar.

Në suren *Asr*, në trajtë mjaft të ngritur dhe hyjnore, Allahu i Lartëmadhëruar e përfaqëson këtë diskurs të religjionit, që është bazë e sjelljes së *homo religjiozitetit* sipas shpalljes së fundit. Fuqia Krijuese urdhëron:

Me emrin e Allahut, Mëshiruesit, Mëshirëbërësit!

*"Pasha kohën! Nuk ka dyshim se njeriu është në një humbje të sigurt. Me përjashtim të atyre që besuan, që bënë vepra të mira, që porositën njëri-tjetrit t'i përmbahen të vërtetës dhe që këshilluan njëri-tjetrit të jenë të durueshëm."*⁶

Kjo sure e Kuranit sqaron se njeriu e përgatit me duart e veta lumturinë dhe shkatërrimin e tij. Njeriu nuk shpëton prej përgjegjësisë nëse e fajëson kohën, shekullin, hapësirën. Diskursi kuranor e mohon kategorikisht arsyetimin e atyre që e kornizojnë të mirën në një kohë të caktuar, ndërsa dobësitë personale i përfaqësojnë si anomali të kohës në të cilën jetojnë. Thënë shkurt: Fisnikëria është në njeriun e jo në kohën.

Në ajetin e parë të kësaj sureje, Allahu Fuqiplo-të betohet në kohën si koncept i korrjes njerëzore, si shtrydhje e lëngut njerëzor prej esencës së tij krijuese. Obligimi i besimtarit nuk është të jetë ithtar i kohës, por pronar i saj. Personi që nuk është pronar i kohës, nuk mund t'i shijojë begatitë e saj.⁷

6. *Asr*, 103:1-3.

7. Islamoglu, Mustafa, *Hayat Kitabı Kur'an*, Istanbul pa datë, f. 1299

Vetëdija islame mbi kohën është në kontekst linear, që është tipike për religjionet e shpallura: koha fillon me krijimin dhe lundron deri në ditën e Gjykimit, mirëpo kjo kohë lineare në një mënyrë shndërrohet në lëvizje ciklike, gjegjësisht në “rrugëtimin e besimtarëve të përkushtuar prej vendit të fillimit deri te vendi i kthimit”.⁸

Për pasojë, njeriu që nuk është i vetëdijshëm për kohën (e tashme dhe të kthimit), është i humbur. Kushtet bazë të shpëtimit janë dy: besimi dhe veprat e mira të bazuara në të. Vepërmirësia e bazuar në besimin nuk është e koncentruar në një periudhë të caktuar kohore dhe përfshin tërë gjininë njerëzore, që prej fillimit e deri te kthimi. Islami i stolisur me besim të këtillë mund të përkufizohet si “*realitet eternal i vetëm i vlerave të pandryshueshme të njerëzimit*”. Termi “*amilu’s-salihat*” (vëpërmirët, vepërmirësia) në Kuran përdoret në shumë trajta të ndryshme. Në ajetet që flasin për vitet e para të shpalljes theksi bie mbi “*sjelljen me përgjegjësi*”,⁹ në vitet e mëpasme theksi i vepërmirësisë fetare është vatrëzuar në “*sjellje e nduarnduartë me besimin*”, në periudhën e formimit të shtetit të Medines më tepër përqendrohet në “*përmirësimin e vetes dhe të tjerëve*”.¹⁰ Përqendrimi i fundit i vepërmirësisë në kontekstin kuranor paraqet thelbin e këtij parimi të shpalljes dhe në të është universalizuar diskursi religjioz Islam për ecjen e vepërmirësisë me kohën, gjatë të gjitha periudhave të jetës njerëzore në faqen e dheut.

Përderisa njerëzit që merren me teorinë e feve nuk arrijnë që ta bartin atë dukuri të rëndësishme dhe të patjetërsueshme të kohës nëpërmjet një diskursi efektiv, religjioni nuk do të ketë vendin e merituar në shoqërinë njerëzore.

Kalimi në mijëvjeçarin e ri u përjetua me shumë ngjarje mahnitëse. U përjetuan shumë tronditje kuptimore, proceset kulturore dhe shoqërore e ndryshuan botën, u ballafaquam me kultura dhe mbikultura të reja, me stile dhe simbolika të ndryshme. Të gjithë këto ndryshime i sfidojnë antropologët, kulturologët, politikanët, sociologët, komunikologët etj. Mirëpo shumë rëndë arrijnë të sfidojnë teologët, që ata të shpëtojnë prej interpretimit imitues shterp dhe të ecin realisht me kohën kur jetojnë.

8. Allahu i Lartëmadhëruar në suren *Bekare* urdhëron: “*të cilët, kur i godet ndonjë fatkeqësi thonë: “Të Allahut jemi dhe vetëm tek Ai do të kthehemi! Ata do të shpërblehen me bekim dhe mëshirë nga Zoti i tyre; ata janë në rrugën e drejtë!” (2:156-157).*

9. Duke filluar prej ajetit të dytë të sures *Bekare* që e shpreh devotshmërinë para udhëzimit, Kurani është bazuar në vetëdijen e përgjegjësisë dhe etikës dhe këtë e shpreh nëpërmjet të aksiologjisë dhe justifikimit hyjnor.

10. Islamoglu, Mustafa, *po aty*.



Këtë ecje unë nuk e kuptoj si interpretim të religjionit me fusha joreligjioze, por përkundrazi si qasje e vërtetë religjioze ndaj fesë, e kërkuar nga universaliteti i shpalljes dhe i diskursit hyjnor.

Është fakt se shoqëria e sotme e orienton rruzullin në bazë të ritmit të shpenzimit. Zoti kryesisht është një Fuqi, diku jashtë, i mënjeluar jashtë saj. Ndërsa teologët dhe teoricienët e religjionit merren më tepër me dogmën dhe folklorin fetar se sa me urtinë fetare, më tepër me parimet e moralizimit shoqëror se sa me shpirtëroren.

Qasja reale religjioze ndaj fesë duhet të jetë e përqendruar në tri segmente bazë:

1. Përfaqësimi intelektual dhe kohor i teologjisë (shkencës mbi parimet besimtare).
2. Zënia vend në mënyrë reale e ortopraktikës (ibadeteve) në shoqërinë bashkëkohore.
3. Emocionimi dhe entuziazmi adhurues në përjetimin e fesë.

vijon...

RRËFENJA E ADEMIT (A.S.) NË KURAN

Harun Jahja

KRIJIMI I ADEMIT A.S.

Rasti i Isait për Allahun është si rasti i Ademit që e krijoi prej baltës e pastaj i tha: "Bëhu!" - dhe ai u bë. (Ali Imran, 59)

ALLAHU I MËSOI ADEMIT A.S. TË GJITHË EMRAT E SENDEVE

Kur Zoti yt u tha engjëjve: "Unë do të krijoj një mëkëmbës (që do të zbatojë ligjet e Zotit) në tokë", ata thanë: "A do të vësh atje dikë që do të bëjë çrregullime e do të derdhë gjak në të, ndërkohë që Ne të madhërojmë, të lavdërojmë dhe të lartësojmë ashtu si të takon Ty?!" Ai tha: "Unë di atë që ju nuk e dini". Allahu i mësoi Ademit emrat e çdo gjëje, pastaj ua paraqiti engjëjve dhe u tha: "Më tregoni emrat e tyre, nëse ajo që thoni është e vërtetë!" (Bekare, 30-31)

BINDJA E ENGJËJVE NDAJ ALLAHUT

"Qofsh i lavdëruar! - thanë ata - Ne dimë vetëm atë që na ke mësuar Ti. Në të vërtetë, Ti je i Gjithëdituri,

i Urti.". "O Adem, - tha Ai - tregoj atyre emrat e gjërave!" Kur ai ua tregoi emrat e tyre, Allahu tha: "A nuk ju kam thënë se vetëm Unë di fshehtësitë e qiellit e të Tokës dhe vetëm Unë di çfarë tregoni haptazi dhe çfarë fshihni?!" (Bekare, 32-33)

"E kur ta përsosë atë (në formën e njeriut) dhe t'i japë atij shpirtin që është krijesë e Imja, atëherë ju bini atij në sexhde". Të gjithë engjëjt tok, bënë sexhde. Përveç Iblisit. Ai refuzoi të jetë me ata që bënë sexhde?" (Hixhr, 29-31)

KUNDËRSHTIMI I SHEJTANIT

Kur u thamë engjëjve: "Përluni në sexhde Ademit!" ata të gjithë iu përlën në sexhde përveç Iblisit. Ai tha: - Si t'i bëj sexhde unë atij që e krijove nga balta?

Gjithashtu tha: -A e sheh këtë që Ti e nderove mbi mua? Nëse Ti më jep kohë deri në Ditën e Kiametit, unë do t'i shfaros me mashtrim pasardhësit e tij, përveç disave prej tyre." (Israë, 61-62)

Allahu i tha: O Iblis ç'pate ti që nuk u bashkove me ata që u përlën? Iblisi tha: Unë nuk i përulem një vdekatori që Ti e ke krijuar nga balta e thatë e marrë prej baltës së

zezë pa formë. Allahu tha: Atëherë dil prej Xhenetit! Ti je vërtetë i mallkuar! Le të jetë mallkimi mbi ty deri në Ditën e Kijametit. **(Hixhr, 32-35)**

Allahu tha: "Ç'ka të pengoi ty kur unë të urdhërova! Ai u përgjigj: Unë jam më i mirë se ai. Mua më krijove nga zjarri, kurse atë e krijove nga balta. Allahu i tha: Atëherë zbrit prej andej (Xhenetit). Ti nuk ke të drejtë që të krenohesh në të! Shporru me të vërtetë ti je prej të poshtëruarve". **(A'raf, 12-13)**

KËMBËNGULJA E SHEJTANIT NË KUNDËRSHTIM

(Iblisi) Tha: "Zoti im, më jep pra afat deri në ditën kur ata (njerëzit) të ringjallen!" (Zoti) Tha: "Sigurisht që do të të jepet afat, deri në një ditë së caktuar." **(Hixhr, 36-38)**

(Iblisi) Tha: "Më jep afat deri në ditën kur ringjallen (njerëzit)!" **(A'raf, 14)**

Kush zgjedh rrugën e drejtë e ka për veten e vet e kush i largohet asaj i largohet në dëm të vetvetes dhe askush nuk e merr të keqen e tjetërkujt. Ne nuk dënojmë asnjë popull para se të çojmë të dërguar". **(Isra, 15)**

"Gjithashtu tha: A e sheh këtë që Ti e nderove mbi mua? Nëse Ti më jep kohë deri në Ditën e Kijametit unë do ti shfaros me mashtrim pasardhësit e tij përveç disave prej tyre." **(Isra, 62)**

BETIMI I SHEJTANIT

Ai tha: "Për shkak se Ti më flake tej unë do t'u zë pritë njerëzve në rrugën tënde të drejtë. E do t'u qasem atyre përpara dhe prapa nga e djathta dhe nga e majta e kështu Ti do të vëresh se shumica prej tyre nuk të janë mirënjohës." **(A'rafë, 16-17)**

NDIKIMI I SHEJTANIT

(Iblisi) Tha: "Zoti im, për shkak se më përzure (më largove), unë do t'ua zbukuroj (të këqijat) atyre sa të jenë në tokë (në këtë botë) dhe të gjithë ata do t'i largoj nga rruga e drejtë!" Përveç robërve të Tu, të cilët i ke bërë të singertë. (Madhëria e Tij) Tha: "Kjo është rruga Imë e drejtë (e qartë)." **(Hixhr, 39-41)**

Në të vërtetë, ti nuk ke kurrfarë fuqie ndaj robërve të Mi. Mbrojtja e Zotit tënd është e mjaftueshme (për ata). **(Isra, 65)**

Në të vërtetë, ti nuk do të kesh pushtet mbi robërit e mi përveç se mbi të humburit që të pasojmë ty. Pa dyshim Xhehenemi është vendi i premtuar për të gjithë. **(Hixhr, 42-43)**

DËBIMI I SHEJTANIT

Allahu tha: "Ik! Kushdo prej tyre që të pason ty, do të ketë Xhehenemin si shpërblim një shpërblim i fortë. Bëj për vete me zërin tënd që të mundesh nga ata. Lësho kundër tyre të gjithë kalorësinë e këmbësorinë tende! Bëj pjesë në pasurinë e fëmijët e tyre dhe jepu premtim. Premtimet e djallit janë vetëm mashtrime!" **(Isra, 63-64)**

(Allahu) Tha: "Dil prej andej i përbuzur dhe i përjash-tuar! Pa dyshim Xhehenemin do ta mbush me ty dhe me të gjithë ata që shkojnë pas teje!" **(A'raf, 18)**

SPROVIMI I ADEMIT A.S

Ndërsa Ademit i tha: "O Adem! Bano ti dhe bashkë-shortja jote në Xhenet dhe hani çtë dëshironi por mos iu afroni kësaj peme se bëheni keqbërës." **(A'raf, 19)**

Ne thamë: "O Adem, ti dhe gruaja jote jetoni në Xhe-net dhe aty hani sa të doni por mos iu afroni kësaj peme se ndryshe do të bëheni të padrejtë." **(Bekare, 35)**

Pastaj thamë: "O Adem me të vërtetë ky është armiku yt dhe i gruas sate, prandaj mos e lini t'ju nxjerrë kurr-sesi nga Xheneti, se pastaj do të vuani në mjerim. Këtu nuk do të mbetesh kurrë as i uritur as i zhveshur dhe nuk do të kesh as etje as vapë." **(Ta Ha, 117-119)**

Ne bëmë besëlidhje edhe me Ademin më parë por ai harroi sepse nuk ishte i vendosur. **(Ta Ha, 115)**

NXITJA E SHEJTANIT

Djalli u pëshpëriti për t'ua zbuluar pjesët e turpshme të mbuluara të trupit të tyre dhe u tha: "Zoti juaj, jua ka ndaluar pemën vetëm që të mos bëheni engjëj ose të pavdekshëm. Dhe iu betua atyre duke thënë: Vërtet, Unë jam për ju këshillues i singertë. Dhe i mashtroi me dinakërinë e tij. Pasi e shijuan frutin atyre iu zbuluan vendet e turpshme dhe nisën të mbulohen me gjethet e Xhenetit dhe Zoti i tyre i thirri A nuk ua kisha ndaluar atë punë? A nuk ju pata thënë se djalli është vërtet armiku juaj i hapur?" **(A'raf, 20-22)**

Por djalli e cyti "O Adem a do të të tregoj pemën e për-jetësisë dhe të një mbretërimi që nuk zhduket? Kështu ata të dy (Ademi dhe Havaja) hëngrën nga ajo pemë e u ndërgjegjësuan për lakuriqësinë e tyre prandaj nisën të mbulohen me gjethet e Xhenetit. Ademi nuk e zbatoi urdhërin e Zotit të vet kështu që devijoi nga rruga e drejtë." **(Ta Ha, 120-121)**



Nyja e ndërmjetësimit në Islam

Nexhat Ibrahim

Doktrina e ndërmjetësimit (*shefa'atit*) është një ndër çështjet e rëndësishme në besimin islam. Këtë rëndësi ndërmjetësimi e ka në Kuran e në Hadith, por edhe në veprat dhe diskutimet e dijetarëve të mëdhenj myslimanë, klasikë e bashkëkohorë.

Nëse do t'i analizonim kuptimet e fjalës “*esh-shefa'atu*” do të shihnim se ajo rrjedh nga gjuha arabe, që do të thotë: *ndërmjetësim apo ndërhyrje për dikë, zotim për dikë, pastaj ka edhe kuptimin: mjet, mënyrë, metodë dhe kërkim*¹. Në kuptimin terminologjik fjala *esh-shefa'atu* ka një shtrirje të gjerë dhe do të thotë: “*Ndërhyrje e dikujt për dikë, për t'i kryer punë atij, lutje për falje në emër të dikujt*”, respektivisht “*ndërmjetësim dhe ndërhyrje pranë Allahut, me lejen e Tij, nga ana e profetëve, dijetarëve dhe dëshmorëve, në favor të besimtarëve mëkatarë, me qëllim që t'u falen mëkatet, si dhe në favor të besimtarëve jomëkatarë, për t'ua lartësuar nivelin shpirtëror.*”²

1. Teufik Muftic, Arapsko-srpsko-hrvatski rjecnik, pjesa I, Sarajevë, 1973, fq. 1743; Ibrahim El-Baxhuri, sipas: Orhan Bislimaj, Akaidi hanefij, Prizren, 2008, fq. 480-481.

2. Ilyas Çelebi, Jeta e Pasma, në: Grup autorësh, Bazat e besimit islam, Prishtinë, 2002, fq. 230.

Sipas dijetarëve myslimanë, fjala *shefa'at* (dhe derivatet e saj gramatikore) do të thotë edhe “*të mundësohet që njëra anë të bëhet çift me tjetrën, respektivisht të ngjitet njëra anë me një të ngjashme me të*”. Po ashtu, *shefa'at* do të thotë “*bashkim i një njeriu me tjetrin që e ndihmon, si-domos kur njeriu me autoritet bashkohet me një njeri që ka rang më të ulët*”.³

Fjala *shefa'at* ka edhe kuptime të tjera, të cilat i gjejmë në procedurat civile e gjyqësore, por nuk është ky rasti për t'i trajtuar.⁴

Kurani i jep rëndësi të merituar *shefa'atit* dhe e lidh me çështjen e njësisë së Zotit⁵. Po ashtu, sipas Kuranit, *shefa'ati* është funksion që i përket jetës së ardhme (ahiretit), veprim ndihme që Zoti do të bëjë për njerëzit⁶,

3. Muhammed Ali, The Religion of Islam, botim i UAR, National Publication, Cairo, pa vit botimi, fq. 250-257, sipas: Islamska Misao, nr. 159, Mars 1992, Sarajevë, fq. 18.

4. Shprehja *shefa'at* përdoret kur shtrohet kërkesa te mbreti, kur ndërhyhet te ndonjë borxhli. Përdoret edhe kur ndërhyhet në proceset gjyqësore. Një hadith i Muhamedit (a.s.) thotë: “*Ai që me ndërhyrjen e tij pamundëson budud'ull-Llabun, ai e kundërshton vetë Allahun.*” Citohet sipas: Nerkez Smailagic, Leksikon islama, Sarajevë, 1990, fq. 573.

5. Shih Kur'anin: Junus, 18; El-En'am, 94; Ez-Zuhruf, 86 etj.

6. Ilyas Çelebi, po aty, fq. 232.

ose që do të bëjnë njerëzit e lejuar prej Tij për njerëzit mëkatarë, me synimin e shpëtimit të tyre nga dënimi i botës tjetër: *“Ndërmjetësimi im është për umetin tim i cili ka bërë mëkate të mëdha.”* (Hadith sipas Ibn Hanbelit) ⁷

Mirëpo, masa të caktuara myslimane, të kapur gabimisht pas disa ajeteve dhe haditheve për *ndërmjetësimin*, besojnë se *“dispozitat e ndëshkimit janë abroguar, se zjarri i xhehenemit është duke u ftohur dhe se do të jetë paqë për besimtarët mëkatarë.”* Shumë nga këto injorantë e kanë përgjithësuar institucionin e *ndërmjetësimit*, e kanë absolutizuar rolin e tij, duke e vënë në pikëpyetje të vërtetën e shpërblimit dhe ndëshkimit. Në ahiret, në xhehenem, do të ketë edhe grupe myslimanësh, të cilët me mëshirën e Allahut do të rivendosen në xhenet. ⁸

ALLAHU I MADHËRISHËM SI NDËRMJETËSUESI I MIRËFILLTË

Shefa’ati është kompetencë ekskluzive e Allahut (xh. sh.). Këtë nuk e kundërshton asnjë nga shkollat serioze të besimit dhe asnjë nga dijetarët e mirëfilltë myslimanë, përveç ndonjë grupi të devijuar. Në Kuran thuhet se Allahu i madhërishëm është ndërmjetësuesi (*shafi’u*) i parë:

“...sepse përveç Tij nuk do të ketë as mbrojtës as ndërmjetësues.” (El-En’am, 51)

“...e që s’ka mbrojtës as ndërmjetësues për të përveç Allahut...” (El-En’am, 70)

“Thuaj: I tërë shefa’ati (ndërmjetësimi) i takon vetëm Allahut, i Tij është pushteti i qiejve dhe i tokës, e më vonë vetëm te Ai ktheheni.” (Ez-Zumer, 44)

Nganjëherë flitet për ndërmjetësimin në lidhje me kontrollin e Zotit mbi gjërat, si për shembull në ajetin:

“Allahu është Ai që ka krijuar qiejt dhe Tokën dhe çdo gjë që gjendet midis tyre, për gjashtë ditë, pastaj është ngritur mbi Fron. Ju nuk keni as ndihmës, as ndërmjetësues tjetër përveç Atij. Vallë, a nuk po vini vesh?” (Es-Sexhde, 4)

Kështu, sipas Kuranit ndërmjetësimi është në duart e Zotit, siç është në duart e Tij edhe pushteti mbi gjërat e tjera, dhe qëndrimi i përsëritur shpesh është se askush nuk mund të ndërmjetësojë te Zoti përveç me lejen e Tij. (Junus, 3 dhe El-Bekareh, 155)

Ndërmjetësimi është i përjashtuar dhe nuk do të zbatohet për ata të cilët janë kryeneçë dhe në këtë botë sillen si zota:

7. Xhuma Emin, Dvadeset principa razumijejanja islama – komentar Dvad - set principa od Hasana el-Bene, Sarajevë, 2006, fq. 450 e tutje.

8. Shih elaborimin e dijetarit egjiptian rreth keqkuptimit të njes besimtare të shefa’atit: Muhammed Gazali, Besimi i myslimanit, Shkup, 1421/2001, fq. 264 e tutje.



“Ata nuk do të kenë ndërmjetësues (ndihmëtarë) prej shokëve (zotave) të tyre, e me shokët (zotat) e tyre ishin jobesimtarë.” (Er-Rrum, 13)

“Thuaj: “Sikur të kishte dashur Allahu, unë nuk do t’jua kisha lexuar dhe as që do të bënte Ai që ta mësoni ju atë. Unë kam jetuar një kohë (të gjatë) në mesin tuaj para profetësisë, a nuk po mendoni?” (Junus, 16)

KUSH MUND TË NDËRMJETËSOJË?

Ndërmjetësuesit janë disa, e ata përmenden edhe në Kuran, por sqarohen po ashtu edhe në hadithe të shumta. Koncepti *shefa’at* përdoret kryesisht në aspektin eskatologjik, por në disa raste e shohim edhe në atë botëror. Në pamundësi për t’i përmendur të gjitha rastet, po theksojmë vetëm disa kategori, pa hyrë në hollësi.

Ndër ata të cilët mund të ndërmjetësojnë te Zoti i madhërishëm, me lejen e Tij, përmenden *melekët*:

“Sa engjëj ka në qiej, ndërmjetësimi i të cilëve nuk bën asnjë dobi, veçse pasi të japë leje Allahu, për kë të dojë e të pëlqejë Vetë!” (En-Nexhm, 26)

Pejgamberët e Zotit gjithashtu përmenden si ndërmjetësues:

“Ne nuk kemi nisur asnjë të dërguar para teje, që të mos i kemi shpallur se: ‘S’ka zot tjetër përveç Meje, andaj më adhuroni (vetëm) Mua!’ Ata thonë: ‘I Gjithëmëshirshmi ka për Vete një bir (prej engjëjve)’. Qoftë i lavdëruar Ai dhe i lartësuar! Jo, ata (engjëjt) janë robër të nderuar.” (El-Enbija, 25-26)

Pas melekëve dhe pejgamberëve, përmenden si *ndërmjetësues* edhe *besimtarët*:

“Ata që u adhuruan në vend të Allahut, nuk do të mund të ndërmjetësojnë për askënd, përveç atyre që dëshmuar për të Vërtetën dhe e dinë mirë (se s’ka Zot tjetër të vërtetë veç Allahut).” (Ez-Zuhuf, 86)

Meqë çdo besimtar është dëshmues i së vërtetës, ky ajet mund të merret lirisht si ajet që ka të bëjë me ndërmjetësimin.

Një ajet tjetër i cili flet qartë për ndërmjetësimin e besimtarëve të mirëfilltë është:

“Askush nuk do të mund të ndërhyjë (për ndërmjetësim), përveç atij që ka marrë lejen dhe premtimin e të Gjithëmëshirshmit.” (Merjem, 87) meqë për çdo besimtar të mirëfilltë mund të thuhet se për Zotin është i mirë.

Gjithashtu, hadithi flet për ndërmjetësimin e Zotit, me anë të melekëve, pejgamberëve dhe besimtarëve. Hadithi që theksohet te Buhariu, i cili ka të bëjë me *shefa’atin* (ndërmjetësimin), flet pikërisht për këtë konstatim dhe e pohon atë.⁹

Madje, Allahu xh. sh., në kuadër të mëshirës dhe mirësisë së pakufishme të Allahut të madhërishëm, u lejon *myslimanëve* që nëpërmjet lutjeve dhe ibadeteve, në mënyrën qartësisht islame dhe ekskluzivisht në emër të Tij, të kërkojnë falje për veten, prindërit e tyre dhe për myslimanët e tjerë:

“O Zoti ynë, më fal mua, prindërit e mi dhe besimtarët në Ditën, kur do të jepet llogari!” (Ibrahim, 41)

NDËRMJETËSIMI I ZOTIT

Siç kemi treguar, duke u mbështetur në leksikun arab, vërejmë se domethënia e fjalës *shefa’at* është ofrimi i ndihmës nga ana e dikuajt që gjendet në pozitë më të lartë, në dobi të tjetrit që është në pozitë më të ulët e që ka nevojë për ndihmë.

Në Kuran fjala është përdorur pikërisht për këtë qëllim. Ideja e ndërmjetësimit, e cila nga një anë e përshkruan qenien e zemëruar të vendosur ta kryejë ndëshkimin, kurse në anën tjetër ndonjë lutës që lutet duke kërkuar falje për mëkatarin, kjo fotografi nuk e manifeston kon-

ceptin Kuranor për ndërmjetësimin, respektivisht konceptin islam për *shefa’atin*, sepse këtu ndërmjetësuesi i vërtetë është vetë Zoti.

Zoti nuk është i zemëruar dhe nuk është i detyruar ta dënojë mëkatarin për atë që ai ka bërë, respektivisht për atë që nuk ka bërë (siç konceptohet për shembull në krish-tërim në lidhje me të ashtuquajturin mëkati i lindjes), por Ai është i Mëshirshmi ndër më të mëshirshmit, i cili në mëshirën e Tij ndaj njerëzisë shkon aq larg sa do ta lirojë nga zjarri edhe atë që nuk ka bërë kurrë asnjë të mirë.

Së këndejmi, ndërmjetësimi i Zotit është ndihma e mëshirshme e Zotit, e cila iu mundëson mëkatarëve t’u shmangen pasojave të këqija të asaj çfarë kanë bërë, kur të gjitha mjetet e tjera do të mungojnë.¹⁰

NDËRMJETËSIMI I MELEKËVE

Për ndërmjetësimin e melekëve flitet në Kuran:

“Ata (engjëjt), që e mbajnë Fronin dhe ata që janë rreth tij, e madhërojnë Zotin e tyre me falënderim dhe i besojnë Atij. Ata lypin falje për besimtarët, duke thënë: ‘O Zoti ynë, Ti përfshin çdo gjë me mëshirën dhe dijeninë Tënde, prandaj fali ata që janë penduar e që ndjekin rrugën Tënde dhe ruaji ata prej dënimit të Zjarrit flakëruar! O Zoti ynë, shpjeri ata në kopshtet e Adnit, të cilat ua ke premtuar, së bashku me të devotshmit prej prindërve të tyre, bashkëshorteve të tyre dhe pasardhësve të tyre! Ti je i Plotfuqishmi dhe i Urti. Dhe shpëtoji ata nga e keqja! Atë që Ti e shpëton nga e keqja atë Ditë, Ti e ke mëshiruar; e ky, me të vërtetë, është shpëtimi i madh!” (El-Gafir, 7-9)

Dhe:

“Qiejt gati sa nuk çahen nga sipër (prej madhësisë së Allahut), ndërkohë që engjëjt lavdërojnë e falënderojnë Zotin e tyre dhe kërkojnë falje për ata që janë në Tokë. Me të vërtetë që Allahu është Falësi dhe Mëshirëploti.” (Esh-Shura, 5)

Lexuesi do të vërejë se në fragmentin e parë flitet për melekët sikur ata do të kërkojnë mëshirën e veçantë të Zotit për besimtarët, ndonëse baballarët, pasardhësit dhe gratë e tyre më vonë janë udhëzuar, kurse në fragmentin e dytë flitet për melekët që luten për mëshirë për besimtarët si edhe për jobesimtarët.

Kësisoj, ndërmjetësimi i melekëve është i përbashkët si për besimtarët ashtu edhe për jobesimtarët. Marrëdhënia shpirtërore ndërmjet melekëve dhe njeriut, siç shihet në kapitullin për melekët, është e atillë që ata e nxisin njeriun drejt veprave fisnike dhe të mira, melekët ndërmjetësojnë në lidhje me njerëzit që kanë bërë ndonjë vepër të mirë, pa marrë parasysh nëse ata besimtarë

9. Këtë hadith e pranon Buhariu dhe Muslimi, sipas: Muhammed Ali, ibid.

10. Sipas: Muhammed Ali, ibid.

janë të ndonjë pejgamberi apo jo.

Edhe ky lloj ndërmjetësimi ka formën e lutjes, që Zoti i madhërishtëm të dhurojë mëshirë dhe falje për krijesat e Tij.¹¹

NDËRMJETËSIMI I PEJGAMBERËVE DHE BESIMTARËVE

Mëshira e Zotit manifestohet gjithashtu nëpërmjet *shefa'atit* të Pejgamberit (a.s.). Fillet e shefa'atit të Muhamedit (a.s.) lidhen me shefa'atin e Pejgamberit të parë Adem (a.s.). Njerëzit e tij, të dërrmuar e të lodhur nga gjendja e tyre e vështirë, iu drejtuan atij për ndërmjetësim te Krijuesi. Mirëpo ai refuzoi dhe i këshilloi që ata t'i drejtoheshin Nuhit (a.s.), pejgamberit të parë të mirëfilltë dhe një prej pejgamberëve kyç, mirëpo edhe ky refuzoi. Kështu, të gjithë pejgamberët me radhë refuzuan ndërmjetësimin, deri sa kjo kërkesë arriti te Muhamedi (a.s.) me të cilin edhe u plotësua.¹²

Muhamedi (a.s.) thotë për veten:

"Unë jam ndërmjetësuesi i parë dhe i ndërmjetësuar i parë."

Po ashtu, është e gabueshme të supozohet se *shefa'ati* pejgamberik do të bëhet vetëm në Ditën e Gjykimit, apo se ai është i kufizuar me lutjen për faljen e të vdekurve.

Sipas transmetimit të Aishes (r.a.), përmendet se Muhamedi (a.s.) doli nga shtëpia dhe shkoi në varrezat e Baki el-Garkad, që t'i lutej Allahut edhe për faljen e të vdekurve. Po ashtu, përmendet edhe istigfari i Muhamedit (a.s.) në salat'ul-xhenaize.¹³

Dijetarët mendojnë se ndërmjetësimi (shefa'ati) i Muhamedit (a.s.) bazohet edhe në *ixhma'*, duke u bazuar në ajetin 5 të sures Ed-Duha apo në ajetin 79 të sures El-Isra'.¹⁴

Shefa'ati pejgamberik manifestohet edhe në ndryshimin që sjell në jetën e një populli, duke e çliruar atë nga prangat e të keqes dhe duke e udhëzuar në rrugë të drejtë. Kështu është thënë se pejgamberi i Zotit, Muhamedi (a.s.) është dërguar që t'i pastrojë njerëzit. (2, 151)

Fjala arabe për pastrim është *juzekki* dhe e ka prejardhjen nga fjala *zekka*, kuptimi burimor i së cilës është përparimi i arritur me bekimin e Zotit. Kurse pastrimi i habitshëm i botës islame, përparimi material, me-

11. Muhamed Ali, ibid.

12. Muhamedi a.s. ka thënë: "Ndërmjetësimi im do të jetë për ata që nga umeti im kanë bërë mëkate të mëdha." Sipas Tirmidhiut dhe Ebu Davudit, në: Sulejman Omer El-Eshkar, Dita e fundit, Shkup, 1421/2001, fq.151. Shih edhe faqet vijuese.

Disa autorë fuqinë e shefa'atit e përqendruan vetëm në personalitetin e Muhamedit (a.s.) kundrejt të gjithë të dërguarve të tjerë e shohin si dhunti, fuqi të Zotit fuqiplotë dhënë atij. Sipas: Nerkez Smailagic, po aty, fq. 574.

13. Krahajo Muslimin: "Nëse bashkësia myslimane prej njëqind njerëzish kryen namazin për ndonjë mysliman dhe lutet për të falje të mëkateve, kjo lutje sigurisht do të pranohet." Ibn Hanbeli në vend të numrit njëqind thekson "tre rreshta (suhuf)". Sipas: Nerkez Smailagic, po aty, fq. 574.

14. Sipas: Nerkez Smailagic, po aty, fq. 574.



ndor, moral dhe shpirtëror, është dëshmia më e qartë e *shefa'atit* të Pejgamberit të Zotit Muhamedit (a.s.). Ai është lutur vazhdimisht për mirëqenien e pasuesve të tij, kurse për duanë e tij është thënë se ka qenë "mbështetje" për ata për të cilët është lutur. (Et-Teubeh, 103) Atij gjithashtu i është urdhëruar të bëjë "istigfar" për ta, (3, 158; 4, 64; 24, 62; 47, 19; 60, 12) kurse këtu ka të bëjë, sikur edhe në rastin e melekëve, për zotimin, *shefa'atin* në dobinë e tyre.

Shefa'ati i besimtarëve është i së njëjtës natyrë. Me shembullin dhe me lutjet e tyre, besimtarët që janë në shkallë më të lartë shpirtërore ndihmojnë ata që janë në nivel më të ulët. *Shefa'ati* është theksuar shprehimisht në Kuran:

"Kush ndërmjetëson për një çështje të mirë, do të ketë pjesë në shpërblimin e saj, kurse kush ndërmjetëson për një çështje të keqe, do të ketë pjesë në ndëshkimin e saj. Allahu është i Gjithëpushtetshëm." (En-Nisa', 85). Fjala origjinale që përdoret këtu është *shefe'a*, kurse kuptimi i saj është: nëse njeriu jep shembull të mirë dhe të tjerët e marrin e nxjerrin mësim, ai do të shpërblehet për këtë.¹⁵

vijon...

15. Muhammed Ali, ibid.

Njeriu ndërmjet frikës dhe shpresës

Nivzi Zegiri

Njeriu është krijesë e Allahut xh.sh. dhe e mbikëqyrur nga Ai. Shpirti e mban njeriun në këmbë dhe për sa kohë ai gjendet në të, i zoti i tij mund të vazhdojë të marrë frymë. Shpirti është dhuratë dhe amanet prej Zotit. Ai duhet të ruhet nga të gjitha të këqijat dhe të kufizohet nga të kënaqurit e tepërt me të mirat e kësaj bote. Njëkohësisht, trajnimi i tij është i domosdoshëm, në mënyrë që të ketë frikë dhe shpresë ndaj Allahut, Krijuesit dhe Mbikëqyrësit të tij.

Allahu xh.sh. është Ai që frikën dhe shpresën i ka bërë dy poligone në të cilat njeriu bëhet gati për shijimin e të mirave të botës së amshueshme. Duke e ditur si kryhet detyra në këto poligone të veçanta, njeriu fluturon drejt të mirave të pafundme të Zotit të vet, drejt hijeve të zambakëve të xheneve të Tij. Kandidati, i cili e dëshiron parajsën duhet të kalojë nëpër shumë sfida të kësaj bote.

Njeriu duhet të ketë frikë ndaj Allahut xh.sh., me qëllim që të largohet nga të gjitha të këqijat, ngaqë "frika është kamxhik i Allahut me të cilin Ai i orienton robërit e Vet që të mësojnë dhe të punojnë, për të fituar afërsinë e Tij."¹ Duke qenë se frika është e pranishme në çdo vepër, ajo nuk lejon që trupi dhe organet e besimtarit të bëjnë vepra të shëmtuara, por i mban të bindura ndaj

1. "Deti i kthjellët i devotshmërisë dhe suptilitetit" – Ahmed FERID. Furkan ISM, 2004 – Shkup. F.316.

urdhrave të Krijuesit. Kur njeriu nuk ka frikë, ai nuk njih kufij, bëhet indiferent dhe mëkatar. Sa më shumë që njeriu të ketë frikë ndaj Allahut xh.sh., aq më shumë e njih Atë. Janë peygamberët dhe dijetarët ata, të cilët i frikësoheshin më shumë Atij. Muhamedi (a.s.) ishte betuar në Allahun xh.sh. se Atë e njih më së miri dhe se i frikësohet më shumë. Për dijetarët flasin edhe fjalët e Allahut (xh.sh.): **"...Në të vërtetë, nga robërit e Tij, Allahut i frikësohen vetëm dijetarët..."** (el-Fatir, 35/28)

Frika mund të ketë disa nivele si: frikë e pamjaftueshme, e tepërt dhe e matur ose mesatare.

Frika e pamjaftueshme e shpie njeriun deri në humbjen e madhe. Njeriu me frikë të pamjaftueshme nuk e njih mirë Zotin e vet, kështu që ka nevojë ta ndërtojë veten në suazat e ngritjes intelektuale rreth njohurive fetare, duke pasur me vete edhe bindjen ndaj Zotit. Vetëm në këtë mënyrë mund të rindërtohet frika e pamjaftueshme, për t'u shndërruar në frikë të qëndrueshme e mesatare.

Frika e tepërt shpie në dëshpërim dhe pesimizëm. E bën njeriun asket të pacak. Në këtë gjendje njeriu mund edhe ta humbë veten e tij duke mos pasur shpresë në ndihmën dhe faljen e Allahut (xh.sh.).

Frika mesatare është ajo e cila e ndërton njeriun në formën më të mirë dhe nuk i lë hapësirë ta humbë shpresën

në Allahun xh.sh., pa të cilën edhe nuk ka besim, sepse ndër emrat e Tij janë edhe El-'Afuv (Mëkatfalësi), Er-Rrahim (Mëshirëploti) etj. Njeriu me frikë mesatare e njeh më mirë Zotin e vet, i di dënimet dhe shpërblimet, mbi bazën e të cilave jeton dhe vepron sipas urdhrave dhe udhëzimeve të Tij.

Sado që të mendojmë se ia kemi frikën Allahut xh. sh. përsëri duhet të jemi të kujdesshëm, sepse Ai i njeh më së miri zemrat. Rreth kësaj Fudajl Ibn Iljadi thotë: "Kur të pyesin: A i frikësohesh Allahut?, ti mos kthe përgjigje, sepse po the se nuk frikësohesh do të konsiderohesh jo-besimtar, ndërsa po the se frikësohesh, je gënjeshtar."

Frika ndaj Allahut e sjell njeriun në binarët e së Drejtës dhe e mëson të largohet nga mëkatet e dëshiruara të dikurshme, ashtu siç largohet nga një gjë kur e kupton se ajo një ditë do ta vrasë. Ata që iu frikësuan Atij, Ai u premton pozita të larta në xhenete dhe se janë në rrugë të drejtë; u thotë se do t'i gëzojnë të mirat e Tij:

"...udhëzimet për rrugën e drejtë dhe mëshira për ata që i frikësohen Zotit të tyre." (el-A'raf, 7/154) **"...Allahu është i kënaqur me ata, por dhe ata janë të kënaqur me Atë. Kjo është dhurata për ata që e kanë frikë Zotin e vet."** (el-Bejjine, 98/8)

Pritshmëria dhe të gëzuarit e njeriut për diçka që e dëshiron, përkufizohet si shpresë. Të priturit për të mirë është shpresë e vërtetë, ndërsa fantazimi i ngjarjeve apo i gjendjeve është iluzion. Gjatë gjithë jetës së tij besimtari punon për të ndërtuar një të ardhme më të mirë, qoftë në llogarinë e tij personale ose të përgjithshme për të gjithë umetin (komunitetin mysliman). Të punuarit apo të investuarit në diçka për një qëllim të caktuar, do të thotë se puna është kryer, ndërsa suksesi është në dorë të Zotit. Meqenëse puna është kryer tani lutemi duke shpresuar që vepra të pranohet. Pra, "shpresa...është ajo në të cilën njeriu investon gjithë atë që është në mundësinë e tij të lirë, ndërsa tjetrën ia lë Allahut dhe vullnetit të Tij." - thotë Ahmed Ferid.

Shpresa në diçka nënkupton të kesh ndjenjë dashurie për atë çka shpreson, të kesh frikë që mund të mos përmbushet ajo që shpreson, arsye për të cilën duhet të përkushtohesh brenda mundësive për të kontribuar në realizimin e asaj që shpreson.

Të shpresuarit për diçka spikat më shumë me rregullin e fundit, që duhet kontribuar për të pasur të drejtë në shpresë. Rreth kësaj, Allahu xh.sh. na njofton në Kuranin Famëllartë: **"Vërtet, ata që besuan dhe ata që mërguan e luftuan në rrugë të Allahut, pikërisht ata shpresojnë në**

mëshirën e Allahut..." (el-Bekare, 2/ 218)

Allahu është Mëshirues dhe i mëshiron njerëzit; duke ditur këtë të shpresojmë në faljen dhe shpërblimin e Tij. Sikur tërë jetën të bënim vepra të mira përsëri nuk do të mund të arrinim shpërblimin që Allahu ka përgatitur për ne, andaj shpresojmë në Mëshirën e Tij, mundohemi dhe veprojmë ashtu siç na ka urdhëruar Ai. E gjithë kjo ka si qëllim që, me mëshirën dhe mirësinë e Allahut (xh. sh.), të bëhemi pjesë e Mëshirës së vetë Krijuesit. **"...e mëshira Ime ka përfshirë çdo send..."** (el-A'raf, 7/156)

Shpresa e gjatë e mbyt zemrën, e largon nga të përkushtuarit dhe puna, duke e bërë shumë të sigurt për suksese edhe nëse qëndron duarkryq. Njeriu me shpresë të tepëruar i ngjan çobanit i cili e nxjerr bagëtinë e tij prej stalle dhe kthehet në shtëpi për gjumë; fle deri në mbrëmje dhe zgjohet për t'i mjellë delet, por asnjë dele nuk do të ketë qumësht derisa nuk kullot; koha e të vjelave të tij është e thatë. E njëjta gjë është edhe me atë që shpreson gjatë dhe nuk merr guximin të veprojë, që të mund të gatitet për të dhënë llogari para Krijuesit të tij.

Duke e njohur mirë Allahun (xh.sh.), duke qenë besimtar i devotshëm, Imam Shafiu (r.a.) (Allahu e mëshiroftë), në prag të vdekjes ishte shprehur kështu me vargje:

Shpresa zemrën ma forcoi dhe medh'hebët janë të ngushtë,

Të gjitha shpresat në faljen Tënde i kam mbështetur.

Mëkatet më janë bërë të mëdha,

por, kur i krahasova me faljen Tënde, Zot,

e pashë se ajo është më e madhe se ato.

Besimtari duhet ta gjejë veten e tij mes frikës dhe shpresës; sepse pa pasur frikë ndaj Allahut xh.sh. njeriu nuk llogaritet besimtar, por mohues e kryelartë; pastaj, të mos kesh shpresë në Mëshirën e Tij do të thotë të mos i pranosh fjalët e Zotit, kur Ai i përgëzon për shpërblime të mëdha robërit e Tij; kështu ai nuk është më besimtar.

Duhet ditur se Allahu xh.sh. është Ndëshkues i reptë dhe Mëshirues i madh e Mëkatfalës. **"Lajmëroji robërit e Mi (o Muhamed) se, vërtet, Unë jam Falësi i madh, Mëshirëploti dhe se dënimi Im është vërtet dënimi i dhembshëm!"** (El-Hixhr, 49-50)



Rëndësia dhe roli i DUASE në jetën e përditshme

Mr. Zymer Ramadani

Në lidhje me këtë shtyllë, këtë ajkë dhe aromë të këndshme dhe të pathyer të besimit islam, Allahu i Madhëruar në Kuranin Fisnik thotë:

“Kur robërit e Mi (besimtarë) të pyesin për Mua, (thua ju se) Unë jam afër, i përgjigjem lutjeve të lutësit, kur ai më lutet Mua. Prandaj, le t’i përgjigjen thirrjes Sime dhe le të më besojnë Mua, për të qenë në rrugë të drejtë.”¹

Po ashtu, transmetohet nga Ebu Hurejre (r.a.), se lidhur me këtë ushqim shpirtëror të besimtarëve Pejgamberi (a.s.) ka thënë:

“Përderisa dikush nga ju nuk ngutet të thotë: Sa herë që i jam lutur Allahut, lutja – duaja nuk më është pranuar, duaja e këtij personi do të pranohet.”²

Kjo shprehje, e cila rrjedh nga gjuha arabe, ka kuptimin: thirrje, ftesë, kërkesë, ndihmë, lutje etj. Vlera dhe dobia e lutjes, është trajtuar hollësisht në shumë raste në Kuran dhe i është dhënë një vlerë e lartë. Duke u nisur nga njeriu, e njëherësh edhe nga pejgamberi i parë Ademi (a.s.), duaja ka qenë themeli kryesor i ka-

limit të tij nga një trajtë në një trajtë tjetër, ose shkak për të fituar falje nga Allahu. Në këtë mënyrë, të gjithë pejgamberët e Allahut kanë kërkuar nga Ai atë çka u nevojitej më shumë, gjë të cilën e kanë arritur vetëm përmes duase. Për shembull, Pejgamberët Nuh, Hud, Salih, Ibrahim Ismail, Ishak, Jakub etj., që të gjithë i janë lutur në forma të ndryshme Madhërisë së Allahut për ndonjë begati, ndihmë apo diçka tjetër. Në këtë rast, Nuhu (a.s.) iu lut Allahut që ta udhëzonte popullin e tij, edhe pse vetë i kishte ftuar me thirrje për plot një mijë pa pesëdhjetë vjet; Ibrahim (a.s.) i është lutur Allahut që ta falte prindin e tij Azerin; Luti (a.s.) po ashtu u lut që edhe djali i tij të mëshirohej dhe të hynte në anije së bashku me besimtarët e tjerë. Po ashtu, edhe lutja e Musait (a.s.) ishte një ndër lutjet që sipas komentuesve të Kuranit llogaritet si më e qëlluara, ngase ai iu lut Allahut që ta bënte pejgamber vëllanë e tij Harunin. Raste të ngjashme me këto i gjejmë edhe mes njerëzve të devotshëm, raste që përmenden në Kuran, si për shembull: lutja e Asijes (bashkëshortes së faraonit, e cila kishte kërkuar nga Allahu që ta mbronte nga zullumi i Faraonit e nga presionet, dhe që t’i ndërtonte një shtëpi në xhenet),

1. Bekare, 2/186

2. Buhâri, Deavât, 22; Muslim, Dhikr, 90, 91; Ebû Dâvûd, Vitir, 23. etj.

lutja e Uzejrit, i cili e luti Allahun që ta bënte të kup-
tonte se si Allahu i ringjall të vdekurit dhe t'i hapeshin
sytë plakës së moshuar që jetonte në shtëpinë e tij, lut-
ja e Merjemes për shfaqjen e ndershmërisë së moralit
të saj, pastaj lutjet e Llukmanit, lutja e As'hâbu'l-Kehf
(Shokëve të Shpellës Kehf) etj.

Ajeti në fjalë kërkon nga çdo besimtar i drejtë që t'ia
drejtojë lutjen vetëm Allahut, sepse përveç Tij askush
tjetër nuk mund t'i përgjigjet dhe t'i shkojë në ndihmë
nevojtarit. Në të njëjtën kohë, vërejmë se ajeti në fjalë
po ashtu hedh poshtë çdo njeri tjetër, duke treguar se
përveç Allahut, të gjitha lutjet e tjera janë të kota dhe
në humbje. Po ashtu, edhe Muhamedi (a.s.) bën ko-
mentimin e këtij ajeti përmes hadithit ku thuhet se,
nëse besimtari e drejton lutjen tek Allahu dhe nuk e
humb shpresën për pranimin apo mospranimin e saj,
lutja e tij do të pranohet me lejen e Allahut në po atë
mënyrë siç e ka kërkuar lutësi.

Kuptimet e lutjes nga këndi Kuranor:

Kur shikojmë ajetet kuranore, të cilat flasin rreth kë-
saj çështjeje, vërejmë se duaaja - lutja shfaqet në disa
kuptime, çdonjëra prej të cilave forcon dhe plotëson
tjetrën.

Të gjitha këto kanë si qëllim që t'ia bëjnë të ditur
sa më lehtë besimtarëve rëndësinë që kanë tek Allahu
(xh. sh.):

1. *Lutja në kuptimin e ibadetit - adhurimit: - “Përveç
Allahut, mos iu lut tjetërkujt nga ata që nuk të sjellin as
dobi, as dëm...”*³

2. *Lutja në kuptimin e kërkesës së ndihmës: - “dhe thir-
rni (për ndihmë) dëshmitarët tuaj”*⁴

3. *Lutja në kuptimin e ftesës: - “Ditën, kur Ai do t'ju
thërrasë e ju do t'i përgjigjeni Atij duke e falënderuar
dhe do të mendoni se në këtë jetë, nuk keni qëndruar
veçse pak kohë.”*⁵

4. *Lutja në kuptimin e përgjigjes: - “Zoti juaj ka thënë:
Më thirrni Mua, Unë ju përgjigjem..”*⁶

5. *Lutja në kuptimin e thirrjes: - “Thuaj: “Thirrni
Allahun ose thirrni të Gjithëmëshirshmin, me cilindo
emër që ta thirrni ju Atë, Ai ka emrat më të bukur....”*⁷

Në jetën e përditshme të myslimanit, duaaja është ajo
që duhet të zërë vend më shumë në veprat dhe fjalët e
tij. Për këtë shkak, dijetarët myslimanë e kanë llogari-
tur duanë si një nga shtyllat e ibadetit. Sipas thënies së

3. Jûnus, 10/ 106.

4. Bekare, 2/23.

5. Îsrâ, 17/52.

6. Gâfir, 40/60.

7. Îsrâ, 17/ 110.



Pejgamberit (a.s.), duaaja është vetë ibadeti dhe thelbi i
tij.⁸ Në këtë mënyrë, Pejgamberi (a.s.) është munduar
gjatë jetës së tij që t'ua bëjë të ditur këtë myslimanëve
dhe t'i nxisë ata që të jenë të lidhur sa më ngushtë me
Krijuesin përmes lutjes, sepse duaaja është çelësi i më-
shirës. Në lidhje me rëndësinë dhe dobinë që ka duaaja,
në shumë hadithe ka porositur kështu:

***“Kërkoni shumë gjëra nga Allahu, sepse Ai krenohet
kur ju kërkoni diçka nga Ai.”***⁹

***“Duaja është ajo që pengon caktimin dhe bamirësia e
zgjat jetën.”***¹⁰

Duhet kuptuar se duaaja nuk mjaftohet vetëm me le-
ximim apo këndimim e disa lutjeve ditore, pa i futur ato
në jetën praktike të përditshme. Nëse në një dua nuk
ka realitet të veprës, atëherë ajo është e kotë dhe i për-
ngjan ilaçit që blihet por nuk përdoret. Nga ana tjetër,
kur besimtari kërkon ndihmë nga Allahu dhe mendo-
het të fitojë nga begatitë e kësaj bote, porse rruga që ai
ndjek është e ndaluar, atëherë lutja e tij është e pakup-
timtë, gjë që e hidhëron edhe Allahun (xh. sh.). Pra,

8. Tirmidhi, Deavât, 1/3371.

9. Tirmidhi, Deavât, 1/3571

10. Tirmidhi, Kader, 6; İbni Mâxhe, Mukaddime, 10. etj.

"O ju që besuat, përgjigjuni Allahut dhe të dërguarit kur ju ftojnë për atë që ju jep jetë, (për fenë e drejtë), dhe ta dini se Allahu ndërhyt ndërmjet njeriut dhe zemrës së tij, dhe se ju do të tuboheni te Ai."

duaia e një personi që merret me shitjen, përpunimin e alkoolit, apo që vepron ndonjë nga ndalesat tjera, nuk do të pranohet. Shijen dhe kuptimin më të mirë kësaj çështjeje ia jep ky hadith i Pejgamberit (a.s.): **"Dikush orvatet - udhëton shumë në emër të Allahut, dhe duke qenë në një gjendje të rëndë, i pluhuros, i rraskapitur hap duart dhe i lutet Allahut duke thënë: O Allah!... Mirëpo ngrënia, pirja dhe ushqimi i tij është haram. E si të pranohet duaia e tij?"**¹¹ Nga ky hadith kuptojmë se kushti për t'u pranuar duaia është pasja kujdes në fitimin e pasurisë, në ngrënien e ushqimit etj.

Duke pasur një jetë të larmishme dhe me shumë programe ditore, njeriu në shumë raste mund të futet në gabime dhe të veprojë gjëra që janë në kundërshtim me moralin njerëzor, ose thjesht të kryejë ndonjë veprim që nuk e preferon Islami. Për këtë shkak, Allahu i Madhëruar ua ka lënë myslimanëve dyert e hapura që t'i eliminojnë përmes lutjeve të ndryshme ditore këto gabime të paqëllimta, që në fund të kërkojnë pendim tek Ai. Nuk bën dallim nëse lutësi është mashkull apo femër, fëmijë apo i rritur, i ri apo plak, i pasur apo i varfër. Të gjithë janë të njëjtë para Allahut, gjë që do të thotë se shpërblimi për lutjet e bëra nuk do jetë sipas pozitës dhe pasurisë së tyre, por sipas devotshmërisë dhe sinqeritetit të lutësit. Gjëja më e mirë që duhet të bëjë besimtari në jetën e tij, është që nevojat dhe kërkesat t'ia drejtojë në mënyrë të drejtpërdrejt vetëm Allahut dhe askujt tjetër. Ai duhet të ketë kujdes në adhurimin dhe lutjet e tij, sepse po u lut dhe po mbeti me shpresë ndaj dikujt tjetër përveç Allahut, atëherë përveç se nuk i pranohet duaia, ai do të meritojë edhe ndëshkimin. Allahu xh. sh. ka lidhje të drejtpërdrejtë

me njeriun dhe Atij asgjë nuk i mbetet sekret. Ai e di atë që veprohet haptazi dhe fshehurazi, prandaj ai është më afër robit se gjithçka tjetër që ka. Në këtë kontekst Ai thotë:

"O ju që besuat, përgjigjuni Allahut dhe të dërguarit kur ju ftojnë për atë që ju jep jetë, (për fenë e drejtë), dhe ta dini se Allahu ndërhyt ndërmjet njeriut dhe zemrës së tij, dhe se ju do të tuboheni te Ai."¹²

Ajeti tjetër, i cili e detajon edhe më tepër përgjigjen e lutjes së besimtarit, thekson edhe dënimin për ata që i luten tjetër kujt përveç Tij: **"Zoti juaj ka thënë: Më thirrni Mua, Unë ju përgjigjem, e ata që nga mendjemadhësia i shmangen adhurimit ndaj Meje, do të hyjnë të nënçmuar në Xhehenem."**¹³

Klasifikimi i lutjeve në literaturën islame:

Pasi cekëm se lutja - duaia është një ndër themelet e rëndësishme në jetën e përditshme të besimtarëve, se ajo mund të ndërrojë caktimin e lig të njeriut, se ajo është çelësi i mëshirës etj., vlen të theksohet edhe vlera dhe rëndësia që dijetarët islamë i kanë dhënë asaj.

Me kalimin e Pejgamberit (a.s.) në botën e ahiretit, udhëheqja e rendit të islamit mbeti tek shokët e tij, respektivisht filloi me Ebu Bekrin (r.a.). Në këtë mënyrë gjenerata e parë ishte më e përpiktë ndaj zbatimit të asaj që porosiste Pejgamberi (a.s.), mirëpo me kalimin e kohës, u ndie nevoja për kompletimin e thënieve të Pejgamberit (a.s.) në një vend të veçantë, ashtu që myslimanët të informoheshin sa më lehtë në lidhje me zbatimin e fesë islame. Në këtë mënyrë, dijetarët e ndryshëm u përkushtuan pas klasifikimit të thënieve - haditheve të Pejgamberit (a.s.), ku përfshihej edhe klasifikimi i lutjeve - duave që kishte bërë Muhamedi (a.s.). Në kohën kur ishte gjallë. Duke filluar nga muhaddithinët - dijetarët e shkencës së hadithit, me në krye Imam Buhariun (810-870), i kanë dhënë nga një kapitull të veçantë vlerës së duave - lutjeve në koleksionet e tyre dhe i kanë emëruar (*kapitulli mbi duatë, lutjet e mëngjesit dhe mbrëmjes etj*). Ata kanë tubuar të gjitha lutjet e bëra nga Pejgamberi (a.s.), qoftë gjatë kohës kur ishte në Meke apo Medine, qoftë kur ndodhej në vende dhe rrethana të ndryshme. Mes librave në të cilat janë tubuar lutjet e Muhamedit (a.s.) si më i njohuri është libri i Imam Neveviut (613-676) **"Kitabu'l-Edhkâr"**.

Si shembull më konkret, në kohërat tona kemi edhe lutjet që bëhen gjatë ritualeve fetare në xhamitë dhe shtëpitë tona. Siç dihet, në fund të çdo namazi bëhet

11. Muslim, Zekât, 65; Tirmidhi, Tefsiru'l-Kurân, 3.

12. Enfâl, 8/24.

13. Gâfir, 40/60.


lutja në mënyrë kolektive, po ashtu në mënyrë kolektive bëhet edhe lutja e ushqimit, lutja e ndërtimit të ndonjë shtëpie, lutja e martesës, duaaja e leximit të Kuranit (hatmes), duaaja që bëjmë kur nisemi në udhëtime të ndryshe, duaaja nëpërmjet së cilës falënderojmë Allahun për dhunti apo për ndonjë begati të ndryshme, duaaja e prerjes së kurbanit, duaaja në namazin e vitrit, lutjet që këndohen në hutben e xhumasë etj. Arsyet se pse këto lutje bëhen në mënyrë kolektive mund të jenë të ndryshme, mirëpo ajo që vlen të theksohet është: duke qenë se shumica e njerëzve nuk e njohin lëmin fetare, imami apo dikush tjetër që ka njohuri fetare prin në lexim - këndimin e lutjeve ditore në namaz, apo në një rast tjetër. Në një pikëpamje, kjo ndikon edhe në mësimin e lutjeve nga xhemati dhe nga të pranishmit që i dëgjojnë.

Nëse ndalemi dhe shikojmë nëse Pejgamberi (a.s.) i ka bërë lutjet haptazi apo kolektivisht, do të hasim në mënyra të shumëllojshme të bërjes së lutjeve. Ai (Allahu e mëshiroftë) ndonjëherë i ka bërë lutjet në heshtje, ndonjëherë me zë, e ndonjëherë tjetër edhe në tubime të ndryshme - në mënyrë kolektive. Të gjitha këto mënyra ia lehtësojnë besimtarit mësimin dhe praktikimin, e në të njëjtën kohë e ndihmojnë edhe në afrimin e tij me Krijuesin, duke marrë si shembull mënyrat e lutjes së Pejgamberit (a.s.). Por duhet të dimë se lutjet e Muhamedit (a.s.) kanë qenë përherë korrekte dhe gjithmonë janë pranuar, në dallim nga lutjet e besimtarëve të tjerë që ndodh edhe të mos pranohen.

Më tej, Allahu i Madhëruar i përgëzon besimtarët duke u treguar se çdo vepër të mirë që ata bëjnë ka për t'ua shpërblyer me dhjetëfishin e saj, por dhe u tërheq vëmendjet dhe shikimet atyre, që të mos e humbin shpresën në Allahun. Në këtë kontekst, i Lartmadhërishti kërkon përsëri nga besimtarët që, edhe pse të zhytur në mëkatet, të drejtohen nga Ai përmes lutjeve, duke thënë:

“Thuaj: O robërit e Mi, të cilët e keni ngarkuar me shumë gabime veten tuaj, mos e humbni shpresën ndaj mëshirës së Allahut, pse Allahu i fal të gjitha mëkatet, Ai është që fal shumë dhe është mëshirues!”¹⁴

Që lutjet të jenë të pranuar, kërkohet që ato t'i drejtohen vetëm Allahut, që lutësi të mos i bëjë ato sa për sy e faqe, që ai të ruhet nga mëkatet tjera, të mos fusë dikë tjetër mes lutjes dhe Allahut. Preferohet që lutja të bëhet në kohët që ka caktuar Pejgamberi (a.s.) si: në pjesën e tretë të natës, në mes të ezanit dhe na-



mazit, në mes të ezanit dhe hutbes së xhumasë, para perëndimit të diellit, gjatë udhëtimit, gjatë muajit të ramazanit, vizitës së Qabes etj. Të gjitha këto ndikojnë që Allahu të tregojë mëshirë ndaj robit të Tij dhe t'ia pranojë lutjen.

Në këtë mënyrë, gjatë çdo ulje të namazit, të gjithë besimtarët kërkojnë mbrojtje nga Allahu, begati dhe falje të prindërve, duke lexuar ajetin: ***“Zoti ynë na jep të mira në këtë jetë, të mira edhe në botën tjetër, dhe na ruaj prej dënimit me zjarr!”***¹⁵

Po ashtu, ndikim të madh do të ketë edhe leximi i ajetu'l-kursijj dhe ajeti:

“Zoti ynë, mos na i lako zemrat tona pasi na drejtove, na dhuro mëshirën Tënde, pse vetëm Ti je dhuruesi i madh”. “Zoti ynë Ti je ai që në një ditë do t'i tubosh njerëzit, ditë që për të cilën nuk ka dyshim. Allahu nuk shkel premtimin e vet.”¹⁶

14. Zumer, 39/54.

15. Bekare, 2/201.

16. Ali İmran, 3/8, 9.



Çdo shtëpi është një fole virtyti

Xhafer Durmush

Ajete të shumta në Kuranin e Madhërueshëm na bëjnë të ditur se shtëpitë janë një vatrë paqeje dhe qetësie. Dashurinë e ndërsjellë dhe respektin, Islami e shikon si bazë themelore në marrëdhëniet njerëzore. Drejtësia, virtytet, mirësjellja, janë cilësi që i japin njeriut formën e tij njerëzore. Mjafton të shikoni suret Ahzab dhe Nur dhe në të dyja do të ndjeni intensivisht aromën e kohës së lumturisë, do ndjeni emocionin e shtëpisë si një liman urtësie...

Veprimtaritë tona ditore sociale, në një farë mënyre na lodhin dhe zemra jonë fillon të mbushet me njollat e mëkatit, sytë tanë ndoten dhe ne kemi vështirësi për të ruajtur duart, fytyrën, veshët dhe gjuhën tonë.

Mirëpo, deri në ç'masë mundohemi ta rregullojmë socialitetin brenda familjes?

Ne jemi përgjegjës për drejtimin e një jete të shëndoshë, por sa përpiqemi t'i rregullojmë marrëdhëniet me mirësjellje, ashtu si porositet edhe në ajetet kuranore e në hadithet profetike?

Po të donim, do të mund t'i rilindnim çdo mëngjes ndjenjat e shquara të moralit Islam.

Këtë besim na e përforcon dhe ajeti kuranor, që thotë se: Kurani i Madhërueshëm e mbron jetën e atij që ia hap zemrën, e mëson të ecë me kulturë, të përmbajë zërin e tij, të kontrollojë shikimet, të japë përshëndetjen,

të kërkojë leje, të respektojë të ndaluarën. Dhe atij që e harron këtë, ia kujton sërish. Libri ynë hedh dritë mbi ato tema që shumë njerëz i pandehin si tabu.

Në suren Nur, në ajetet që na ndriçojnë mendjen, thuhet: **"...Kur të hyni në shtëpi, të përshëndetni njëri-tjetrin me përshëndetje të mirë e të bukur nga Allahu..."** (en-Nur 24/61)

Kur lexojmë këtë ajet, mendimi që Islami i jep vlerë njeriut na bën të ndihemi mirë: Mendoni që Libri Ynë i Madhërueshëm na këshillon që të komunikojmë me njëri - tjetrin. Kur të hyni në shtëpinë e myslimanit, fjala e parë që duhet të thoni pasi t'ju jepet selam, është t'ia ktheni me të njëjtën mënyrë...

Dhe kur të mos keni ç'të thoni, më e mira është ta stolisni atë me fytyrë të qeshur dhe fjalë të ëmbël. Kjo është një fushë ku mund t'i nxirrni në pah të gjithë mirësitë.

Kjo do të thotë se "Paqja qoftë mbi ju" nuk është një shprehje e thjeshtë, por do të thotë të ndash lutjen për mëshirën dhe begatinë e Allahut. Prandaj, me qëllim që të kenë një dialog të mirë, të gjithë myslimanët duhet të jetojnë sipas traditës profetike.

Po ta dinim vlerën e kësaj, fundi i çdo bisede që fillon me fjalën e Allahut do të ishte plot dobi. Energjinë negative që mund të harxhojmë në fusha të ndryshme, mund ta shlyejmë me begatinë e selamit. Lutjes që be-

simtari bën për besimtarin, engjëjt i përgjigjen me amin, kështu që vetëm me lutje të ndërsjella mund të shtohet qetësia e shtëpisë sonë.

Pejgamberi ynë thotë: *“Kur të hyni në shtëpitë tuaja, jepni selam, që të shtohet begatia.”* Madje ai na porositi që edhe në një shtëpi ku nuk ndodhet njeri duhet të jepet selam me fjalët: *“Paqja qoftë mbi ne dhe mbi adhuruesit e mirë të Zotit.”*

Dhe përgëzon duke thënë së engjëjt e marrin këtë selam.

Ky hadith profetik sprovon në zbritjen e parë të vahjit nënën tonë Hz. Hatixhen, duke zbuluar një pjesë nga mbulesa e kokës, për të parë nëse ai që vinte ishte engjëll apo jo. (shih: Ibn-i Hisham, I, 257-258) Këtë ide mund ta përmbledhim kështu: nëse veshja jonë, të folurit tonë, të ngrënët dhe të pirët bëhet brenda kufijve të moralit Islam, engjëjt e mëshirës janë bashkë me ne në shtëpitë tona.

Është e qartë se ajetet Kuranore e ndalojnë përgojimin në një mjedis të tillë. Do të kujtojmë se duhet të largohemi nga veprat e këqija, duhet të përpiqemi të rrimë larg thashethemeve. Çdo njeriu i është caktuar një engjëll, i cili frymëzohet për çdo gjë - e mirë apo e keqe - që thotë ai në lidhje me të tjerët.

Shprehja *“Paqja qoftë mbi ju”* na çon në një mjedis të tillë. *“Atë Ditë që do të dëshmojnë kundër tyre gjubët, duart dhe këmbët e tyre për çfarë kanë bërë”* (en-Nur 24/24) dhe para çdo gjëje vetëm duke mbrojtur zemrën mund të arrijmë gradën më të lartë qiellore.

Në ajetet kuranore që urdhërojnë të mbrojmë shikimet tona, thuhet: *“(O Muhammed alejhiselam!) thuaju besimtareve dhe besimtarëve të ruajnë shikimet e tyre (prej haramit).”* (en-Nur 24/30-31) D.m.th. shprehja që zemrat të jenë të kulluara është e lidhur me ruajtjen e shikimit (nga haramet). Mbrojta e zemrës fillon me ruajtjen e shikimeve.

Mendoni se hollësia e këtyre ajeteve na kujton se duhet të tregojmë mirësjellje ndaj njëri-tjetrit. Dhe duhet pasur parasysh që këtë edukatë duhet ta transmetojmë të fqinjët, në rrugë, në punë etj. Sa fillim i mirë do të ishte që këto vlera të bukura të mos humbitnin e të zhdukeshin, por të ringjallehin...

Në suren Ahzab, rrëfimet mbi thjeshtësinë e klimës profetike duhet t'i transmetojmë në shtëpitë tona. Duke lexuar këtë sure të shenjtë, vërejmë sërish që idhujtarët e kuptuan shpejt se lartësimi i Islamit nuk ishte i lidhur me fuqinë materiale. Kuptuan se myslimanët korrën sukses në çdo fushë vetëm falë karakterit të tyre të shëndoshë dhe cilësive të larta morale.

Në këtë mënyrë, duhet të transmetojmë në zemrat dhe shtëpitë tona këshillën e ajeteve në kaptinën e nderuar, që myslimanët duhet të jetojnë me virtyte e të zotërojnë

ndjenjën e turpit, gjë që përbën boshtin kryesor të përgjigjes që duhet t'i jepet mohuesve. Edhe gratë e pejgamberit udhëzohen të mos e këmbëjnë lumturinë e përjetshme me jetën dhe të mirat e kësaj bote. Ky udhëzim duhet të jetë kuptimplotë për ne.

Pastaj, nënave të besimtarëve u thuhet: *“O gratë e Pejgamberit! Në shtëpitë tuaja uluni me dinjitet”, “kujtoni urtësinë dhe ajetet e Allahut, që lexohen në shtëpitë tuaja...”* Vazhdimin e ajetit duhet ta lexojmë më me kujdes, sepse më pas përmendemi edhe ne së bashku me ato. Nëpërmjet grave të besimtarëve, na tërhiqet vëmendja të gjithëve.

“O Profet, thuaju grave dhe vajzave të tua, si dhe grave të besimtarëve, që të lëshojnë mbulesën e tyre (të kokës) përreth trupit...” (Ahzab 33/59) Do ishte mirë që kuptimet e këtyre fjalëve t'i varnim në vendin më të bukur të shtëpisë sonë. Dhe sa e dobishme do të ishte që këtë këshillë mirëdashëse ta mbanim gjithmonë parasysh...

“Uluni në shtëpitë tuaja me urtësi”. Nëse do të mendojmë se për çfarë na flet ky udhëzim... duhet të kuptojmë që, sikur të merrnim një pjesë nga urtësia e nënave tona në të ulur, në të ecur, në të veshur, në të folur, gjëra të cilat i përmendëm më sipër me respekt, sikur të përqafojmë cilësitë morale dhe besimin e tyre, vetëm kështu do të fitonim dashurinë e Pejgamberit (a.s.).

Në suren Nur, ku urdhërohet: *“Kur fëmijët tuaj të arrijnë moshën e pubertetit, le të kërkojnë leje, ashtu siç kanë kërkuar leje ata para këtyre...”*, (shih: Nur 24/59) theksohet fakti se respekti për të ndaluarën lipset të mësohet në kohën e duhur.

Duke u bazuar në ajetet e mësipërme, kuptojmë se fëmijëve duhet t'u mësohen që në moshë të vogël rregullat e hyrje daljeve pranë njerëzve më të afërt. Fëmija duhet të njihet me edukatën e mirë Islame përpara se të ketë arritur moshën e pjekurisë. Për këtë arsye, të mirat që na ofron morali Islam përqafohen me dashamirësi nga myslimanët. Dhe kjo fillon me dashurinë dhe respektin për të afërmit me të cilët ai banon nën një çati.

Ka një fjalë të urtë që thotë: *“Dëgjova - harrova, pa-shë - kujtova, bëra - mësova”.* Kjo na bën të mendojmë se si fillim morali Islam duhet mësuar dhe praktikuar në mjediset më të ngushta.

Që sjelljet e mira të vendosen në natyrën njerëzore dhe të shndërrohen në zakon, nevojitet një punë e durueshme. Ringjallja e mirësive të Islamit, si virtyti, ndjenja e turpit, fjala e mirë, fytyra e qeshur, ndershmëria, përbëjnë kushtin që pikësëpari të fillohet nga shtëpia. Vetëm nëse do ta mbrojmë me fanatizëm këtë gjë, do të mund të fillojmë të shpresojmë në përsosmërinë e familjes dhe të shoqërisë.

Urat e jo muret

Abdullah Hoxhiq

Kur shihnim me entuziazëm rrënimin e murit të Berlinit (1989), shpresonim se do të hynim në një epokë më të sigurt, më të qetë, dhe se do të jetonim në një botë plot harmoni, në të cilën do të dilte në pah bashkëjetesa, paqja, dashuria, një botë në të cilën të gjithë do t'i përkisnin familjes njerëzore globale me të tëra nuancat. Nga fundi i shekullit të dytë dhe fillimi i shekullit të tretë shpresonim për një jetë më të mirë, më normale dhe më me kuptim. Mjerisht, pas më shumë se njëzet vjetësh, shpresat tona u shndërruan në ëndërra dëshpëruese dhe në iluzione të zbrazëta.

Allahu i madhërishëm në Kuranin Fisnik urdhëron:

“O njerëz! Në të vërtetë, Ne ju krijuam ju prej një mashkulli dhe një femre dhe ju bëmë popuj e fise, për ta njohur njerëtitjetrin. Më i nderuari prej jush tek Allahu është ai që i frikësohet më shumë Atij. Vërtet, Allahu është i Gjithëdijshtëm dhe për Atë asgjë nuk është e fshehtë.” (El - Huxhuratë, 13)

Po ashtu, citojmë edhe versetin:

“Në të vërtetë, besimtarët janë vëllezër, andaj pajtojini vëllezërit tuaj midis tyre dhe kijeni frikë Allahun, në mënyrë që ju të mëshiroheni.” (El - Huxhuratë, 10)

Por tani ka gjithnjë e më shumë luftëra, konflikte, dhunë, retorikë nxitëse, keqpërdorim të demokracisë, padrejtësi, varfëri, mjerim, përmytje natyrore të cilat

njeriu i shkakton me lakminë e pangopur, ka urrejtje të madhe, xheloz, zili. E të gjitha këto janë MURE, mure që të gjithë ne duhet t'i rrënojmë, pa marrë parasysh çfarë jemi dhe kush jemi.

Zoti i madhërishëm na ka krijuar të ndërtojmë ura, si ato materiale ashtu edhe ato shpirtërore, ura miqësie mes gjithë njerëzve të këtij planeti të vogël, që mezi dallohet në Rugën e Qumështit, pa folur pastaj për kozmosin e pafund.

Kur Toka është kaq e vocërr, çfarë jemi ne?

Të gjitha llojet e mureve dhe barrierave mes njerëz-

“Në të vërtetë, besimtarët janë vëllezër, andaj pajtojini vëllezërit tuaj midis tyre dhe kijeni frikë Allahun, në mënyrë që ju të mëshiroheni.”

(El - Huxhuratë, 10)

ve, mes popujve, feve, ideologjive dhe shteteve, janë turp dhe nënçmim për mendjen e shëndoshë, shpirtin e pastër dhe tërë botën e civilizuar. Bukur ka thënë dikush, që të gjithë muret janë të këqija e të gjitha urat janë të mira. Urat lidhin, muret ndajnë.

Ndërsa njerëzve u duhet afrim, lidhje e takime dhe jo ndarje. Të urtë janë ata që lidhin e nuk ndajnë, siç janë të mençur ata që rrënojnë mure dhe ndërtojnë ura.

Ja pse është turp që regjimi sionist në Palestinë ka ndërtuar tashmë murin masiv me gjatësi 400 km dhe më shumë se 8 m lartësi. Edhe më turp është ngritja e murit mes Gazës dhe Egjiptit, e vetmja portë shpëtimi për palestinezët e vuajtur, mur i cili arrin deri 18 m lartësi!

Allahu Ekber!

Pra, muri i dikurshëm i Berlinit është lojë në krahasim me këtë.

I Dërguari i Allahut, Muhamedi (s.a.v.s.), ka thënë të vërtetën: *“Askush prej jush nuk është besimtar, përderisa nuk i dëshiron vëllait të tij atë që dëshiron për vete.”* Ndërsa ai i cili i shërben Zotit, duhet t’u shërbejë krijesave.

Të dashur dhe të nderuar miq, atëherë le të ndërtojmë ura dhe të rrënojmë mure e barriera. T’i pastrojmë zemrat dhe shpirtrat tanë, ta ndriçojmë mendjen me dritën e Zotit dhe të marrim vendim që të afrohem njëri me tjetrin.

Të dalim nga shikimet e ngushta dhe të përfshihemi në botën e gjerë të Zotit. T’i rrënojmë barrierat, t’i shërojmë plagët e zbukurojmë jetën tonë dhe jetën e të tjerëve.

A është e mundur të kënaqemi me begatitë e Allahut dhe me bukuritë e dynjasë, e në të njëjtën kohë të bëjmë sehir vuajtjet e të tjerëve, kushdo qofshin ata?

Kur kemi një Zot, një Krijues, dhe kur gjithë ne jemi krijesat e Tij, atëherë të mos tu mëshojmë shumë kundërshtive duke u ndarë në Ne dhe Ata. Ekziston vetëm Ai dhe ne, e të gjithë kemi të drejtë të kemi identitete dhe kultura të ndryshme.

Çdo person është i ndryshëm, sikurse dhe ti. Çdo-njëri është i rëndësishëm dhe secili prej nesh mund të bëhet ndërtues urash dhe rrënues muresh. Dhe për këtë nuk nevojiten të holla. Duhet pasur vetëm qëllim



të sinkertë që të ndihmojmë të tjerët, t’i pajtojmë ata që janë në konflikt, t’i ngushëllojë të mjerët. Pra duhet t’i japim përparësi njohjes dhe jo largimit, hapjes dhe jo tërheqjes.

Një mijë vjet më parë, Ebu Rejhan El-Biruni (973-1048), një gjeni universal i arsimimit enciklopedik, ka udhëtuar deri në Indi për të studiuar hinduizmin, duke u bërë kësajsoj urë mes botës hinduse dhe civilizimit islam. Edhe pse rridhte nga një familje e pasur dhe me nam, el-Biruni i mirënjohur shkoi në Indi nën rrëzën e Himalajeve, duke kërkuar të mësonte hinduizmin nga klerikët hindusë në faltore hinduse. Në vend të pagesës në të holla, ai punoi në faltore duke bërë gjithfarë punësh që i caktoheshin. Për plot dyzet vjet shërbeu e mësoi dhe si rrjedhojë e kësaj përvoje shkroi veprën “Libri mbi Indinë”.

Në këtë mënyrë kanë ndërtuar njerëzit e mëdhenj ura mes feve, kulturave dhe qytetërimeve. Kjo është arsyeja pse u bënë të njohur dhe na duket sikur jetojnë edhe sot. Ata që ngritin mure e rrënojnë ura, do të



zhduken nga skena me vetë vdekjen, e nëse përmenden, përmenden vetëm për të keq.

Të nderuar miq, në kontekstin e temës sonë, ju ofroj një tregim fantastik për dy vëllezër që kanë jetuar gjatë në harmoni dhe në dashuri.

Këto dy vëllezër jetonin në fshat, duke punuar bashkërisht në harmoni të përkryer dhe në mirëkuptim.

Por një ditë ata u kacafytën mes tyre, dhe kjo ishte zënka e tyre e parë pas dyzet vjet pune të përbashkët në bujqësi. I kishin të përbashkëta veglat e mjetet e punës, ndërsa të lashtat dhe frutat i ndanin bashkërisht në pjesë të barabarta. Konflikti mes tyre, i cili ndodhi për shkak të mosmarrëveshjes triviale, erdhi duke u rritur. U shkëmbyen fjalë të hidhura dhe akuza të rënda, të cilat shkaktuan ndasi shumë mujore dhe ftohje të plotë të marrëdhënieve.

Një mëngjes, dikush trokiti në derën e vëllait të madh. Ai pa një njeri të panjohur, i cili i tha:

-Kërkoj punë për disa ditë. Mund të bëj shërbime të vogla në fushë.

-Po, i tha vëllai i madh. Kam punë për ty. Shiko në fund të atij kanali. Aty jeton fqinji im, vëllai im i vo-

gël. Vëllai im i ka ndërruar drejtimin ujit, gjë e cila më ka hidhëruar së tepërmi, kështu që unë kam përgatitur për të ndëshkimin që meriton! I sheh ata gurë, merri dhe ndërto një mur me lartësi dy metra, në mënyrë që mos ta shoh vëllanë më kurrë.

I huaji tha:

-E kuptova situatën.

Vëllai i madh ia siguroi punëtorit tërë materialin e nevojshëm dhe shkoi në qytet për disa ditë, për të kryer disa punë. Kur u kthye te prona e vet vuri re që mjeshtri e kishte kryer punën e tij. Megjithatë mbeti habitur nga ajo që i zunë sytë. Në vend që të bënte murin e lartë dy metra i cili do ti ndante dy vëllezërit, mjeshtri kishte ndërtuar një urë të bukur.

Në këtë çast, vëllai i vogël erdhi me nxitim tek vëllai i madh, duke i thënë:

-Ti je njeri i mrekullueshëm! Pas gjitha atyre që të kam bërë, ti ndërtove një urë! Me të vërtetë që unë krenohem me ty!

Pas këtyre fjalëve, e përqafoi. Dhe ndërsa dy vëllezërit pajtoheshin, njeriu i panjohur po përgatitej të largohej.

Ata i thanë:

-Qëndro, sepse ne kemi shumë punë për ty.

Njeriu u përgjigj:

-Do kisha dëshirë të qëndroja, por më duhet të shkoj, sepse kam shumë ura të tjera për të ndërtuar.

Të bëhemi të gjithë, burra dhe gra, të gjithë bano-rët e Tokës, prej atyre që ndërtojnë ura mes vëllezërve dhe mes të gjithë njerëzve.

Të bëhemi ndërtues të asaj që është e dobishme, pra ura që bashkojnë dhe pajtojnë, e jo mure që ndajnë. Të punojmë për t'i pajtuar ata që janë në konflikt, në mënyrë që Allahu i madhërishtëm të na bekojë dhe të pranojë çdo urë që ndërtojmë, çdo mendim të mirë, çdo fjalë të bukur dhe çdo vepër të dobishme.

Allahu i madhërishtëm qoftë i kënaqur me ne, e ne me Atë, dhe le t'i shpërblejë pa masë ata që e lexojnë këtë dhe ua shpërndajnë tjerëve, ndërsa mua, robit të varfër të Allahut, të më përkujtojnë me lutje.

Përktheu dhe përshtati:
Prim.dr.med.sc. Ali F. Iljazi

...Shkeputur ditarit!

...dhe nuk munda, nuk doja të ndahesha nga ai takim aq i afërt! E ndjeva të më ngjitej me këmbëngulje në hojëzat e mushkërive një aromë që e njihja para se të isha ngjizur njeri. Nuk doja të ndahesha prej atje...nuk munda...! Mu aty për herë të parë mu bashkuan dy gjysma të një së tërë..., mu aty për herë të parë ndjeva të më rrihte një zemër e plotë! Mu aty, më pranë se asnjëherë Zotit tim, putha me mall kockërriza rëre...dhe Zotin e kam dëshmitar; mu aty për herë të parë dëshirova të jem një kockërrizë rëre që pati puthur gjurmën Tënde!

Sa më kishtë marrë malli...

Sot diçka ndryshe e ndjeva të më digjte vaji në grykë, e kuptova se nuk mund të quhem ndryshe veçse një fukara që pret t'i falin një sexhadë të shtrirë në tokën Tënde, një sexhadë që mbart ato kockërriza krenare rëre që të patën puthur këmbët...Dhe sot diçka ndryshe të ndjeva në brendësinë time të varfër...

Ardhja Jote pati ftuar ecejaket e beharit...dhe dielli për të parën herë ngrohu si yll i madh, atë ditë kur erdhe Ti... Ka kaq shekuj që ngrohemi me rrezatime të akullta, sepse Ti ke ikur, e nga pas të ndoqi behari që solle atë muaj prill...

O Behar i jetës sime! Që atëherë dielli na rrezaton ftohtësi!

O "Ah" i shpirtit tim!

E kuptova pse Ti nuk e zbuluron madhërueshëm gjumin e gjithsecilit, se je aq i pastër! Dhe mos eja, mos eja në ëndërrën time, mos eja! Deri atëherë kur sytë e mi të bëhen të denjë për nurin Tënd; Ti mos eja!

O shpëtimtar i dy botërave të mia! Sot, qava nga malli për Ty, për sytë e tu të pagjumë, për këmbët tua që enjtëshin

ndërsa Ti kërkoje të ishim umeti yt; qava për lotët e tu ndërsa ti përgjërohesh që ne të ishim të falur...

O melodi e harmonisë sime! Sot vrapova pas ca tingujve të dashuruar me Ty dhe dëshirova të isha pjellë e një kallamishteje...

Endërrova tek më prisnin trupin e qullët, ndjeva të thahesha nën diell, të shpohesha me hekë të skuqur...

Endërrova të isha fyell, të puthja buzët e një artisti...e fryma e atij që më përkëdhelte brendësinë të përkthente dashurinë time duke të dhuruar qindra selame...

O dashuria ime e pahapësirë!

Më ka marrë malli e të kërkoj kudo brenda vetes! Të kërkoj në sy, në zemër, brenda damarëve dhe nuk di të përcaktoj ku ndodhesh sepse jam një hapësirë kaq e vogël për të përfshirë madhësitë Tënde!

Më ka marrë malli, ndonëse pa të parë asnjëherë...të pashtë, të njoha, të dëgjova ngado!

Më ka marrë malli...e nuk dua të flas më me askënd, andaj shpirti më grabit fjalë dhe më flet...e në çdo qelizë më injekton emrin Tënd!

Ti je meditimi im i gjatë në netë që zgjasin krahë agimesh të përgjumura e presin të zbardhen...Dhe veten e gjej të dehur në Ty, shtrirë në kufirin mes këtyre dy ngjyrave; bardh e zi...E aty në mugëtirë përgjoj çdo gjë të gjallë, përgjoj veten që pret zbritjen Tënde me bardhësinë, me vesën, me agimin... për të më dhënë jetë edhe një ditë më tepër... Sepse e di; Ti je shkak i ekzistencës sime!

...Dhe vazhdoj të ekzistoj me Ty...në Ty!

Vazhdoj të jetoj me shpresën që më bën të jetoj...me shpresën se atë ditë, do të më ftosh edhe mua në përqafimin bujar të ndërmjetësimit Tënd!



Një Ajet

Me emrin e Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit!

“Shpresën në mëshirën e Allahut nuk e humb askush, përveç jobesimtarëve.”

(surja Jusuf, 12/15)

Ata që pretendojnë se janë të mbrojtur nga dënimi i Allahut janë pikërisht të humburit. Gjithashtu edhe ata që e humbin krejtësisht shpresën nga Allahu janë jobesimtarët. Sado e pashpresë të duket situata, madje sado mëkat të madh që mund të kemi bërë nuk është e saktë të humbë shpresa nga Allahu Mëshirëplotë. Besimtarët duhet të jenë plot shpresë para mëshirës së Allahut të Lartmadhëruar. Shprehja e një dyshimi ndaj Mëshirës së Allahut të Lartmadhëruar e nxjerr njeriun nga besimi. Myslimani **bën një jetë në mes një frikë të thellë dhe një shpresë të pafund**. Prandaj atij nuk i shuhet shpresa kurrë, as në momentet më të trishtuara të jetës. Një besimtarë i vërtetë është ai i cili e organizon jetën e tij ndërmjet këtyre dy poleve, **të frikës së thellë (havr) dhe shpresës së pafundme (rexha)**. Vetëm në qoftë se këto dyja janë ngulitur mirë në zemrën e njeriut mund të flitet për një besim të gjallë e që prodhon vepër. Përndryshe nuk kemi një besim të pjekur që shpie në vepta të mira e të singerta.

Një Hadith

Transmetohet nga Ebu Hurejre radijallahu anhu se:

Resulullahu sallallahu alejhi ve sellem ka thënë:

“Në qoftë se një besimtar do ta dinte natyrën e dënimit të Allahut, nuk do të shpresonte kurrë xhenetin. Por, edhe nëse një kafir (jobesimtar) do të mund të konceptonte krejtësisht natyrën e mëshirës së Allahut, nuk do ta humbiste kurrë shpresën nga xheneti.”

(Muslim, Tevbe 23)

Koment

Ky hadith shpjegon në mënyrë bindëse dy cilësitë e Allahut, atë të mëshirës dhe atë të dënimit. Ky hadith dëshmon qartë pamundësinë tonë për të kuptuar natyrën e dy prej cilësive të Allahut.

Kur një besimtar nuk e gëzon sigurinë absolute për të shpresuar në xhenetin, askush tjetër s’e gëzon këtë të drejtë, e aq më pak një jobesimtar (kafir). E nëse një jobesimtar nuk do të mund të ndihej i pashpresë, në kuptimin absolut, përballë detit të pafundëm të mëshirës hyjnore, atëherë askush tjetër nuk mund të bjerë në humnerën e fatalitetit, pesimizmit e dëshpërimit, aq më pak ka gjasa të bjerë në disfatizëm një besimdrejtë.

Asnjë besimtar nuk mund të jetë i sigurt nga dënimi i Zotit, po ashtu si asnjë kafir nuk duhet ta humbasë krejtësisht shpresën nga Zoti. Prandaj, gjithkush duhet të jetojë midis frikës dhe shpresës. Thënë me fjalë të tjera, njeriut nuk duhet t’i mungojë frika e dënimit nga Allahu në rastin kur është besimtar dhe kryen adhurimet ndaj Tij, sikurse nuk duhet t’i mungojë shpresa te Allahu edhe në rastin kur është kafir dhe rebel. Frika dhe shpresa janë si dy polet ekstreme, plus-minus-et, e jetës së besimtarit. Ashtu siç nuk mund të realizohet një reaksion kimik pa ekzistencën e poleve plus dhe minus, ashtu edhe një jetë e ekuilibruar besimi nuk mund të realizohet në shpirtin e një besimtari pa praninë e frikës dhe të shpresës.

Mësimet që nxjerrim nga hadithi:

1. Allahu ka një mëshirë dhe një dënim të pafundëm.
2. Duke pasur parasysh cilësitë e Allahut, Xhemal dhe Xhelal, njeriu është i detyruar të mbajë një qëndrim plot respekt dhe frikë, por në të njëjtën kohë edhe plot shpresë ndaj Tij.
3. Në gjendje shëndeti të plotë duhet të ruhet ekuilibri mes frikës dhe shpresës, kurse në gjendje sëmundjeje duhet ushqyer më shumë shpresa.
4. Jeta ideale e një besimtari është ajo, e cila qëndron ndërmjet frikës dhe shpresës.
5. Mungesa e frikës ose e shpresës, e zhvesh njeriun nga besimi i plotë.

PARIMET E MORALIT TË LARTË -2-

Ndjesia e dashurisë ndaj një qenieje, përhapet në çdo gjë që e bën të lindë atë dashuri ose që lidhet me atë dashuri. Për shembull, mes mijëra malesh që ekzistojnë, Mali i Uhudit është më i veçanti për besimtarët, sepse atë e ka dashur në mënyrë të veçantë i Dërguari i Allahut (s.a.v.s.). Qyteti **“Jeth-rib”**, para hixhretit ishte një qytet si të gjithë të tjerët, por më vonë, për faktin se atë qytet e lau me dashurinë dhe mirësinë e Tij Mbreti i Shpirtërave (s.a.v.s.), ai u bë **“Medinej-i Munevvere”**. Me të vërtetë, ajo dashuri aq e zjarrtë që gjallon në zemrat e besimtarëve për **“Medine-i Munevvere”** nuk ka të krahasuar me dashurinë ndaj asnjë qyteti tjetër, sepse sa herë që përmendet ky qytet, besimtarëve u vjen ndërmend Pejgamberi (s.a.v.s.).

Prandaj, siç del në pah edhe nga shembujt e mësipërm, dashuria ndaj Allahut të Lartmadhëruar shpie në dashurinë dhe në

bindjen absolute ndaj profetit Muhamed (s.a.v.s.).

Allahu (xh.sh.) thotë në Kuran:

“Thuaju (o Muhamed): ‘Nëse ju e doni Allahun, atëherë më ndiqni mua, që Allahu t’ju dojë dhe t’ju falë gjynahet! Allahu është falës i Madh dhe Mëshirëplotë.’ (Al-i Imran, 31)

Rruga e bindjes ndaj Të Dërguarit të Allahut e bën njeriun të meritueshëm për të qenë pjesë e robërve që pëlqen Allahu i Lartmadhëruar. Rezultati i dashurisë dhe i bindjes ndaj Allahut (xh.sh.) dhe ndaj Resultit të Tij, është kënaqësia që besimtari ndjen nga prirjet e natyrshme të dashurisë dhe dhembshurisë kundrejt krijesave për hatër të Krijuesit, kënaqësia e të ndarit me vëllezërit myslimanë të çdo gjëje brenda mundësive, kënaqësia e të falurit, , kënaqësia e të shikuarit të krijimit nëpërmjet syrit të Krijuesit, si dhe plot gjendje të tjera.

Për t’u afruar me të vërtetat e Resulullahut (s.a.v.s.), sahabet e nderuar qëndronin të gjithë përreth Profetit duke u bërë shërbëtorë të Tij. Për sahabet, njësimi me Të ishte mirësia më e madhe e kësaj dynjaje, arsye për të cilën ata arritën të gjitha favorët hyjnore. Gjatë historisë, besimtarët që përvetësuan cilësitë e larta të personalitetit të Tij shembullor, duke e gjallëruar ndjeshmërinë hyjnore si pjesë të natyrshmërisë, arritën kulmet sa i takon besimit dhe moralit, duke u bërë kështu pishtarë orientues për njerëzimin.

Ilaçi më i efektshëm i zemrave të sëmura dhe indife-

“Thuaju (o Muhamed): ‘Nëse ju e doni Allahun, atëherë më ndiqni mua, që Allahu t’ju dojë dhe t’jua falë gjynahet! Allahu është falës i Madh dhe Mëshirëplotë.”

(Al-i Imran, 31)

rente është dashuria ndaj Pejgamberit (s.a.v.s.). Pikërisht te mahnitja që ka ushqyer tek njerëzit personaliteti i tij i lartë, e ka burimin edhe prirja për **“praktikimin e sunetit me bindshmëri absolute”**.

Profeti ynë (s.a.v.s.) dëshiron të jetë së bashku me umetin e Tij në xhenet, prandaj kërkon që umeti i Tij të jetë i vëmendshëm ndaj çdo çështjeje të urdhëruar nga Allahu (xh.sh.). Në lidhje me dashurinë që Profeti ynë (s.a.v.s.) ushqen për umetin e Tij, në Kuran thuhet:

“Tashmë ju ka ardhur një i Dërguar nga gjiri juaj. Atij i vjen rëndë për gjynahet që bëni ju, jua dëshiron të mirën me gjithë zemër që ju të shkoni rrugës së drejtë dhe është i butë dhe i mëshirshëm me besimtarët.” (et-Tevbe,128)

Që të mund t’i bashkohemi këtij Profeti aq shumë të dhënë pas umetit të Tij, duhet t’ia vëmë veshin me gjithë shpirt këshillave të Tij. Disa nga këshillat e rëndësishme që Profeti (s.a.v.s.) ka kërkuar t’i zbatojmë me përpikmëri, janë këto:

I Dërguari i Allahut (s.a.v.s.) ka thënë:

Zoti më urdhëroi që heshtja ime të jetë meditim, (të njëjtën gjë jua këshilloj edhe juve).

Allahu i Lartmadhëruar i ka dhuruar të gjitha krijesave sipas veçorive të tyre të krijimit dhe sipas aftësisë së të menduarit. Procesi i të menduarit tek krijesat, përveç njerëzve dhe xhindeve, quhet *“instinkt”*. Ky lloj të menduari shërben për vazhdimësinë e jetës trupore. I ndihmon kafshët për të mbushur barkun, i ndihmon për vetëmbrojtje, i siguron për vazhdimësi-

në e llojit të tyre, si dhe për çështje të tjera të ngjashme me këto.

Ndërsa njeriut i është dhuruar meditimi si aftësi mendore për të forcuar përbërjen e shpirtit dhe për të mund t’u bërë rob i afërt me Allahun dhe mik i Tij. Sa humbje tragjike do të ishte përdorimi i kësaj aftësie vetëm për interesat e kësaj bote, si dhe për interesat e nefsit!

Përvetësimi i begative Hyjnore dhe raporti i njeriut me lumturinë e tij në Ahiret, lidhet kryekëput me thellimin e tij në mënyrë të vëmendshme dhe të qëndrueshme në meditim dhe ndjeshmëri. Meditimi është një nga mjetet më të rëndësishme që e shpie njeriun në majat më larta të njerëzores. Udhërrëfyesi ynë, Kurani, që nga ajeti i parë e deri tek i fundit, e thërret njeriun të mendojë thellë drejt mrekullive të krijimit të tij, rreth harmonisë së përsosur të universit, si dhe rreth Kuranit si një mrekulli e pashoqe. Ai i tërheq vëmendjen njeriut me shprehje të tilla si: ***“A nuk zini mend?”***, ***“A nuk po mendoni?”***, ***“A nuk po merrni mësim?”*** Kështu, cilido që dëshiron të jetë në përputhje me vlerat njerëzore, është i detyruar të hyjë në atmosferën e të menduarit nën prirjen e Kuranit të Madhërueshëm.

Allahu (xh.sh.) në Kuran thotë:

“Vallë, a nuk mendojnë ata në vetvete? Allahu ka krijuar qiejt dhe Tokën dhe ato që gjenden në mes tyre - vetëm me qëllim dhe afat të caktuar. E, me të vërtetë, shumica e njerëzve nuk besojnë në takimin me Zotin e tyre.” (er-Rum, 8)

“Vallë, a mos u lodhëm ne gjatë krijimit të parë? Jo,



por ata dyshojnë në krijimin e sërishëm. Ne e kemi krijuar njeriun, Ne e dimë ç'i pëshpërit atij shpirti i vet.” (Kaf, 15-16)

I dërguar nga Allahu (xh.sh.) si personalitet shembullor për umetin e Tij, Profeti Muhammed (s.a.v.s.) mendonte thellë për botën e krijimit, si dhe për urtësinë e Krijuesit të saj. Nuk fliste rreth kësaj çështjeje pa qenë e nevojshme ta bënte një gjë të tillë. Hesh-tjet e tij zgjasnin shumë. Shpeshherë e ftonte umetin e tij të meditonte rreth krijesave të Allahut (xh.sh.), dhe i thoshte se meditimi është lloji më i veçantë i adhurimit.

Në vazhdim të këshillave profetike, Profeti ynë (s.a.v.s.) ka thënë:

Zoti im më urdhëroi që e folura ime të jetë dhikër, (të njëjtën gjë jua këshilloj edhe juve).

Të dashuruarit ndjejnë nevojën e përmendjes së emrit të asaj që dashurojnë, në përputhje me masën e dashurisë që ndjejnë ndaj saj. Nga ana tjetër, përmendja e vazhdueshme e rrit edhe dashurinë e dashuruesit ndaj asaj që dashuron. Ata që kanë shijuar kënaqësinë e besimit e përmendin Allahun në masën e dashurisë që ndjejnë për Të.

Pa dyshim, të përmendësh Allahun nuk do të thotë ta përsërisësh disa herë shqiptimin e emrit të Tij, por do të thotë që, më vetëdije dhe perceptim të thellë t'i bësh vend Atij në qendrën e ndjesive, pra në zemër. Në Kuran thuhet:

“...ata që besojnë dhe zemrat e të cilëve, kur përmendet Allahu, qetë-



sohen. Vërtet, zemrat qetësohen me përmendjen e Allahut!” (er-Ra’d, 28)

Nga Hazret-i Aisheja (r.a.), mësojmë se Resulullahu (s.a.v.s.) ishte vazhdimisht në gjendje përmendjeje të Allahut të Lartmadhëruar. Në Kuran, nëpërmjet një ajeti që kërkon prej nesh të njëjtën gjë, Allahu i Lartmadhëruar thotë:

“...Por, Zotin tënd përmende shumë dhe adhuroje Atë në mbrëmje dhe në mëngjes.” (Al-i Imran, 41)

“Pasi të kryeni namazin, përmendeni Allahun duke qëndruar në këmbë, ulur dhe shtrirë...” (en-Nisa, 103)

Në këtë ajet, Allahu i Lartmadhëruar urdhëron që edhe në çaste të vështira rreziku, lufte dhe fatkeqësie, nuk duhet harruar apo neglizhuar dhikri, pra në çdo çast dhe në situatë zemrat duhet të jenë të lidhura me Të.

Që njeriu të mos bjerë në indiferencë dhe në harrësë, dhikri është kusht. Allahu (xh.sh.) thotë në Kuran:

“Mos u bëni si ata që e harruan Allahun, kështu që Ai i bëri të harronin vetveten! Pikërisht ata janë të pabindurit (ndaj Allahut).” (el-Hashr, 19)

Allahu (xh.sh.), kur i dërgoi Hazreti Musanë dhe Hazreti Harunin - alejhimesselam - tek Faraoni, i porrositi:

**“Vallë, a nuk i shohin devetë, se
si janë krijuar?!”**

**Po qiellin, se si është ngritur?!
Po malet, se si janë vënë të pa-
tundur?!”**

Po tokën se si është shtrirë?!”

(el-Gashiye, 17-20)

**“Shkoni ti dhe vëllai yt me mrekullitë e Mia dhe
mos reshtni së më përmenduri Mua!”** (Ta Ha, 42)

Ai që thotë me gjithë zemër “O Zoti im”, nuk mund të nxjerrë nga goja fjalë të gabuara, nuk mund të bëjë padrejtësi, nuk mund të sillet ndaj krijesave pa dhembshuri, sepse tek ai që bën dhikër shfaqen cilësitë e Allahut **Rahman dhe Rrahim**.

Jeta adhuruese e atij që është në kontakt me dhikrin dhe që zemrën e ka të lidhur me Zotin, arrin kulmet. Profeti (s.a.v.s.) ka thënë:

“Ndryshimi ndërmjet atij që bën dhikër (përkujton Allahun) dhe atij që nuk bën dhikër, është si ndryshimi i të gjallit me të vdekurin. (Buhari, Deavat, 66)

Si këshillë të tretë, Pejgamberi (s.a.v.s.) ka thënë:

**Zoti im më urdhëroi që shikimi im të jetë i pajisur (i
kultivuar) me aftësinë e nxjerrjes mësim, (të njëjtën
gjë jua këshilloj edhe juve).**

Allahu (xh.sh.) shpreh lëvdata për robërit e Tij, të cilët i shohin gjërat e ngjarjet me kujdes dhe nxjerrin prej tyre mësimin e duhur. Ai na informon se ajetet i ka shpallur dhe i ka sqaruar pikërisht për këtë kategori njerëzish. Në disa ajete të cilat orientojnë njeriun drejt nxjerrjes mësim nga qeniet dhe nga situatat që zhvillohen rreth tij, thuhet:

**“Vallë, a nuk i shohin devetë, se si janë krijuar?! Po
qiellin, se si është ngritur?! Po malet, se si janë vënë**

të patundur?! Po tokën se si është shtrirë?!”
(el-Gashiye, 17-20)

**“Vallë, a nuk kanë udhëtuar ata nëpër
Tokë, për të parë përfundimin e atyre që
qenë përpara tyre!?...”** (Muhamed, 10)

Më e rëndësishmja përsa i takon dijes intuitive, është njohja e gjuhës që lidhet me gjendjen e qenieve. Këtë etapë, Hazreti Mevlana e shpreh me fjalët **“u poqa”** dhe **“u dogja”**. Në veprën e tij madhështore të Mesnevisë ai flet me të gjitha qeniet, bëhet përkthyesi i gjuhës së tyre të gjendjeve. Një nga komunikimet e tij është edhe ai që zhvillohet ndërmjet tij dhe trëndafilin. Në një bisedë gati miqësore me trëndafilin, Hazreti Mevlana thotë:

“Ngaqë pranoi të jetonte në harmoni me gjembin, trëndafili u pajis me erë të mirë. Këtë të vërtetë dëgjoje nga vetë trëndafili. Dëgjo çfarë thotë: Pse të pikëllohem nga gjembi me të cilin bashkëjetoj, pse ta lëshoj veten për këtë? Kënaqësinë që shpreh me të qeshura, unë e fitova me durim e qëndresë ndaj bashkëjetesës me gjembin. Nëpërmjet tij unë fitova mundësinë për t'i dhuruar gjithë botës aroma të këndshme.”

Ndërsa Junus Emre kuqendron me lulen e verdhë, duke mësuar nga ajo e duke i mësuar asaj urtësinë dhe të fshehtat e universit.

Sad-i Shirazi thotë:

“Për shikimin e të urtëve, çdo gjethe peme është një libër që të shpie drejt urtësisë hyjnore.”

Si përfundim, mund të themi se për të arritur

pjekurinë, pastrimin dhe dëlirësinë e botës së brendshme, janë të domosdoshme cilësitë e larta të të menduarit, bërja dhikër si edhe pajisja e shikimit me aftësinë e të nxjerrurit mësim nga çdo gjë. Resulullahu (s.a.v.s.), na bën të ditur se Vetë Allahu e ka urdhëruar të jetë i kujdesshëm në këto pika, prandaj të njëjtën gjë kërkon edhe prej nesh.

Sa bukur shprehet hazreti Imam Rabbani kur thotë:

“Sa fatlum është ai, të cilit i është dhënë mirësia e ndjekjes së Sunetit të Profetit Muhamed (s.a.v.s.). Edhe një punë e vogël që bëhet sot duke besuar në vërtësinë e Islamit, do të shpërblehet një lloj me vlerën e punëve të mëdha...”
(Mektubat Rabbani, 44. Mektub)

Zoti na përfshiftë, ne robërve të Tij, në bashkësinë e fatlumëve që zbatojnë me përpikmëri sunetin e të Dërguarit të Allahut (s.a.v.s.)!

Të jetuarit në rrugën e drejtë të moralit dhe të këshillave profetike i shndërron të dy botët në gëzim feste. Receta e vetme e cila vuajtjet e përkohshme të kësaj bote i lartëson në qetësi të përjetshme, që lotët e hidhur i kthen në buzëqeshje të pafundme, që hakërrimat e dala prej shpirtit i shndërron në ushtima prej xheneti, gjendet në parimet e larta të Resulull-llahut (s.a.v.s.), në dhembshurinë, në mëshirën dhe ndërmjetësimin e Tij.

Bajramet që arrijmë të përjetojmë në këtë botë, para të gjithash duhet të jetohen përreth këtyre të vërtetave, në mënyrë që të arrijmë të përjetojmë bajramet e jetës së pafundme. Mes këtyre të vërtetave është meditimi,

**“Betohem në Atë
që ka në dorë shpirtin tim se,
deri sa ju të mos mëshironi
njëri-tjetrin nuk do të mund
të hyni në xhenet.”**

dhikri (përmendja sa më shpesh e Zotit) si dhe trajtimi me kujdes e vëmendje i çdo gjëje që na rrethon... Me pak fjalë, çështja qëndron në përvetësimin e moralit të lartë të Hazret-i Pejgamberit (s.a.v.s.), të altruizmit, të ndarjes me të tjerët të çdo gjëje që ai kishte...

Nuk duhet harruar se Allahu i lartmadhëruar i ka krijuar njerëzit nevojtarë ndaj njeri-tjetrit. Shoqëria, ashtu si ka klasën e pasur dhe të fortë, ka e do të ketë gjithmonë edhe klasën e të dobëtëve, të sakatëve dhe të nevojtarëve. Ne duhet të pyesim veten: “Pse i krijoi Allahu i Lartmadhëruar nevojtarët?” Përgjigjja dihet: “Nevojtarët janë, për jo të tillët, një amanet i Allahut (xh.sh.).” Vetë Allahu na ka ngarkuar me këtë përgjegjësi.

Duhet të mendojmë vazhdimisht se të pasurit mund të ishin në vend të të varfërve, apo dhe anasjelltas. Ata që gëzojnë një gjendje të mirë ekonomike duhet ta kuptojnë mirë përgjegjësinë që kanë në lidhje me plotësimin e nevojave të të varfërve, sepse përballë jetës së pafundme, jeta e kësaj bote është veçse një segment shumë i shkurtër dhe i papërfillshëm. Ndof-ta në sajë të durimit dhe të falënderimit të atyre nevojtarëve, të pasurit do të shpërblehen me mirësi të pamasë në botën e pafundme, në Ahiret.

Një ditë, Profeti Muhamed (s.a.v.s.) tha:

“Betohem në Atë që ka në dorë shpirtin tim se, deri sa ju të mos mëshironi njëri-tjetrin nuk do të mund të hyni në xhenet.”



Sahabet thanë:

“O i Dërguari i Allahut! Ne jemi të gjithë të mëshirshëm.”

Profeti (s.a.v.s.) tha:

“Mëshira për të cilën po flisja unë nuk është ajo që kuptuat ju, pra nuk është vetëm mëshira që ju shprehni ndaj njëri tjetrit. Unë po flisja për mëshirën, e cila rrok të gjitha krijesat, një mëshirë e cila përfshin (nuk lë jashtë asgjë) çdo krijesë!..” (Hakim, IV, 185/7310)

Hakërrimat që lëshohen në heshtje nga shoqëria duhet t'i ndejmë më thellë. Sigurisht, në krye të këtyre vijnë të sëmuret dhe pleqtë e mbetur vetëm, fëmijët që janë hedhur në rrugë, në mëshirë të fatit, ata që kanë humbur rrugën duke u ndikuar nga helmi i mediave të papërgjegjshme, të rinjtë të cilët duke qenë në stinën më të bukur të jetës po zhyten në batakun e alkoolit dhe të bimëve narkotike, si dhe mendjet e njoma të të rinjve që kanë humbur ndjeshmërinë fetare e kombëtare.

Nëse i kemi parasysh të gjitha këto, sa herë që zemra dhe dora jonë zgjatet nga njerëzit e shkretë e nevojtarë, ne arrijmë ta përfjethëjmë thelbin e bajramit të vërtetë, sepse myslimanët janë si organet e të njëjtit trup. Nëse humbim qoftë edhe një njeri, është njësoj si të kemi humbur një pjesë të trupit tonë. Duke dëshiruar që besimtarët të jenë pikërisht të tillë, Profeti thotë:

“Në dashurinë, dhembshurinë dhe në ruajtjen e njëri-tjetrit, besimtarët janë si një trup i vetëm. Kur një nga organet e trupit sëmurët, atëherë edhe organet e tjera sëmuren dhe digjen flakë nga temperatura.” (Buhari, Edeb, 27; Muslim, Birr 66)

Duhet të mendojmë mirë se cila është ajo lëvizje shpirtërore, e cila do t'i zgjonte me të vërtetë nga gjumi indiferentët, që do t'i gjallëronte me gëzim e lumturi të varfërit e të vuajturit, do ta bënte njerëzimin të buzëqeshte me fytyrën e ngrohtë e të qeshur të Islamit, duke sjellë festën e vërtetë mes tyre.

Sa mund të shkrihen zemrat dhe duatë tona me njerëzit në nevojë?

A do të mund të bëhemi sado pak shkak që në fytyrat e tyre të duket buzëqeshja, ajo buzëqeshje që do të na dhuronte kënaqësinë e vërtetë të festës, si dhe do t'i falte shpirtëve tanë pranvera të këndshme lumturie?

Allahu i Lartmadhëruar na ndihmoftë që t'i ndejmë thellë dhimbjet dhe vuajtjet e vëllezërve tanë myslimanë që po dhunohen, që zemrat e shpirtrat tanë të bëhen dergjah për ta, si dhe na e bëftë të mundur t'ia mbështjellim plagët me ndihmat tona materiale dhe shpirtërore! E bëftë bajram të përjetësisë që shfaqet plot me manifestime lumturie, derën tonë që do të hapet drejt Ahi-retit!

Amin...



Mr. sci. Alamur Sofu

Njohja e të ndaluarës dhe të lejuarës është çështje e domosdoshme në sheriatin Islam

“**T**huaju: “Ejani t’ju lexoj çfarë ju ka urdhëruar Allahu: që të mos i shoqëroni Atij asgjë (në adhurim); që të silleni mirë me prindërit; që të mos vrisni fëmijët tuaj për shkak të varfërisë, sepse Ne ju ushqejmë ju dhe ata; që të mos i afroheni veprave të turpshme, qofshin ato të hapëta apo të fshehta dhe që të mos ia merrni tjetrit jetën, të cilën Allahu e ka shenjtëruar, përveçse kur e kërkon drejtësia (e ligji). Këto ju porosit Ai, me qëllim që të kuptoni.”¹

Me të vërtetë, parimi që duhet njohur patjetër është se Allahu xh.sh. është i Vetmi ligjdhënës, pavarësisht se urdhëri i Ligjdhënësit, konfirmohet me anë të tekstit kuranor, sunetit apo ixhtihadit të dijetarëve, ngase janë pa dyshim dijetarët ata që shpjegojnë qëllimin e Ligjdhënësit, duke iu përmbajtur rregullave dhe programit të studimit, të cilat janë përcaktuar sipas burimeve të sheriatit. Pa dyshim, nga mëshira e Tij e madhe Allahu xh.sh. ka

përcaktuar ligje, të cilat janë në dobi të njeriut: pra ajo që është urdhëruar të zbatohet është në dobi të njeriut, ndërsa e ndaluara është në dëm të tij. Nga mëshira e madhe e Ligjdhënësit, është e dukshme se Allahu xh.sh. i ka dërguar peygamberët për dobinë e njerëzve, gjë e cila shprehet qartë në Kuranin (a.sh.): “Dhe atyre që ndjekin të Dërguarin tonë, Profetin që nuk di shkrim e lexim, të cilin ata do ta gjejnë të shënuar në shkrimet e tyre në Teurat dhe Ungjill. Ai do t’i urdhërojë ata të bëjnë vepra të mira dhe do t’i ndalojë nga të këqijat duke i liruar nga barrët e rënda dhe vështirësitë që kanë pasur. Prandaj ata që do ta besojnë përkrasin dhe nderojnë atë, duke ndjekur dritën që është zbritur me të, pikërisht ata janë të ftuarit.”²

Pa dyshim, njohja e asaj që është e ndaluar (haram), e asaj që është e lejuar (mubah) dhe e asaj që është e obliguar, përbën një prej parimeve që një mysliman duhet të

1. El-En’am: 151

2. Al-A’raf: 157

ketë parasysh medoemos, sepse me anë të asaj njohurie do të dijë të kryejë obligimet e caktuara nga Ligjdhënësi i vetëm, Allahu xh.sh. dhe do të dijë të largohet nga ato që Ai ia ka ndaluar. Të gjitha ligjet e përcaktuara nga Allahu xh.sh., janë në dobi të njeriut dhe kurrësesi në dëm të tij, pavarësisht nëse njeriu është apo jo në gjendje të kuptojë urtësinë e këtyre obligimeve dhe ndalesave.

Obligueshmëria e besimit në Allahun xh.sh., në emrat e Tij të bukur dhe cilësitë e Tij të larta, janë rruga dhe mënyra me të cilën është nderuar dhe çmuar krijesa-njeri. Po ashtu, zbatimi i detyrimeve, si fjala vjen namazi, agjërimi, haxhi, e pastrojnë njeriun shpirtërisht, duke e larguar nga veset dhe nga gjërat e ulëta. Gjithashtu, ligjësimi dhe obligimi i dhënies së zekatit janë bazë e harmonisë dhe e mirëkuptimit midis njerëzve, ngase secili i kryen obligimet që i takojnë.

Ekzistojnë sanksione të prera rreth disa krimeve të mëdha si fjala vjen dënimi për mbytje, zina (prostitucion), vjedhja, shpifja në moral, për përdorimin e pijeve dehëse, për përdorimin e drogës e gjëra të ngjashme. Të gjitha këto sanksione kanë për qëllim të mbrojnë individin, shoqërinë, vlefshmërinë e njeriut, të drejtat e njeriut qofshin ato materiale apo shpirtërore.

Të përcaktuarit e rregullave të shitblerjes dhe marrëveshjeve bashkekzistuese mes njerëzve kanë për qëllim rregullimin e sistemit të jetës në mënyrë më të përsosur, duke mos i lënë hapësirë mashtrimeve e korrupsionit, por duke sjellë vetëm qetësi dhe bashkëpunim mes njerëzve. Këtë çështje e përkufizon shumë qartë dijetari Ibn Kajjimi³ (r.a.), i cili thotë: *“Parimore në përcaktimin e rregullave për bashkekzistencën e njerëzve është se ato janë përcaktuar për t’u zbatuar drejtësia mes tyre, gjë për të cilën janë dërguar pejgamberë dhe janë zbritur libra nga Ligjdhënësi-Allahu (xh.sh.).”*

Një çështje e tillë argumentohet edhe me fjalët e Allahut xh.sh.: ***“Ne i çuam të dërguarit Tanë me prova të qarta dhe bashkë me ta zbritëm Librat (e shenjtë) dhe peshoren (e drejtësisë): që njerëzit të veprojnë drejt...”***⁴

Si Ligjdhënësi i vetëm, Allahu xh.sh. e ka ndaluar kamatën vetëm e vetëm sepse në të ka padrejtësi. Po ashtu ka ndaluar lojërat e fatit, sepse në to ka mashtrim. Po ashtu, Ligjdhënësi ka ndaluar disa lloj shitblerjesh për arsye se në to mund të ketë kamatë apo dredhi e mashtrime.

Përcaktimi i kushteve të veçanta për çështjet familjare dhe shoqërore kanë si qëllim mbrojtjen e nderit e të moralit, dhe vlerësimin e lartë për lidhjet familjare dhe vazhdimin e llojit njerëzor.

Ligjësimi i xhihadit dhe i mbrojtjes së vetës ka për qëllim zmbrapsjen e armikut, mënjanimin e tiranisë,



mbrojtjen e umetit, lartësimin e fjalës së Vërtetë dhe përhapjen e thirrjes për paqe e qetësi në këtë tokë.⁵

Lejimi i ushqimeve të këndshme ka si qëllim respektimin dhe nderimin e krijesës së përsosur, njeriut. Ndalimi i ushqimeve të fëlliqura dhe i disa lloj mishrave të shtazëve synon ruajtjen e natyrshmërisë njerëzore, mbrojtjen e shëndetit të njeriut nga gjërat e neveritshme dhe largimin e tij nga çdo gjë që ia dëmton trupin, mendjen dhe shëndetin nga sëmundje e dëme të ndryshme. Për këtë arsye Allahu xh.sh. thotë: ***“O njerëz! Ushqehuni me të gjitha ato gjëra të lejuara e të mira që gjenden në Tokë dhe mos ndiqni gjurmët e djallit, sepse ai është njëmend armiku juaj i hapur.”***⁶ Gjithashtu, edhe Pejgamberi (s.a.v.s.) thotë: *“Nuk ka dëm e as të dëmtuar (reciprok)”*⁷.

Rregullimi e sistemimi në mënyrë të hollësishme i së drejtës trashëgimore nga Kurani dhe Suneti synon garantimin e drejtësisë në ndarjen e trashëgimisë familjare, si dhe largimin nga çdo nxitje e zilisë dhe hidhërimit ndërfamiljar.

5. Shih më gjerësisht: ESBABU SHERA'I FI KESHFIL ESRARI ALA USULIL BEZDEVII. vol.II. f. 259 e më tej. Po ashtu krahaso: Iz ibn Abdu Selam, KAVAIIDUL AHKAMI, vol.I. f. 46 e më tej.

6. El-Bekare: 168.

7. Transmeton imam Maliku, Ahmedi, Nesaiju, Behjekiu, Darekutni dhe Ibn Maxhe.

3. Shiko: E'alamul Muki'in, vol. I. f. 388

4. El-Hadid: 25.

Pa dyshim që e lejuara (mubahi) dhe e ndaluara (harami) janë dy antonime, çdonjëra prej të cilave ka kuptimin e vet gjuhësor dhe terminologjik.

Fjala *mubah* (e lejuar) që e hasim në terminologjinë e sheriatit nënkupton veprën e cila është e lejuar të kryhet, por që mbetet në zgjedhjen e të ngarkuarit me obligime (mukelef) që ta zbatojë apo jo atë. Për zbatimin e mubahit nuk ka shpërblim, por as për mos zbatimin e tij nuk ka ndëshkim.

Haram konsiderohet ajo vepër e cila është rreptësisht e ndaluar të kryhet, kryerësi i së cilës ndëshkohet. Vepruesi i haramit (të ndaluarës) ndëshkohet në botën tjetër, por në disa raste ndëshkohet edhe në këtë botë, siç është rasti i kriminelit, shpifësit në moral, i atij që bën zina (prostitucion) etj. Sipas dijetarëve hanefit, dispozita e haramit ndahet në dy grupe:

1. Harami që është i ndaluar nga vetvetja (haramun lidhatihi). Ky lloj harami është i ndaluar qysh në parim, ngase kryerja e tij ka dëme dhe pasoja, siç janë për shembull vjedhja, prostitucioni, prija ndaj pijeve dehëse, ngrënia e mishit të kafshëve të cofëta etj. Në këtë kategori të haramit hyjnë të gjitha ato haramet që sjellin dëme e pasoja, e që dëmton çështje të cilat sheriatu islam i konsideron interesa vitale (el-maslehatul muteberetu), siç janë: besimi, mendja, pasuria, jeta dhe nderi.

2. Harami që për shkaqe të tjera konsiderohet haram (haramun ligajrihi). Ky haram është ai që në parim është i lejuar (mubah) por që për shkaqe të ndryshme bëhet haram. Për shembull, shitblerja në parim është e lejuar, por nëse ajo bëhet duke i mashtruar njerëzit, atëherë kjo lloj shitblerjeje konsiderohet haram; agjërimi në parim është i lejuar, por nëse agjërohet dy ditë pa ndërprerje nuk lejohet etj.

Pavarësisht nga fakti se me çfarë harami kemi të bëjmë, është e qartë se harami është në dëmin tonë, arsye për të cilën edhe Ligjdhënësi e ka ndaluar. Këtë të vërtetë Allahu xh.sh. na e sqaron në mënyrë shumë të qartë në Kuranin (a.sh.): ***Thuaj: “Me të vërtetë, Zoti im ka ndaluar vetëm punët e pabijshme, qofshin të hapëta ose të fshehta dhe gjynahet, dhunimin pa të drejtë, t’i shoqërohet Allahut (në adhurim) diçka, për të cilën nuk ju ka dhënë kurrfarë të drejte dhe të thoni për Allahun atë që nuk e dini.”***⁸

Duke u bazuar dhe analizuar rregullën e sheriatit, në të cilën thuhet: ***“Çdo gjë që të shpie tek harami konsiderohet haram”***, na bëhet e qartë se myslimanit i vihen ca masa paraprake që e pengojnë në afrimin ndaj haramit, ngase kur njeriu i përdor dhe zbaton gjërat që shpien te harami, ai bie pa dyshim në haram. Mbyllja e rrugëve që shpien te harami është një begati e madhe për njeriun i cili dëshiron të ruhet prej haramit. Për këtë arsye po sjellim si shembull ajetin: ***“Mos i shani idhujt që ata***

i adhurojnë në vend të Allahut në mënyrë që ata të mos e shajnë Allahun armiqësisht nga padija. Kështu Ne ia paraqesim të bukura çdo populli veprat e veta. Pastaj ata do të kthehen te Zoti i tyre i cili do t’i lajmërojë për gjithçka që kanë bërë.”⁹ Po ashtu, mund të përmendim edhe hadithin e Pejgamberit s.a.v.s, i cili me një rast iu është drejtuar ashabëve të tij me fjalët: ***“Vërtet një prej mëkateve të mëdha është sharja e prindërve! Ashabët e pyetën: a mund t’i shajë njeriu prindërit e tij? (Pejgamberi s.a.v.s.) u përgjigj: po, kur dikush ia shanë babanë dikujt tjetër, e detyron atë t’ia shajë babanë e tij, e kur dikush ia shanë dikujt tjetër nënën, e detyron atë t’ia shajë nënën e tij.”***

Si nga ajeti, ashtu edhe nga hadithi, vërehet qartë se myslimanit i mbyllet rrugët që e shpien të harami. Masat që pengojnë arritjen te harami në sheriatin islam njihen si ***“Seddudh-Dheria”***.

Harami si dispozitë është gjithëpërfshirës, domethënë nuk mund të konsiderohet për dikë haram e për dikë jo haram; nuk është e mundur që diçka të jetë haram në një vend, e të jetë jo haram në një vend tjetër. Harami përfshin prijësin dhe njeriun e zakonshëm, gjykatësin dhe atë që është duke u gjykuar prej tij etj.

Domosdoshmëria e largimit nga harami është e prerë dhe e qartë, por gjithashtu duhet larguar edhe nga ato gjëra për të cilat jemi në dyshim nëse janë haram apo jo, ngase largimi nga gjëra të tilla do të thotë mbrojtje prej të ndaluarës (haramit). Kur ndodh që çështja është e dyshimtë nëse është haram apo jo, atëherë duhet të largohemi nga ajo vepër që të mos biem në dyshimin se kemi rënë në haram. Një veprim i tillë kuptohet qartë nga hadithi i Pejgamberit (s.a.v.s.): ***“Në të vërtetë hallalli (e lejuara) është i qartë, por dhe harami (e ndaluara) është i qartë. Ndërmjet tyre janë gjërat e dyshimta, të cilat shumë njerëz nuk i dinë. Kush ruhet nga gjërat e dyshimta, është i sigurve në pikëpamje të besimit dhe të nderit, ndërsa kush bie pre e gjërave të dyshimta, ka rënë në të ndaluarën, ashtu sikurse bariu që ruan kopenë rreth vendit (kullotës) të ndaluar dhe të cilit mund t’i ikin dhentë për të kullotur në të. Çdo sundues e ka një vend (kullotë) të ndaluar për të tjerët, kurse vendi i ndaluar i Allahut janë ndalesat (haramet) e Tij...”***¹⁰

Kur një çështje është e diskutueshme nëse është haram apo jo, është më mirë që të largohemi nga zbatimi i saj, për atë se nëse është ajo vepër haram dhe nuk e kemi bërë kemi shpëtuar nga dënimi, e nëse nuk është haram por është e lejuar nuk ka kurrfarë dënimi nëse nuk zbatohet një vepër që është e kategorisë së mubahit (e lejuar). Pikërisht për këtë Pejgamberi (s.a.v.s.) ka thënë: ***“Lëre atë që të duket e dyshimit, ndërsa përmbaju asaj që nuk të duket e dyshimtë”***.¹¹ Po ashtu Pejgamberi (s.a.v.s.) na e ka bërë të qartë se duhet të largohemi prej të gjitha gjërave që të

9. El-En’am:108.

10. Transmeton Buhariu dhe Muslimi.

11. Transmeton Tirmidhiu dhe Nesaiu.

8. El-E’araf: 33.

shpien te harami: *“Largohuni nga ajo që ju kam ndaluar dhe punoni sa të mundeni nga ato që ju kam urdhëruar, sepse ata që kanë qenë para jush s’i ka shkatërruar asgjë përpos pyetjeve të tepërta dhe papajtueshmërisë (mosrespektimit) të pejgamberëve të tyre”*.¹²

Duke u mbështetur në këto tekste kuptojmë qartë se myslimani e ka detyrë të domosdoshme largimin nga harami dhe kryerjen e asaj që i është urdhëruar, sipas mundësive. Pa dyshim, para se të veprohet e mira dhe e dobishmja na del si detyrë mënjanimi i të keqes.

Mes dijetarëve është e diskutuar çështja e disa gjërave për të cilat, duke mos pasur tekst, mbetet të gjykohet nëse duhen konsideruar haram apo të lejuara. Rreth kësaj çështje dijetarët ndajnë këto mendime:

1. Një grup dijetarësh janë të mendimit se në parim çdo gjë është e ndaluar derisa të mos sillen argumente që vërtetojnë se ajo është e lejuar. Të këtij mendimi janë disa mu’tezili, Ibn Hamid dhe Kadi Ebu Ja’la prej hanbeliteve.

2. Esharitë dhe Ehli hadithi janë të mendimit se sa u takon çështjeve për të cilat nuk ka argument, duhet ndaluar dhe nuk duhet gjykuar pa u sjellë argumenti.

3. Disa dijetarë shafi janë të mendimit se gjërat e dobishme për të cilat nuk ka argument duhet të konsiderohen të lejuara, ndërsa gjërat që janë të dëmshme duhet të konsiderohen të ndaluara në parim.

4. Shumica e hanefive dhe shafive janë të mendimit se çështjet për të cilat nuk ka argument në parim duhet të konsiderohen të lejuara.

Mbështes idenë sipas së cilës çështjet për të cilat nuk ka argument konsiderohen të lejuara për sa kohë nuk sillen argumente që vërtetojnë se ajo vepër quhet haram – e ndaluar. Mendimi i tillë bazohet në këto argumente:

1. Fjalën e Allahut xh.sh.: **“Është Ai që për ju ka krijuar çdo gjë që ka në Tokë...”**¹³

2. Ajetet: **Thuaje: “Kush i ka penguar stollitë dhe ushqimet e këndshme të cilat Ai i ka krijuar për robërit e vet?”**¹⁴

3. **“Sot ju janë lejuar gjërat e mira dhe të pastra...”**¹⁵

4. **Thuaje: “Unë nuk gjej në atë që më është shpallur mua asgjë që e ndalon njeriun të hajë çfarë të dojë përveç kafshëve të ngordhura, gjakut të derdhur...”**¹⁶

5. Fjalën e Pejgamberit (s.a.v.s.): **“Më i madhi krim i myslimanëve është që, nëse dikush i cili është pyetur për diçka jo të ndaluar, i është përgjigjur pyetësit duke i thënë se ajo është haram”**.¹⁷

12. Transmeton Buhariu dhe Muslimi.

13. El-Bekaretu:29.

14. El-E’araf: 32.

15. El-Maide:5.

16. El-En’am: 145.

17. Buhariu, Muslimi dhe Ahmedu.



6. Hadithin e Pejgamberit (s.a.v.s.): **“E lejuar konsiderohet ajo çka e ka lejuar Allahu në librin e Tij. Po ashtu, haram konsiderohet ajo që e ka ndaluar Allahu në Librin e Tij, e atë që e ka lënë në heshtje është e lejuar për ju”**.¹⁸

Nga të gjithë këto argumente del qartë se ato çështje të cilat Ligjdhënësi i ka lënë në heshtje, domethënë pa i përcaktuar nëse janë haram (të ndaluara) apo të lejuara (mubah), ato konsiderohen të lejuara për shkak se po të ishin të ndaluara Allahu xh.sh. do t’i kishte ndaluar, duke qenë se e ndaluar është e dëmshme. Për këtë arsye Allahu xh.sh. thotë: **“Ç’keni ju që të mos hani nga ajo për të cilën është përmendur emri i Allahut, e Ai ju sqaroi juve se çka është e ndaluar për ju, përveç kur jeni të detyruar (atëherë edhe harami është hallall)...”**¹⁹

Pa dyshim se qëllimet e sheriatit islam bazohen parimisht në drejtësi dhe se burimi i sheriatit është nga Ligjdhënësi, i Cili është i Përhershëm dhe i Pafund. Thënë shkurt, sheriatit islam buron nga Ligjdhënësi i vetëm, Allahu xh.sh., ndryshe prej ligjeve të tjera, të cilat burojnë nga njeriu dhe janë me të meta e të papërsosura.

18. Tirmidhiu dhe Ibn Maxheh.

19. El-En’am: 119.



Frika ndaj Allahut xh.sh.

Naim Driçaj

Allahu xh.sh. urdhëron kështu në Kuranin Famëlartë: *“O besimtarë, frikësojuni Allahut dhe çdo njeri le të shikojë se ç’ka përgatitur për të nesërmen! Kijeni frikë Allahun, sepse Ai di çdo gjë që bëni ju!”* (Hashr,18) Përsëri, Allahu xh.sh. thotë: *“O besimtarë! Kijeni frikë Allahun ashtu si i takon Atij dhe vdisni vetëm duke qenë myslimanë!”* (Ali Imran,102)

Treguesi i frikës sonë ndaj Allahut xh.sh. mbështetet në faktin se sa e përmbyjmë veten ndaj gjërave që Ai na i ka ndaluar, si dhe në dëshirën për të kryer sa më parë veprat që na ka urdhëruar. Po ashtu, shenja e dashurisë sonë ndaj Allahut është fakti se deri në ç’masë i zbatojmë veprat për të cilat na ka urdhëruar Allahut xh.sh. apo jo.

Në shumë hadithe të Pejgamberit (a.s.) besimtarëve u tërhiqet vëmendja rreth kësaj çështjeje, duke jua përkujtuar që ta kenë përherë frikë Allahun xh.sh: *“Kini frikë Allahun kudo që të jeni”*. (Tirmidhiu)

Një nga dijetarët, Halimi (Allahu e mëshiroftë!), ka thënë: “Frika ndaj Allahut xh. sh. arrihet atëherë kur njeriu e njeh vetveten”.

Ushqimi i frikës ndaj Allahut xh. sh. në zemra, e çon njeriun në vetëdijen se mbi të sundon përherë mbikëqyrja e Zotit. Dhe kur këto ndjenja e shoqërojnë njeriun vazhdimisht, ai tregon kujdes që të mos kalojë kufijtë e Allahut, qoftë kur është i shoqëruar me njerëz të tjerë, qoftë kur gjendet vetëm. Prandaj, personi që i frikësohet Allahut xh. sh në çdo situatë, fiton mirësinë e Allahut.

I Dërguari (s.a.v.s.) ka përmendur një nga shtatë grupet e njerëzve të cilët do të strehohen nën Hijen e Arshit të Allahut ditën e kijametit, ditë kur nuk ka hije tjetër për-

veç Hijes së tij. Një prej tyre është edhe personi të cilin një grua e bukur e fton për imoralitet, por ai nuk bie në imoralitet duke thënë se i frikësohet Allahut.

Ibn Kajim el Xheuzij (Allahu e mëshiroftë!) ka thënë: *“Frika e pakët nga ana e njeriut rrjedh si pasojë e njohjes së pakët që ky njeri ka për Allahun xh.sh. Më i dituri i njerëzve është ai që ia ka frikën më shumë Zotit xh.sh. “Vërtet, ata që i frikësohen më shumë Allahut nga robët e Tij, janë dijetarët.”* (Fatir, 28)

Në librin e Ibn Kethirit “El-Bidaje ve en-nihaje”(Fillimi dhe mbarimi), thuhet: “Ditën e Kijametit, kur njerëzit afrohen te zjarri i xhehenemit, që të gjithë gjunjëzohen prej frikës së madhe të kësaj dite, ashtu siç ka thënë Allahu i Madhëruar në Kuranin Fisnik: *“Dhe atë ditë e sheh secilin popull të gjunjëzuar...”* (Xhathije,28). E kur i afrohen zjarrit, dëgjojnë zërat e mizorëve që janë duke u dënuar. Të gjithë njerëzit e Pejgamberët, thonë: *“Vetja ime, vetja ime”*, përveç më të mirit të Pejgamberëve, Muhamedit (a.s.) i cili thotë: *“Umeti im, umeti im.”* Atëherë prej xhehenemit teptis një zjarr i madh, të cilin umeti i Muhamedit (a.s.) përpiqet ta shmangë, duke thënë: *“O zjarr, për hatër të atyre që kanë kryer namazin, që kanë dhënë sadaka e që kanë agjëruar, si dhe për nder të njerëzve të devotshëm, kthehu mbrapsht e mos na digj”*, por zjarri nuk ndalet. Në atë çast të tmerrshëm, vjen Xhebraili (a.s.) me një enë të mbushur me ujë dhe thotë: *“Zjarri ka sulmuar umetin e Muhamedit (a.s.)!”* Dhe enën e mbushur me ujë ia dhuron të Dërguarit të Allahut Muhamedit (a.s.) duke i thënë: *“O i Dërguar i Allahut, merre këtë enë dhe me ujin e saj stërpikë zjarrin, e zjarri (me lejen e Zotit) do të ndalet menjëherë!”*

Pejgamberi (a.s.) e pyet: “Çfarë uji është ky, o Xhibril?” Ai i përgjigjet: “O Muhamed, ky ujë janë lotët e besimtarëve që kanë qarë në dynja nga frika e Allahut xh.sh!”.

Frika e njeriut ndaj Allahut xh.sh. varet nga dija dhe devotshmëria që ka njeriu, varet nga besimi që ka ai në Allahun e Lartësuar, **Fudej ibn Ijad** (Allahu e mëshiroftë!) ka thënë: “Frika e njeriut për Zotin është sipas dijes së tij për Zotin.”.

Besimtar i vërtetë është ai që i frikësohet Allahut të Lartësuar me të gjithë gjymtyrët e tij, ashtu siç thotë **Ebul-Lejthi (r.a.)**: “Frika ndaj Allahut shfaqet në shtatë gjëra:

1) Gjuha. E ruan besimtarin nga gënjeshtria, përgojimi, thashethemet, shpifja e nga fjalët e kota, si dhe e bën atë të përkushtohet në përmendjen e Allahut (xh.sh.), në leximin e Kuranit dhe në mësimin e diturisë.

2) Zemra. Besimtari zhduk nga zemra e vet armiqësinë, urrejtjen dhe zilinë që ka ndaj vëllezërve të tij, sepse zilia i davarit veprat e mira, ashtu sikurse thotë **Pejgamberi (a.s.)**:

“Zilia i ha punët e mira, ashtu sikurse ha zjarri drutë”. Dije se zilia është një prej sëmundjeve të mëdha të zemrës, e sëmundjet e zemrës nuk kurohen ndryshe veçse me dituri dhe me punë.

3) Shikimi. Nuk ndalet në gjërat e ndaluara, si në ushqim, pije, veshje etj., e as nuk e shikon dynjanë me syrin e epshit, por shikimin e përdor vetëm për të marrë mësim.

4) Barku. Besimtari nuk fut në barkun e tij diçka të cilën Allahu (xh.sh.) e ka ndaluar.

5) Dora. Besimtari nuk e zgjat dorën e tij drejt gjërave të ndaluara (haram), por vetëm aty ku fitohet kënaqësia e Allahut të Madhëruar.

6) Këmba. Besimtari nuk shkon në ato vende ku i bëhet mëkat Allahut, por shkon në ato vende për të cilat Allahu është i kënaqur, siç është shoqërimi me dijetarë dhe me njerëz të mirë.

7) Bindja ndaj Zotit (xh.sh.). Besimtari duhet t’i bindet Atij me një bindje të sinqertë dhe çdo vepër të mirë ta bëjë vetëm për hir të Tij, duke iu ruajtur njëkohësisht syfaqësisë (rijasë) dhe hipokrizisë (nifakut). Pra, nëse një besimtar i vë në zbatim këto shtatë cilësi, atëherë ai pa dyshim është prej atyre për të cilët është shprehur Allahu në Kuran: “*Kurse jeta tjetër te Zoti yt është për punëdrejtët që ruhen (nga gjynahet dhe nga dënimi i Allahut).*” (Zuh-ruf, 35)

Besimi, nuk është thjesht pretendim, as ndonjë gjë që varet në qafë për t’u dukur i bukur, por është bindja që shprehet me gojë, që zë vend në zemrën e njeriut dhe dëshmohet me kryerjen e veprave.

Në kohën e Musait (a.s.) jetonte një njeri i devotshëm. Ai kishte shumë fëmijë dhe ishte mjaft i varfër. Një ditë

prej ditësh atë e kaploi një varfëri aq e madhe, sa nuk i mbeti gjë prej gjëje për të ushqyer fëmijët e tij. Meqenëse ishte i sëmurë dhe i pafuqishëm për të lëvizur nga shtrati, ai e dërgoi gruan e tij në qytet që të kërkonte ushqim për familjen. Gruaja shkoi me vrap në shtëpinë e një tregtari dhe i kërkoj ushqim për fëmijët e saj. Tregtari iu përgjigj se pranonte ta ndihmonte, por me një kusht: që ajo të bënte imoralitet me të! Kur dëgjoi fjalët e tij, gruaja heshti dhe u kthye në shtëpi duarthatë. Fëmijët filluan të qanin me të madhe: Oh, nëna jonë, ne jemi duke vdekur nga uria, prandaj na jep diçka për të ngrënë?

Nëna me zemër të pikëlluar shkoi përsëri tek tregtari dhe i tregoi për gjendjen e vështirë të fëmijëve të saj, në mënyrë që ai të tregonte sadopak mëshirë dhe ta ndihmonte. Por ai prapë i tha se, nëse dëshironte ta ndihmonte, duhej që më së pari ajo t’ia përmbushte kërkesën e tij! Më në fund, gruaja pranoi dhe kur u hoqën mënjanë vetëm për vetëm, ajo filloi të dridhej.

Ai e pyeti:

–Çke, përse dridhesh?

Gruaja u përgjigj:

–Unë i frikësohem Allahut.

Papritmas, burri u ndal dhe pasi u mendua pak, i tha: “Kur ti në këtë gjendje që je, e ke frikë Allahun e Madhëruar, atëherë unë që jetoj në bollëk duhet të kem frikë prej Tij edhe më shumë sesa ti, prandaj merri këto ushqime dhe dërgojua fëmijëve të tu, sepse unë s’kam për të të bërë asgjë.

Gruaja e ndershme u kthye e gëzuar tek fëmijët e saj, të cilët, kur e panë që kish sjellë tërë ato ushqime, u gëzuan tej mase. Atëherë, Allahu (xh.sh.) i shpalli Musasë (a.s.): “*Thuajti filanit se ia kam falur gjynahet*”.

Musa (a.s.) shkoi tek ai, ashtu siç e kish e porositur Zoti i tij dhe i tha: “O njeri, ndoshta ti ke bërë diçka të mirë që është mes teje e Zotit?!” Atëherë burri ia tregoi ngjarjen me hollësi. Me atë rast, Musai (a.s.) i tha: Vërtet Allahu i Lartësuar t’i ka falur gjynahet...**(Ky tregim gjendet në librin “Mexhmeul-letaifi”)**

Disa nga Selefët kanë thënë: “Ai që është më i ditur, ai i frikësohet më shumë Allahut (xh.sh.)” **“Allahut ia kanë frikën më shumë dijetarët nga robërit e Tij.”** (Fatir, 28)

Ajo që e pohon dhe e mbështet këtë të vërtetë, është edhe thënia e Pejgamberit a.s: “*Unë i frikësohem Allahut (xh.sh.) më shumë se sa ju.*” (Buhari Muslim).

Në një hadith të transmetuar nga Tirmidhiu, Pejgamberi (a.s.) ka thënë: Sytë e dy grupeve të njerëzve nuk do t’i prekë zjarri (i Xhehenemit): Syri që qan nga frika e Allahut, dhe syri që rri natën vigilent në rrugën e Allahut (xh.sh.).

Haxhi Faik Hoxha

një jetë plot besim e përkushtim

Muhamed Sylari

"Unë nuk i kërkoj temat, ato më gjejnë vetë dhe kështu kam shkruar atë që duhet shkruar" - thoshte poeti i madh Horhe Luis Borhes. Ndoshta, kjo ka ngjarë edhe në lidhjen time me idenë dhe dëshirën për t'u angazhuar me këtë veprimtari që po organizojmë. Pikërisht heshtja e madhe, me të cilën është rrethuar personaliteti i myftiut H. Faik Hoxha (më jetëgjati në drejtimin e kësaj detyre të vështirë, aq më tepër në një qytet si Shkodra e pas viteve 1990) dhe elementë të shumtë përreth saj, që e bëjnë më intriguese, më kanë "thirrur" dhe më kanë "kërkuar", për t'u bërë nxitësit kryesorë që në një ditë të bukur si kjo, të mbledhemi dhe të nderojmë këtë burrë, që kaderi e solli të ishte myfti i Shkodrës për 12 vite me radhë!

Çfarë përfaqëson H. Faik Hoxha në mesin e një vargu të gjatë hoxhallarësh, myftilerësh e shërbyesish të përkushtuar ndaj Thirrjes Islame në vendin tonë?

Çfarë kontributi ka në lëvizjen islame të këtyre dy dekadave të fundit, në Shkodër, por jo vetëm?

E, para duarve të këtij 80 vjetori, si e ndjen veten ai përpara pasqyrës së jetës?

Jeta e këtij burri 80 vjeçar ka qenë plot vuajtje, munde, por edhe të papritura të këndshme...

Dymbëdhjetë vite në krye të myftinisë Shkodër dhe tetë dekada që mban mbi supë, janë tashmë një thesar

i çmuar plot eksperiencë të rralla humane, kujtime brezash, sakrificë të tëra në rrugën e ruajtjes së identitetit islam. Pengesa të shumta të kaluara në mbrojtje të adhurimeve, riteve fetare islame dhe lidhjes së sinqertë me Zotin; nga ky njeri i shquar me ngjarjet bashkudhëtare, kthehen në elementë të rëndësishëm të historisë tonë fetare e kombëtare dhe domosdoshmërisht duhet të njihen nga të gjithë, veçanërisht nga brezi i ri.

Haxhi Faik Hoxha u lind më 14 prill 1930 në Shkodër. Pas gjashtë javësh ai shkon në Durrës, ku babai i tij, Sheh Qazim Hoxha, shërbente si vaiz. Po atë vit, i ati me familje shpërngulen në Tiranë.

Për marrëdhënien e tij me të atin, ai kujton: *"Në periudhën e fëmijërisë, më afër kam qenë me nënën time, pasi babai në të shumtën e kohës ishte i zënë, si Sheh, si myderriz në medresenë e Tiranës etj. Kur kam hyrë në medrese, kam patur një lidhje të fortë me babain, sa që e kam dashur më shumë se nënën. Kujtoj, se kur vinte sezoni i verës dhe familja ime shkonte në Shkodër, unë rrija vetëm me babain tim. E kam dashur si prind, por edhe si mësues, pasi prej tij kam mësuar rregullat e para të fesë. E kishte zakon të më mësonte gjatë verës lëndët e vitit që vinte. Kështu, kur fillonte viti i ri shkollor, unë i dija mësimet që herët. Kjo më ka ndihmuar të jem i pari i klasës."*

Natyrshtë, lidhja shpirtërore me të atin, dijetarin e shquar, komentatorin e Kuranit dhe udhëheqësin shpirtëror të një pjese të mirë të klasës intelektuale islame të kohës së tij, Sheh Qazim Hoxha, do të jepte frytet e saj legjitime në formimin besimor, intelektual, qytetar e largpamës të Haxhi Faik Hoxhës.

Nga viti 1935-1939, ai kryen shkollën fillore në Tiranë. Gjatë kësaj kohe ai kujton edhe porositë e vyera të drejtorit të shkollës për mbrojtjen e flamurit shqiptar, në një kohë kur vendin tonë e kishte pushtuar Italia.

Nga viti 1939-1948, ai vazhdon me sukses dhe kryen

me nota të shkëlqyera Medresenë e Përgjithshme të Tiranës. Më pas, lidhja e tij me këtë medrese do të vazhdojë, ku emërohet mësues i arabishtes, besimit, predikimit etj. dhe vazhdon të qëndrojë në këtë funksion për një vit e gjysëm deri në vitin 1952.

Pas lirimit nga shërbimi ushtarak, ai detyrohet të merret me një punë, larg origjinës së formimit të tij. Për këtë, ai dëshmon: *“Ato vite ishin të vështira. Unë sapo isha martuar. Nëna ime ishte e moshuar dhe kishte nevojë për një krah në shtëpi. Nga ana tjetër, edhe Komunitetit Mysliman po i ngushtohesh rrethi i veprimtarisë. Mundësia për të shkuar me shërbim fetar jashtë Shkodrës ishte e vështirë, kështu u detyrova të gjej një punë tjetër, deri më 4 qershor 1966, kur jam arrestuar dhe jam burgosur.”*

Nga viti 1966-1989, vuan 23 vite burgim në birucat e sistemit më të çmendur të kohërave, sistemi i armiqësimit me miqtë e Zotit dhe besimtarët e Tij!

Me ndryshimet politike dhe rigjallërimin e jetës fetare në vend, pas formimit të Bashkësisë Islame në Shqipëri, në fillimet e vitit 1991, me propozimin e Hafiz Sabri Koçit, Haxhi Faik Hoxha përzgjidhet si myfti i Shkodrës, detyrë të cilën e mban me dinjitet deri në vitin 2003, kur për arsye shëndetësore jep dorëheqjen e tij.

Periudha 12 vjeçare e myftinisë së H. Faik Hoxhës është e mbushur me ndodhi të shumta, duke filluar nga përpjekjet për rimëkëmbjen e jetës fetare dhe institucioneve islame në vend e deri në përrurimin e xhamisë madhështore të Parrucës.

Gjatë kësaj periudhe 12 vjeçare, myftinia Shkodër nën drejtimin e tij ka luajtur një rol të rëndësishëm në promovimin e vlerave të pastra islame, qytetare e kombëtare. Në ruajtjen, kultivimin dhe përhapjen e mësimave të Kuranit, Traditës Muhamedane, si shpresa dhe optimizmi për një jetë dhe një të ardhme më të mirë për shoqërinë shqiptare e mbarë kombin, edukimi i brezave të rinj me moralin e fesë dhe besimit në Një Zot, solidarizimi me njerëzit në nevojë, nxitja e harmonisë ndërfaqetare.

Ditë pas dite, institucioni i myftinisë Shkodër nën drejtimin e tij po rimëkëmbet, ndonëse “kabilët” e kohës nuk reshtën asnjëherë në përpjekjet e tyre të dështuara për ta ndaluar hovin dhe angazhimet e lavdëruara në këtë drejtim.

Xhamisë së vjetër të Plumbit nisën t’i shtohen edhe shumë xhami të reja. 9 xhami në qytet e 38 në fshatrat e Shkodrës janë dëshmitari më i mirë i kësaj ringjallje. Literatura e re fetare islame nisi të qarkullonte në duart e besimtarëve, sidomos të rinjve të pasionuar pas fesë së gjyshërve. Dijetarët islamë shqiptarë në mërgim dhanë kontributin e tyre të vyer e të pakursyer. Kurset fetare gjallëruan procesin e ripërtëritjes islame. Shumë të rinj

myslimanë u dërguan për plotësimin e studimeve islame jashtë vendit dhe u kthyen teologë, thirrës islamë, hoxhallarë e shërbeyes në rrugën e udhëzimit islam.

Haxhi Faik Hoxha meriton respekt dhe nderim të madh edhe për faktin se me kurajon e tij, ai nuk u dorëzua në vitet më të vështira të krijimit të një institucioni islam, si myftinia Shkodër e dekadës së fundit të shekullit që kaloi. Njerëzit ishin të varfër. Kuadro fetarë kompetentë nuk kishin mbetur më! E megjithatë, me urtësinë e tij, me afrimin e intelektualëve myslimanë, besimtarëve të vjetër, trashëgimisë së viteve të shkuara e përpjekjeve të shumta, ai arriti që jeta fetare islame të gjallërohej e të lulëzonte vit pas viti. Aktivitete të shumta fetare e kulturore, hapja e medresesë së re të qytetit, mevludet nëpër xhamitë e ndryshme, në qytet e sidomos në fshat, mukabelet e Kuranit në Ramazan, vaset e larmishme etj, arritën t’i japin ngjyresën islame jetës fetare në qytetin tonë të lashtë.

“Jam i vetëdijshëm se çfarë ka qenë në dorën time për t’u bërë, është bërë me aq sa kam patur mundësi!” – më tha një ditë teksa e pyesja për vështirësitë e kohërave të shkuara.

Gjatë kësaj periudhe 12 vjeçare, puna dhe veprimtaria e myftiut Haxhi Faik Hoxha është vlerësuar maksimalisht edhe nga presidenti i Republikës, Këshilli Bashkiak Shkodër, Akademia e Shkencave Tiranë, Kryesia e K. M. Sh etj. Ai është vlerësuar si një prijës fetar që me punën e tij ka mbjellur urtësi, besim, qytetari, harmoni, shpresë e optimizëm, si një pishtar i ringjalljes së vlerave islame, mbrojtës i interesave kombëtare.

Dhe në përfundim të fjalës sime, kam dëshirë ta kthej kokën nga e kaluara e kujtimeve të Haxhi Faik Hoxhës. Aty është edhe babai, njëkohësisht udhëheqësi i tij shpirtëror Sheh Qazim Hoxha...

“Kujtoj një herë, se në shtëpi erdhi një letër për babën. Ia dërgonte një nga shehlerët e Sudanit. Në të i shkruante: Iu luta Resulull-llahit (a.s.) të më njihte me një nga shehlerët tixhani, larg vendit tim. Resulull-llahi (a.s.) më tha: “Shkruaj: Qazim Hoxha, myderriz në medresenë e Tiranës!” Me anë të kësaj letre, ai i dërgonte babës edhe ixhazetin e tij në shenjë respekti. Kjo letër ka ekzistuar dhe e kam parë me sytë e mi!” – rrëfen ai me shumë nostalgji.

Natyrshëm, në këtë emocion të këtij kujtimi kaq të veçantë, nuk ka sesi të mos mendojmë se lutjet e singerta për mbarësi e begati të një Shehu të afërt me Resulull-lahin (a.s.), kanë shoqëruar çdo ditë të jetës së tij myftiut e Shkodrës, Haxhi Faik Hoxha. Në një farë mënyre, ata kanë qenë kredojat e tij shpirtërore, busulla e tij orientuese, feneri ndriçues i një myftinie në krye të së cilës ai u bë shembull dhe mbeti simbol nderi e krenarie!



Historia e djaloshit trim që dëshironte të bënte një tatuazh

Ilir Rruga

Një djalosh i ri shkoi tek tatuisti dhe i tha t'i bënte një tatuazh.

Tatuisti e pyeti:

-Djalosh trim, më thuaj çfarë tatuazhi dëshiron të të bëj?

Ai u përgjigj:

- Një luan që ulërin. Ta dish se edhe pagesa ime do të jetë si e një luani, kështu që më bëj tatuazhin e një luani të vërtetë. Ngjyra le të jetë e mjaftueshme.

- Në cilin vend të trupit dëshiron të ta bëj tatuazhin?

- Në mes të shpatullave.

Sapo tatuisti filloi t'i ngulte gjilpërën, djali e ndjeu dhimbjen e gjilpërës deri në palcë. Pas kësaj, bërtiti duke thënë: Të lutem mjeshtër ki kujdes, se më mbyte! Çfarë je duke bërë kështu?

Mjeshtri tha:

-Ju vetë më thatë t'ju bëja një luan.

Djaloshi pyeti:

- Nga ku e keni filluar tatuazhin?

- Nga bishti.

- Oh ju lutem, lërë fare bishtin. Dhimbja e bërjes së bishtit më bllokoi edhe frymëmarrjen. Lërë bishtin, le

të jetë një luan pa bisht. Për ndryshe, do më bjerë të fikët nga plaga e gjilpërës.

Ustai, filloi të merrej me pjesën tjetër të luanit, por në një mënyrë të pamëshirshme dhe pa treguar ndonjë dhembshuri. Trimi filloi të bërtiste sërish me të madhe dhe përsëri e pyeti:

- Cilën pjesë të luanit je duke bërë tani?

- Veshët.

- Lërë, le të jetë pa veshë. Mos i bëj as ato.

Kur Ustai filloi të pikturonte një pjesë tjetër të luanit, djaloshi filloi të bërtiste prapë, duke thënë:

- Cilën pjesë të luanit po bën kështu, me gjilpërën e tretë?

- Barkun, i dashur.

- Po më dhemb tej mase, mos e ngul gjilpërën kaq shumë, lërë, le të jetë fare pa bark.

Tatuisti u habit shumë dhe për një kohë ngeli si i shushatur. Më pas, duke hedhur gjilpërën në tokë, i tha djaloshit trim: "*Vallë, a ka ndonjë njeri tjetër në botë që të bjerë në gjendjen tënde? Ku është parë në botë ndonjë luan pa bisht, pa kokë, pa veshë dhe pa bark? Edhe Allahu i madhëruar nuk ka krijuar një luan të tillë!*"¹

Transmetimi i kësaj historie ka si qëllim t'u japë

1. Mesnevi, I, 2980-3000.

shembull myslimanëve modernë dhe inteligjencës Islame.² Në këtë histori, dëshira për të bërë një tatuazh, përfytyrohet me dëshirën e myslimanit modern, i cili dëshiron të jetojë Islamin e plotë, por duke braktisur sunetin e profetit Muhamed (s.a.v.s.) dhe disa farze të Islamit sipas dëshirave të tij. Kur thirren për në namaz, do të vëresh se ata të japin një përgjigje të tillë: “Oh ju lutem; pesë kohë namaz në ditë na marrin shumë kohë, akoma më e lodhshme është marrja e abdesit. Ne, vërtet dëshirojmë ta falim namazin, por do ta bënim këtë nëse marrja e abdesit do të kufizohej vetëm me larjen e duarve dhe të fytyrës, sikur t’i ulim namazet në dy kohë, si dhe nëse do të hiqnim disa veprime gjatë namazit, siç janë rukû’, suxhûd (rënia në sexhde), kuûd (të qëndruarit në këmbë). Ne jemi njerëz të dobët dhe të zënë me punë, kështu që ku janë ata dijetarë të lartë në ditët e sotme, që mund t’i falin pesë kohët e namazit me gjithë rregullat e tij gjatë ditës?”³

Nëse do u kujtohet agjërimi, ata do të shprehin: Njeriun e shqetëson dhe e bën të sëmurë të qëndruarit pa ngrënë; ndërsa nëse do u kujtohet dhënia e Zekatit, ata do të thonin, dhënia e dy përqind të ardhurave çdo vit nuk është një shumë e vogël; nga ana tjetër, çfarë të drejtash kanë të varfrit tek pasuria që kam fituar me djersën time! Por nëse do t’u flitej për vajtjen në Haxh, ata do të përgjigjeshin me fjalët se: “kjo nuk ka qëllim tjetër, vetëm të ndihmojë popullsinë që jeton në shkretëtirë. Përse duhet të jemi të urdhëruar? Përse ta kemi të detyruar të shkojmë tek këmbët e tyre dhe t’i ndihmojmë!”

Duhet ta dimë mirë që feja është një urdhër Hyjnor. Është një harmoni, një rregull Hyjnor dhe kurrësi nuk mund të mendohet ndryshimi i saj sipas dëshirave dhe përfitimeve tona. Allahu i madhëruar thotë në Kuranin Famëlartë: **“Mos i thoni asaj rrenës së gjuhëve tua: ‘Kjo është ballall e kjo është haram’ e të shpifni ndaj Allahut rrenën. Vërtet, ata që shpifin rrenën ndaj Allahut, nuk kanë shpëtim.”**⁴

Ai që i thotë vetes mysliman ndërkohë që shfaq sjellje të tilla, do t’i ngjajë luanit pa bisht, pa bark, pa veshë e pa kokë. Ashtu si nuk mund të kemi një luan të tillë, po ashtu nuk mund të jetë mysliman ai që nuk pranon farzet (urdhërat) dhe nuk qëndron larg prej harameve

(ndalesave), gjë për të cilën na ka urdhëruar Allahu (xh.sh.). Dikush që i thotë vetes mysliman, duhet që së pari të pranojë të gjithë urdhrat dhe ndalesat e Islamit, siç kanë ardhur nga ana e Allahut (xh.sh.).

Qëllimin e paraqitjes së këtij rrëfimi e kemi marrë nga Mesnevi. Në fundin e historisë thuhet: “Vëlla, duro nga dhimbja e gjilpërës, me qëllim që të shpëtosh nga dhimbja e gjilpërës së nefsit tënd jobesimtar”.⁵

Pra, tregohu i durueshëm përpara dhimbjeve dhe fatkeqësive me të cilat mund të përballesh gjatë jetës, me qëllim që t’i shmangesh nënshtrimit ndaj nefsit (epshit) tënd.⁶

Shkurtimisht, për të zotëruar një moral dhe një pjekuri shpirtërore, duhet të qëndrojmë me durim përpara dëshirave të nefsit, epsheve, mendjemadhësisë dhe mburrjeve tona. Nuk mund ta arrijmë suksesin nëse nuk i marrim parasysh pasojat gjatë udhëtimit tonë. Por, kurrësi nuk duhet të na frenojnë pengesat ose vështirësitë që hasim gjatë udhëtimit tonë. Nuk duhet të harrojmë se në një Hadith Kudsi Allahu i madhëruar thotë: **“Kush ka për qëllim të veprojë një punë të mirë dhe nuk e bën atë, Allahu (xh.sh.) ia shkruan një shpërblim sikur e ka vepruar atë. Por kush ka për qëllim të bëjë një vepër të mirë dhe e vepron atë, Allahu (xh.sh.) ia shkruan shpërblimin nga dhjetë deri në shtatëqind fish, ose akoma më shumë.”**⁷

Në mbyllje, detyra jonë është të përulemi përpara urdhrave të Krijuesit, sepse ne e dimë që Krijuesi ka vendosur ligjet më të mira dhe më të përshtatshme për robërit e Tij, duke mos harruar se Allahu është “Âdil” (i Drejtë) dhe Allahu nuk u bën padrejtësi asnjë robi të tij, gjë të cilën e shikojmë edhe në këto ajete, ku Allahu i madhëruar thotë: **“E kush punoi ndonjë të mirë, që peshon sa grimca, atë do ta gjejë. Dhe kush punoi ndonjë të keqe, që peshon sa grimca, atë do ta gjejë.”**⁸ Gjatë gjithë jetës së tij, duke ecur me shpresë në mëshirën dhe duke u frikësuar nga dënimi i Allahut (xh.sh.), myslimani synon të shpëtojë jo vetëm veten e tij, por edhe mjedisin që e rrethon.

5. Mesnevi, I/3001.

6. Tahirü'l-Mevlevî, *Şerh-i Mesnevi*, Konya 1966, fq. 1406.

7. Buhari: Rikak: 31, Muslim, Ibni Maxhe, Ebu Davud, Ti - midhi, Nesâi, Hadithe Kudsi nga Muvatta', Madve Yayınları: 105-106.

8. Sure Zilzal 099/ 7-8.

2. Ismail Güleç, *Türk Edebiyatında Mesnevi Tercüme Ve Şerhleri*, Pan Yay, İstanbul 2008, fq. 32-33.

3. Ismail Güleç, *Türk Edebiyatında Mesnevi Tercüme Ve Şerhleri*, Pan Yay, İstanbul 2008, fq. 32-33.

4. Sure Nahl 016/116.

Veglat muzikore në Islam dhe ndikimi i tyre në muzikën perëndimore

Mr. Abas Jahja

Ekziston një instrument tjetër arab, i njohur me emrin “Rebab”, të cilin më vonë francezët e quajtën rubella, kurse Italianët rubeca. Me kalimin e kohës, ky instrument pësoi disa ndryshime të vogla dhe në shekullin e XV- të mori emrin viola.

Islami përmban një thesar shumë të madh kulturo-artistik dhe nuk ka dyshim se me zgjerimin e kufijve Islam dhe me kalimin e myslimanëve në Spanjë, ata patën ndikim të madh në mbarë Europën, si në aspektin shkencor, ashtu dhe në atë kulturor e artistik.

Ne në këtë shkrim do të ndalemi në aspektin e artit muzikor dhe të instrumenteve muzikore.

Europa e ka dhuratë nga myslimanët edhe origjinën e shumë instrumenteve muzikore. Ky ndikim fillon nga shekulli i IX- të.

Edhe sot, po t'i analizojmë emrat e instrumenteve muzikore perëndimore, mund t'i zbërthejmë lehtë dhe të vërejmë se origjina e tyre gjendet në fjalët me prejardhje arabe. Kështu për shembull, fjala “Al-ud” është marrë nga gjuha Arabe dhe është përshtatur pothuajse në të gjitha gjuhët europiane si: në spanjisht *laud*, në portugalisht *alaude*, në suedisht *lute*, në anglisht *lute*, në frëngjisht *luth*, në italisht *liuto*, në gjermanisht *laute*, në danisht *lut*, në rusisht *llutnja*, në polonisht *lutina* dhe në gjuhën shqipe *lahuta*.

Ky instrument ka një zë shumë mahnitës dhe me kalimin e tij në Spanjë, u bë i njohur në tërë Europën. Ekzistojnë mendime se këtë instrument e ka shpikur filozofi i madh mysliman, Farabiu, por faktet historike tregojnë se Udi ka ekzistuar edhe para Farabiut, ndaj mund të themi me siguri se ai ka bërë disa ndryshime në këtë instrument, duke e ripërtërirë atë, sepse në shkrimet tona të më hershme kemi cekur që ai ishte njohës i mirë i teorisë së muzikës, por ai ishte virtuoz Udi. Po ashtu, ai ishte edhe virtuoz i kanunit.

Kanuni është një instrument që përbëhet nga 78 tela. Në disa raste, numri i telave mund të ndryshojë sipas vetë llojit të kanunit, gjë që varet nga madhësia e tij, arsye për të cilën disa prej tyre janë me 72 tela. Fjala kanun do të thotë ligj. Këtu bëhet fjalë për ligjin e instrumenteve, sepse kanuni është marrë si bazë e të gjitha instrumenteve.

Pianoja e Europës ka marrë modelin ose shembullin nga kanuni, dallimi qëndron në atë se te pianoja, telave u bihet nëpërmjet tastave.

Duhet theksuar se në këtë periudhë muzikantët evropianë shkonin nëpër qytetet kryesore arabe, në institutet dhe universitetet e të cilave mësonin shkencën dhe artin. Mes të gjitha arteve të tjera, muzika ishte në rend të parë. U përkthyen veprat e El-Kindiut. Farabiut, Ihvanu es Safa, Ibni Sinas dhe u studiua ho-

Ilësisht vepra e Safijjuddin Urmeviut.

Përveç instrumenteve, europianët kanë marrë edhe terma të veçantë muzikor. Sipas disa muzikologëve, termi “Trubadur” vjen nga fjala arabe “Dur Tarb”, që do të thotë shtëpia e argëtimit.

Padyshim që duhet të përmendim edhe instrumentin e mirënjohur, kitarën, e cila vjen nga fjala Arabe “el-Kajtara”, pastaj El-Daff-adufe (def ose daire), Al-Sumug-Sonajas (cimbali), Al-Nafir-anafil (trompetë e vjetër), Al-Karn-corn (bri).

Ekziston një instrument tjetër arab, i njohur me emrin “Rebab”, të cilin më vonë francezët e quajtën rubella, kurse italianët rubeca. Me kalimin e kohës, ky instrument pësoi disa ndryshime të herëpashershme, derisa në shekullin XV mori emrin viola.

Një ndër instrumentet më të rëndësishme, posaçërisht në muzikën fetare është naji. Termi vjen nga gjuha persiane dhe lidhet me një instrument frymor të përhapur në të gjitha vendet Islame. Ky instrument prodhohet nga kallami. Duhet të theksojmë se stili dhe mënyra e fryrjes është e ndryshme mes popujve myslimanë. Mënyra e fryrjes tek Iranianët është se tek ata naji vendoset midis dhëmbëve e jo në buzën e ekzekutuesit. Kjo mënyrë e përdorimit i jep tingullit një veçori dalluese. Ndërsa arabët i fryjnë këtij instrumenti me buzë. Po ashtu, ekziston dallim në lidhje me këtë edhe mes arabëve e turqve. Në pjesën e sipërme, turqit vendosën edhe një pjesë tjetër përbërëse, e veç kësaj e realizojnë këtë instrument duke përdorur bririn e kaut. Pjesa e shtuar bën që nga naji të dalin tinguj më të thellë e më shpirtërorë. Ne bëmë këtu një paraqitje të shkurtër të najit, por mendoj se për

këtë instrument duhet të flasim më gjerësisht. Kësisoj, në shkrimet vijuese do të kemi një qasje më të gjerë lidhur me të, duke pasur parasysh historikun dhe simbolizmin e këtij instrumenti shumë të vjetër.

Duhet të theksojmë se rebabi, instrumenti që përmendëm më sipër, u përdor nga persianët, arabët e turqit dhe është një instrument që ekzistonte qysh para ardhjes së Islamit. Kjo vegël muzikore vazhdoi të përdorej edhe gjatë shekujve që pasuan e pati ndikim të madh edhe në Europë. Me kohë, forma e saj në përdim pësoi ndryshime, kështu që prej instrumentit origjinal lindën instrumente si viola, violina, violonçeli dhe kontrabasi.

Mund të themi lirisht se arti muzikor islam është një thesar i pafund dhe i pashterur, si në aspektin e veglave muzikore, ashtu edhe në aspektin e teorisë së muzikës.

Gjatë historisë kemi pasur ekzekutues të famshëm të instrumenteve të ndryshme muzikore, si solistë të famshëm dhe teoricienë të mëdhenj. Këto personalitete kanë lënë gjurmë të thella dhe ndikim të madh në artin e muzikës perëndimore.

Në mbyllje, mund të themi se muzika është pasqyra e një populli, ose me fjalë tjera ajo është elementi që tregon shkallën dhe lartësinë e nivelit kulturor të një populli. Nëse dëshirojmë të vlerësojmë se sa i ngritur është një popull, duhet të shqyrtojmë nivelin dhe cilësinë e muzikës së atij populli. Filozofi i madh kinez, Konfuc, thotë: *“Nëse është prishur muzika e një populli, mund të arrijmë në përfundimin se tek ai popull janë prishur edhe shumë vlera të tjera njerëzore”*.



Ditari i Daut Boriçit

Sundimi disashekullor osman në trevat shqiptare la gjurmë të pashlyeshme në rrugën e zhvillimit kombëtar shqiptar. Së pari, elementi shqiptar u strehua shumë mirë brenda strukturës osmane, falë aftësive të tyre të lindura dhe veçorive karakteristike vitale të kombit shqiptar. Pozicionimi i elementit shqiptar në tërë institucionet osmane, deri në pikat më të larta të hierarkisë administrative osmane, i hapi rrugën zhvillimeve të reja e gjithëpërfshirëse në trevat shqiptare.


Përkrah zhvillimeve ekonomike, ushtarake dhe shoqërore, u bënë përparime edhe në fushën e arsimit. Një prej burimeve të ruajtura në Shqipëri është edhe ditari i Daut Boriçit.

Daut Boriçi është i njohur për aktivitetin e tij politik më shumë se atë arsimor. Ai shkroi mjaft vepra si në gjuhën turke-osmane, ashtu edhe në gjuhën shqipe. Mes veprave që ai ka lënë në dorëshkrim njihen Di-

tarët, Elif-Baja, Gramatika e Gjuhës Shqipe, Fjalori turqisht-shqip, dy fashikuj për shkollat ruzhdije, si dhe një autobiografi që nuk dihet se ku gjendet sot.

Punimi shkencor i njërës prej ditarëve të Daut Boriçit është kryer nga mag. Ali Bardhi, i cili në punimin e tij për gradën master ka botuar edhe faksimilet e dorëshkrimeve. Artikulli ynë bazohet në të dhënat e këtij studimi dinjitoz shterues, i cili shpresojmë se do ta shohë sa më parë dritën e botimit, duke i ofruar kështu botës së studimeve një botim tjetër të plotë, i cili hedh dritë mbi gjendjen arsimore në Shqipërinë Veriore gjatë sundimit osman në fundin e shek. XIX.

Mes tjerash, nga Daut Boriçi kanë ardhur deri në ditët e sotme dy ditarë, të cilët përmbajnë të dhëna për periudhat 1884-1850 dhe 1893-1895. Të dy ditarët përbëjnë një volum prej 500 faqesh. Regjistrat u ruajtën nga Shefqet Muka, një intelektual i njohur ar-



simdashës shkodran, i cili e njihte shumë mirë vlerën e tyre. Thuhet se gjatë sundimit komunist në Shqipëri, këto vepra u fshehën nëpër muret e shtëpisë së familjes Muka. Megjithatë, kjo bëri që disa fletë të dëmtoheshin nga lagështira. Në tezën e tij, mag. Ali Bardhi ka transkriptuar vetëm një nga ditarët, atë që përmban më shumë të dhëna të natyrës dokumentare në lidhje me arsimin në Shqipërinë Veriore, ndërsa në lidhje me ditarin e dytë, ai thjesht na njofton se përmban më shumë të dhëna të natyrës ekonomike. Pa dyshim që një përpunim i këtyre të dhënave do mund të nxjerrë në pah aspekte të jetës ekonomike, arsimore dhe shoqërore.

Përpunimi i materialit të ditarit hedh dritë mbi fusha të ndryshme të jetës arsimore në Shqipëri. Ditari përmban të dhëna për shkollat (mejtepet), mësuesit dhe bazën materiale arsimore në këtë periudhë. Në sistemin arsimor osman mejtepet ndaheshin në iptidai (fillore). Në ditar ka të dhëna në lidhje me ndërtimin e shkollave, të cilat gjatë kësaj kohe ndërtoheshin me ndihmat e mbledhura nga populli, ose me fondet e caktuara nga Ministria e Arsimit. Në qoftë se Ministria e Arsimit e shihte të pamundur ndarjen e fondit të caktuar, atëherë kërkohej që të ardhurat të mbledheshin nga popullsia. Personave që nuk mund të jepnin asnjë gjë ngaqë ishin të varfër, u kërkohej të kontribuonin duke punuar dy ditë pa shpërblym. Në rastet kur shtëpitë myslimane ishin të vogla në numër, gjë që nuk e mundësonte ndërtimin e një mejtepi në secilën prej tyre, atëherë caktohej një fshat ku do të ndërtohej mejtepi, i cili do të mund të shërbente si qendër ku do të mbledheshin nxënësit e të gjitha zonave përreth. Sipas të dhënave të përshkruara të regjistrit në fjalë, në rast se nuk kishte ndonjë burim tjetër të ardhurash, pagesa e mësuesve të shkollave fillore mund të mbulohej nga bashkia e Shkodrës. Në ditarin e Daut Boriçit bëhet fjalë edhe për programin arsimor që zbatohet në shkollat fillore, tregohet mënyra se si bëhej regjistrimi i nxënësve nëpër shkolla dhe çfarë dënimesh parashiheshin në rast se ata nuk e ndiqnin mësimin e detyruar. Ditari na mundëson të kuptojmë edhe shtrirjen që kishte arsimimi fillor në vilajetin e Shkodrës gjatë periudhës në të cilën Daut efendi Boriçi shërbente si inspektor. Nga të dhënat në ditar, mund të themi se në të gjithë vilajetin e Shkodrës gjendeshin plot 48 mejtepe, 32 prej të cilave vetëm brenda sanxhakut të Shkodrës. Kjo shifër vlen për periudhën kur punoi Daut Boriçi, pasi në vitin 1905-1906 sipas vjetarit të arsimit, dimë që në vilajetin në fjalë gjende-

shin 74 shkolla të tilla. Edukimi i mesëm në arsimin osman kryhej në shkollat e quajtura Ruzhdiye. Vlen të përmendet ruzhdiya e Ulqinit, e cila po sipas ditarit u ndërtua në vitin 1871, në të cilën shërbente si mësues Ibrahim efendi Shkodrani. Në shkollat ruzhdiye mësohej akaid, arabisht, persisht, turqisht (osmanisht), aritmetikë, gjeometri, diktat, llogari, histori, vizatim, shkrime osmane (sulus, divani dhe rika).

Veç kësaj, në ditar flitet edhe për shkollat darulmuallimin, darulmuallimat, në të cilat përgatiteshin mësues për shkollat e niveleve të ulëta. Vend të veçantë në ditar zënë edhe çështjet që kanë të bëjnë me mësuesit, si përçues të sistemit arsimor që kërkohej të zbatohet në vilajet asokohe. Kështu, në ditar gjenden të dhëna në lidhje me shkallët e mësuesve, të cilat caktoheshin në varësi të shkollës ku do të punonin, përmenden emrat e tyre, puna për inspektimin e njohurive, detyrat që kryenin, rrogat që merrnin për punën e bërë, ankesat që drejtoheshin si nga instanca administrative ashtu edhe nga masat popullore në lidhje me punën e tyre, mësuesit që patën dhënë dorëheqje, arsyet e këtyre dorëheqjeve, si dhe emrat e mësuesve që kanë vdekur në moshë të shtyrë.

Përveç ambienteve dhe trupës mësimore, rëndësi të veçantë kishin edhe programet mësimore e librat shkollorë, me të cilët realizohej mësimi nëpër shkollat e niveleve të ndryshme. Të dhënat që përmban ditarin në lidhje me këtë pikë mund të grupohen në titujt e librave dhe të traktateve që i qenë dërguar vilajetit të Shkodrës, si dhe në kërkesat që kishte vilajeti në fjalë për bazë materiale, dhe po ashtu në lista të librave shkollorë dhe edukativë.

Tema të veçanta përbëjnë edhe çështja e arsimit të vajzave gjatë kësaj periudhe, shkollat private që qenë hapur në vilajetin e Shkodrës, kryesisht nga të huajt dhe jomyslimanët, çështja e arsimit në gjuhën shqipe, rastet e shumta të rrethprerjeve (synetlleqeve) që mbuloheshin me fonde të veçanta nga buxheti shtetëror, si dhe xhamitë dhe mesxhidet që përmenden si objekte ku zhvillohej arsimimi.

Nisur nga këto të dhëna, besojmë se botimi shkencor i ditarit të Daut Boriçit, i transkriptuar me aq profesionalizëm nga ana e mag. Ali Bardhit, do të na shërbejë për të pasuruar të dhënat në lidhje me arsimin në Shqipërinë Veriore të gjysmës së dytë të shek. XIX.



Profeti a.s. dhe nipërit e tij

Profeti (a.s.) gjatë gjithë historisë së jetës së tij ka treguar interes, përkujdesje dhe përkushtim të veçantë ndaj fëmijëve, dëshirave të tyre, kërkesave shpirtërore dhe trupore, duke mos anashkalluar për asnjë moment rëndësinë e fëmijëve; madje mund të themi se në këtë aspekt, Profeti (a.s.) nuk ka bërë dallime mes fëmijëve myslimanë dhe jo myslimanë. Ashtu sikurse në çdo rast edhe këtu Profeti (a.s.) është treguar shembulli më i mirë se si duhet të sillemi si baba apo si gjysh.

Nipërit e Profetit (a.s.) veçanërisht Hasani dhe Hysejmi kanë kaluar një fëmijëri tejet të gëzueshme pranë Profetit (a.s.). Kur Ai (a.s.) ndërroi jetë, ato ishin akoma të vegjël, përkatësisht Hasani 7.5 dhe Hysejmi 6.5 vjeç, mosha më e bukur e lodrave dhe fëmijërisë.

Pejgamberi (a.s.) i ka bërë synet Hasanin dhe Hysejmin në ditën e shtatë të lindjes së tyre dhe më pas ka shtruar gosti. Pejgamberi (a.s.) shpesh e tregon dashurinë ndaj nipërve duke kaluar kohë me ta, duke i dashur e përqafuar, puthur e ledhatuar. Një ditë, një sahabi i quajtur Akra b. Habis ndërsa shikon Profetin (a.s.) duke puthur Hasanin e pyet:

- A i puthni ju fëmijët? Unë kam dhjetë fëmijë, por asnjërin nuk e puth.

Profeti (a.s.) i përgjigjet:

"Ai, i cili nuk mëshiron, nuk do të mëshirohet."
(Buhari, Edeb, 18)

Profeti (a.s.) i përgjigjej të gjitha kërkesave të fëmijëve, veçanërisht kur bëhej fjalë për kërkesa që atyre i dukeshin të rëndësishme, fjala vjen, Ai (a.s.) luante me fëmijët, i mbante në shpinë dhe i shëtiste.

Pejgamberi (a.s.) këtë lidhje me fëmijët nuk e dëmtonte madje edhe kur ishte duke kryer adhurimet.

Një ditë, kur Profeti (a.s.) dëgjon Hasanin duke qarë, nuk duron dhe i drejtohet Hz. Fatimes:

-A nuk e di se unë mërzitem kur e dëgjoj duke qarë?

Profeti (a.s.) i bënte dhurata nipërve, sepse dhurata është një mënyrë për të shprehur dhe konsoliduar më tej dashurinë ndaj çdo njeriu.

Një ditë, Ai (a.s.) vjen në shtëpi me një gjerdan duke thënë: "Këtë do ia jap atij që dua më shumë". Të gjithë menduan se do ja jepte Hz. Aishes, por në fakt ia dha Lubabes, vajzës së Hz. Zejnebit.

Ai (a.s.) nuk bënte dallime mes nipërve të tij, ndante kohë për ta, i kushtonte rëndësi duke u munduar të përmbushte sa më tepër kërkesat e tyre.

Gruaja shembullore



Tregon Ebu Hurejra (Zoti qoftë i kënaqur me të): “Erdhi Xhibrili te Pejgamberi (paqja e Allahut qoftë mbi të) dhe i tha: -O i Dërguari i Allahut! Do të të vijë Hatixhja duke mbajtur një enë me pije ose me ushqim. Kur të vijë përcillja përshëndetjen me selam nga Zoti i saj i Gjithëfuqishëm dhe nga unë, dhe jepi myxhden për një shtëpi nga margaritarët në xhenet ku nuk do të ketë zhurmë e as lodhje.” Zonja Hatixhe (Zoti qoftë i kënaqur me të), gruaja e parë e Pejgamberit (paqja e Allahut qoftë mbi të), ishte nga gratë më të mençura kurejshite dhe nga më të moralshmet. Ajo zgjodhi të martohet me Pejgamberin para se t’i shpallej nga Zoti, ngaqë tek ai pa besnikërinë dhe moralin e mirë. Ajo e parapëlqeu atë ndaj arabëve të njohur të cilët e kërkonin dorën asaj. Zonja Hatixhe i jepte kurajo Pejgamberit pasi atij iu shpall feja nga Zoti dhe i jepte guxim e trimëri të qëndrojnë dhe të vazhdojnë të përhapë flamurin islam. Gjithë pasurinë e saj ia la në duar atij, ashtu siç duhet të bëjë gruaja e mirë me burrin e mirë. Historia na rrëfen se Sherih El-Kadi një ditë e takoi Esh-Shabiun. Esh-Shabiu e pyeti atë për gjendjen në shtëpinë e tij.

Sherihu iu përgjigj:

- Për rreth njëzet vjet te gruaja ime nuk kam parë asgjë që më zemëron.

Ai e pyeti:

- Po si kështu?

Sherihu iu përgjigj:

- Që natën e parë kur hyra në dhomë me të, pashë tek ajo mirësi magjepëse dhe bukuri të rrallë. Mendova me vete: Do të pastrohem dhe do të fal dy rekate si falënderim për Allahun. Pasi përfundova namazin pashë gruan time tek po e përfundonte namazin që e kishte falur me mua.

Pastaj vazhdoi:

- Lavdëruar qoftë Allahu! E lavdëroj dhe nga Ai ndihmë kërkoj. Përshëndes Muhamedin, shokët dhe familjen e tij! Unë jam grua e huaj dhe nuk di për moralin, karakterin tënd. Më thuaj, pra çfarë do dhe ta bëj atë dhe çfarë nuk të pëlqen t’i iki asaj... Dhe më në fund kërkoj falje nga Allahu.

Pastaj vazhdova unë:

- Lavdëroj Allahun dhe nga Ai ndihmë kërkoj. Përshëndes Pejgamberin dhe familjen e tij. Vërtet, ti ke folur fjalë që në qoftë se janë të vërteta do të jenë në të mirën tënde, e nëse shtresh do të jenë argument kundër teje. Më pëlqen kjo dhe e urrej këtë dhe këtë. Çfarëdo të mirë që e sheh përhapë, dhe çfarëdo të keqe që e sheh fshihe!

Pastaj tha:

- Cilët fqinj dëshiron të hyjnë në shtëpinë tënde që t’u jap leje, e cilët i urren t’i urrej edhe unë.

Me të kalova natën më të mirë dhe jetova kohën në të cilën nuk pashë tjetër veç asaj që më pëlqen.



Zvicër, lind makina UC e karikueshme në tren

Në Zvicër ka marrë jetë një projekt për makinat qytetëse të së ardhmes. Ato mund të karikohen brenda një vagoni treni dhe mund të përshkojnë distanca të vogla brenda qytetit. Makina UC e ngjashme me Smart-in dhe me format e Fiat 500, ka dy vende dhe mund të futet në një vagon treni për t'u karikuar me energji.

Ideja për të integruar transportin publik me atë individual duhet të shërbejë vetëm për lëvizjet e shkurt-ra urbane, pasi për të mbuluar distancat e mëdha do vazhdojnë të shërbejnë trenat. Vendi për automjetin e gjatë 2.7 metra mund të prenotohet me anë të internetit dhe ndërsa udhëtoni në tren duke përshkuar distanca të mëdha, me të mbërritur në destinacion, mund të hiqni makinën nga karikimi, njëlloj si një celular, për ta përdorur në rrugët e ngushta dhe me trafik.



Bateritë e makinës garantojnë një shpejtësi deri në 120 km/h. Projektuesi i kësaj makine është Frank Rinderknecht, ndërsa prezantimi i saj është bërë në Sal-lonin e Gjenevës.

Photoshop mbush 20 vjet



Kur në botën e teknologjive komunikuese e informuese i mbijetoni njëzet vite dhe ende jeni më relevanti në fushën tuaj, kjo nuk është gjë e vogël. Është fjala për Adobe Photoshopin, softuerit më të mirë për përpunimin e fotografive i cili tani i ka mbushur 20 vjet.

Edhe ata të cilët nuk e kanë përdorë Photoshopin kurrë, sigurisht kanë dëgjuar për këtë softuer; të gjithë ato fotografitë e bukurosheve, të cilat i shihni në revista, edhe atyre që i shihni në Telegraf, sigurisht

kanë kaluar nëpër duart e ndonjë mjeshtri të Photoshopit, i cili ua ka përmirësuar flokët e thinjura, ua ka hequr celulitin, dhe mbi të gjitha e ka bërë fotografinë më të mirë për tu parë.

Për profesionistët e uebit dhe ata të cilët merren me fotografinë digjitale Photoshop megjithatë është një softuer i cili nuk mund të anashkalohej. Për të gjithë ata Photoshop sot do të organizojë manifestime të shumta në mbarë botën dhe do t'i bëjë bashkëprogramuesit më të rëndësishëm të cilët kanë punuar gjatë viteve në të.

Panik i shfrytëzimit të memories nga Windows 7

Kohë më parë janë paraqitur informata se kompjuterët me Windows 7 kanë shumë pak memorie kur merret parasysh se 86% e kompjuterëve me Windows 7 shfrytëzojnë prej 90 deri në 95 për qind të memories së tyre fizike.

Craig Barth, drejtor ekzekutiv i Devil Mountain Software, kompanisë e cila qëndron prapa zhvillimit të softuerëve për përcjelljen e performancave, ka paraqitur të dhënat e publikuara në raportin e komunitetit XPnet të kompanisë së tyre.

Anëtarët e këtij komuniteti shfrytëzojnë mekanizma pa pagesë për ngarkimin periodik të performancave mbi të dhënat e serverëve të XPnet nga dhjetëra mijëra kompjuterë të cilët vërtetojnë të dhënat e po-



huara. Rezultatet e publikuara pas testimeve të bëra kanë treguar se bëhet fjalë për diçka që do të mund të sillte deri tek disa probleme të mëdha si për sistemin operativ Windows 7 e po ashtu edhe për kompjuterët tanë.

Unazat e Saturnit, vërtetohet përbërja

Unazat e Saturnit nuk mund të konsiderohen më një mister për shkencën që ka arritur të zbulojë përbërjen e tyre.

Ujë në gjendje të ngrirë, ky është përbërësi kryesor i unazave që për sytë e teleskopëve janë një magji e vërtetë. Sipas një studimi italo-amerikan të publikuar në "Science", pamjet e marra nga sonda Cassini, ndërtjnë shkencërisht strukturën përbërëse të unazave.

Rrathët kryesorë A dhe B janë ndërtuar 95 % nga uji në gjendje të akullt, ndërsa unaza C nga shumicë karboni. Ngjyra e unazave dominohet nga bluja në të bardhë, ç'ka tregon qartë praninë e ujit në gjendje të akullt.

Unazat e Saturnit kanë qenë përherë objekt studimi nga ana e shkencëtarëve ndër shekuj, pasi përveç veçorisë që i japin Saturnit si planet, kanë ngjallur edhe një kureshtje të madhe.





Peshku mbron diabetikët nga dëmtimet në veshka

Nëse diabetikët konsumojnë peshk, ato mbrohen nga dëmtimet në veshka, që janë shpesh sëmundje që bashkëshoqërojnë diabetin, sidomos atë tipit II. Të paktën ky është konkluzioni i një studimi të publikuar në revistën amerikane “American journal of kidney disease”. Në një studim të realizuar në Kembrixh, Angli, është marrë një kampion prej mbi 22 mijë vullnetarëve, nga të cilët 517 prej tyre vuanin nga diabeti. Vullnetarëve u është kërkuar të shpjegojnë menynë e tyre dhe u pa se konsumimi i peshkut kishte efekte pozitive dhe se ishte e nevojshme që diabetikët të konsumonin të paktën dy racione peshk në javë. Ndër pacientët që ndiqnin këtë regjim dietetik, prej dy racionesh dhe më tepër peshk në javë, studiuesit kanë vërejtur praninë e më pak proteinave në urinë, një kusht që quhet “makroalbuminuria”, që është shenjë e dëmtimeve në veshka. Vetëm 8% e



tyre kanë shfaqur këtë gjendje, ndërsa pjesa tjetër e diabetikëve që konsumonin më pak peshk, kishin një rrezik prej 18% për të shfaqur “makroalbuminurin”.

Në Japoni shpikët kontrolluesi i cilësisë së gjumit

Në Japoni vjen një shpikje e re që quhet “sleep scan”. Kjo risi kontrollon dhe vlerëson cilësinë e gjumit, ndërsa nxjerr në pah anomalitë e tij. Një minitapet ultra-teknologjik i pajisur me censored brendshëm vendoset në shtrat. Gjatë gjumit këta censored regjistrojnë disa të dhëna, mes të cilave edhe të rrahurat e zemrës, lëvizjet e trupit të cilat konvertohen me imazhe në një kartë memorie. Pikërisht këto të dhëna shfrytëzohen për të marrë anomalitë gjatë gjumit të njeriut.



Diskutimet e thella të bëjnë më të lumtur

Lajme të këqija për të pasionuarit e thashe-themeve. Të bësh biseda më të thella dhe dome-thënëse të bën më të lumtur, ndërsa të flasësh vetëm për tema të lehta, ka efektin e kundërt.

Përfundimin e ka nxjerrë një studim amerikan

i kryer nga kërkuesit e Washington University të St. Louis, i publikuar në “Journal of Psychological Sciences”. Një çelës tjetër, tregues i lumturisë së një njeriu është edhe koha që ai kalon vetëm. Studimi ka zgjatur 4 ditë dhe ka monitoruar 79 të rinj, të gjithë studentë të kolegjit.

Molla, sekreti i vitalitetit të njeriut

Përveç se pastron dhëmbët në mënyrë të përkryer, parandalon plakjen e lëkurës, heq urinë, mund të parandalojë disa sëmundje, përfshirë këtu edhe tumorin. Këtë zbulim e ka bërë një institut italian që thekson se konsumimi i mesatarisht dy mollëve në ditë, është ideal. Në botë ekzistojnë rreth 8 mijë lloje mollësh, por 15 të parat, nga renetta dhe deri tek golden delicious e Fuji, përfaqësojnë 90 % të tregut botëror. Kili është vendi që eksporton më shumë mollë në botë, ndërsa në Europë, tre prodhuesit më të mëdhenj janë Italia, Franca e Holanda.



Kujtesë më të fortë? Shkoni me pushime



Kur jemi duke pushuar, mendimet memorizohen më mirë në kujtesë pasi neuronet funksionojnë në mënyrë më të lirshme kur ndizen në sinkron dhe kjo ndodh kur në tru kalojnë disa valë celebrale tipike gjatë gjendjes së pushimit.

“Max Planck Institute for Brain Research” në Frankfurt me në krye Erin Schuman ka kryer studimin e publikuar në “Nature”.

Dihej edhe më parë që gjendja e qetë e trurit ndikonte në memorizim më të shëndoshë, por nuk ishte zbuluar se cilit mekanizëm i dedikohej ky avantazh.

Tronditet Polonia, *Presidenti e shumë shtetarë, viktima të një aksidenti ajror*

Presidenti i Polonisë, Lech Kaczynski, bashkëshortja e tij, guvernatori i Bankës Qendrore të Polonisë, shefi i ushtrisë dhe shumë zyrtarë të lartë të vendit kanë mbetur të vrarë pas përplasjes së avionit me të cilin udhëtonin. Ishte një përplasje që ndodhi në një fushë me mjegull, në afërsi të një aeroporti rus, që ka marrë jetën e 97 personave që ndodheshin në bord. Kryeministri polak, Donald Tusk, e ka konsideruar këtë përplasje fatale, si “ngjarja më tragjike që ka përjetuar Polonia që pas Luftës së Dytë Botërore”.

Vdekja e Presidentit, i cili qeverisi Poloninë për një periudhë kohe së bashku me vëllanë binjak, sjell një paqartësi politike në vend. Zgjedhjet e ardhshme presidenciale ishin parashikuar të mbaheshin në tetor, por pas kësaj humbjeje ato do të zhvillohen brenda një periudhe dymujore, sipas Kushtetutës. Gruaja e Presidentit dhe disa zyrtarë të lartë të qeverisë ishin gjithashtu në bordin e “Tupolev Tu-154”, i cili u përplas në një pyll rreth dy kilometra larg qytetit perëndimor rus të Smolenskut.

Sipas një zëdhënësi të qeverisë vendore të qytetit, piloti i avionit dhe gabimi i tij ishin përgjegjës të përplasjes. Në vendin ku është shembur avioni, pas tragjedisë kanë shkuar menjëherë shumë njerëz, ndërkohë që të shumtë kanë qenë edhe polakët e grumbulluar para pallatit presidencial në Varshavë.

Vdekja e Presidentit polak, së bashku me shumë zyrtarë të lartë të vendit dhe të partisë, e ka ndryshuar krejtësisht natyrën e politikës polake. “Pasojat politike do të jenë afatgjata dhe do të ndryshojnë të gjithë peisazhin e politikës së vendit”, deklaroi një analist politik dhe njohës i mirë i politikës së vendit. Në Poloni, ndërsa roli i Presidentit është kryesisht simbolik, ai mund të vendosë vetëm për sa i përket miratimit të ligjeve dhe të bllokojë nisma të ndryshme ligjore.

Kryetari i Dhomës së Ulët të Parlamentit, Komorowski, është emëruar menjëherë Presidenti i



Polonisë, në vend të të ndjerit që humbi jetën mëngjesin e së shtunës, në tokën ruse. Kryetari është gjithashtu kandidat presidencial për zgjedhjet e ardhshme, data e zhvillimit të cilave është afruar me dy muaj.

Ndërkaq, televizioni rus ka shfaqur zonën në të cilën ndodhi përplasia dhe pamjet e avionit tërësisht të shkatërruar e djegur. Avioni ishte një nga dy “Tupolev TU-154” të flotës së qeverisë polake, por bëhet fjalë për avionë që, edhe pse kanë qenë të mirë, ishin të vjetër, me rreth 20 vjet fluturime. Zyrtarët e qeverisë, prej kohësh ankoheshin në lidhje me vjetërsinë e tyre dhe faktin që kjo mund t’i bënte të rrezikshëm. Sipas burimeve të Ministrisë së Brendshme ruse, në bordin e avionit ndodheshin 97 persona, përfshi 88 anëtarë të delegacionit polak që kishte shkuar në Rusi, për të përkujtuar polakët që u vranë masivisht nga Stalini, në vitin 1940. Një zyrtar i një misioni kontrolli rus bëri të ditur se piloti ishte njoftuar për të mos u ulur në aeroportin e afërt, por të fluturonte në Moskë, apo në Minsk, për shkak të kushteve të këqija atmosferike, por piloti nuk kishte dëgjuar ta ndiqte këtë këshillë.

Ministri polak i Drejtësisë tha se ai do të drejtonte një hetim të posaçëm të përplasjes së avionit, në të cilin humbën jetën dhjetra persona. Edhe Presidenti rus, Medvedev, dhe Kryeministri Putin, do të ndërmarrin hetime dhe do të bashkëpunojnë edhe me drejtësinë polake.

Ndër viktimat më të rëndësishme për nga posti, që

ndodheshin në avion, ishte dhe guvernatori i Bankës Qendrore të Polonisë, 47 vjeç, i cili ishte në këtë detyrë që nga viti 2007, shefi i ushtrisë polake dhe zëvendësministri i Jashtëm. Në bordin e avionit ndodheshin edhe disa nga familjarët e viktimave të masakrës së Stalinit, që shoqëronin delegacionin e lartë qeveritar, që ndodhej në një vizitë në Rusi.

Maqedoni, propozohet që zv. presidenti të jetë shqiptar

Liderët e partive politike të shqiptarëve duhet ta shfrytëzojnë momentin e hapjes së procesit të ndryshimeve kushtetuese që të kërkojnë ndryshime thelbësore që kanë të bëjnë me rregullimin e statusit të shqiptarëve në Maqedoni. Këtë e sugjerojnë ekspertët shqiptarë për takimin e radhës të liderve të partive më relevante politike në Maqedoni, i cili është paralajmëruar të mbahet në fund të javës. Lideri i VMRO-DPMNE-së, Nikola Gruevski, i BDI-së, Ali Ahmeti, i Demokracisë së Re, Imer Selmani, dhe lideri i opozitës maqedonase, Branko Cërvenkovski, njoftohet se në takimin e radhës do të mundohen t'i harmonizojnë qëndrimet e tyre rreth ndryshimeve kushtetuese në sferën e gjyqësorit. Profesori i së drejtës kushtetuese, Osman Kadriu, thotë se duhet të ndërhyhet edhe në Ligjin për përdorimin e simboleve kombëtare, si dhe në atë të përdorimit të gjuhës shqipe. “Në këto momente kur po hapet çështja e ndryshimeve kushtetuese partitë politike shqiptare duhet të kërkojnë ndryshime në çështjet që i prekin shqiptarët. Patjetër duhet të kristalizohet çështja e përdorimit të flamurit shqiptar, pasi Kushtetuta e tanishme nuk i ka dispozitat shumë të qarta rreth përdorimit të tij. Kushtetuta nuk është e qartë se si mund të përdoret flamuri kombëtar, para cilave institucione dhe në cilat festa”, deklaroi Kadriu.

Profesori Jeton Shasivatri është i mendimit se duhet ndryshuar krejtësisht Kushtetuta e Maqedonisë dhe të rishqyrtohet statusi i shqiptarëve. “Mendoj se tërësisht Kushtetuta e Maqedonisë duhet të zëvendësohet me një Kushtetutë të re. Kushtetuta duhet të ndryshojë në të gjitha aspektet, duke filluar nga statusi i shqiptarëve, përdorimi i simboleve përfshirë edhe të



drejtën e Badenterit për të gjitha çështjet që i prekin shqiptarët”, thotë Shasivatri. Sipas tij, këto ndryshime janë vetëm kozmetike, të cilat aspak nuk do ta ndryshojnë pasqyrën për gjykatat e vendit.

Propozues i ndryshimeve kushtetuese është qeveria e Maqedonisë, ndërsa me të synohet në pavarësimin e gjykatave, respektivisht mënjanimi i ndikimeve politike ndaj pushtetit gjyqësor. Ndryshimet e reja thuhet të bëhen për shkak të presioneve të faktorit ndërkombëtar, me ç'rast parashihet që ministri i Drejtësisë të mos jetë anëtar i Këshillit Gjyqësor, të zvogëlohet mandati i gjykatësve dhe të rritet numri i anëtarëve në KRGJ nga radhët e gjykatësve.

Irani do të zhvillojë një takim të nivelit të lartë për armët bërthamore

Irani njoftoi se do të mbajë takimin e tij ndërkombëtar të nivelit të lartë vetëm disa ditë pas takimit të nivelit të lartë në Uashington, të organizuar nga Shtetet e Bashkuara.

Ministri i Jashtëm i Iranit, Ramin Mehman Parast, njoftoi se Teherani do të mbajë të shtunën e ardhshme një takim dy ditor të nivelit të lartë. Media shtetërore njoftoi se në takim do të marrin pjesë përfaqësues nga 60 vende.

Zëdhënësi tha se Teherani do të hapë një rrugë të re për pastrimin e botës nga armët bërthamore. Shtetet e Bashkuara do të presin udhëheqës nga 47 vende gjatë takimit dy ditor të nivelit të lartë që është caktuar të hapet të hënën.

Presidenti i Iranit, Mahmud Ahmadinexhad shpalli prodhimin e një tipi të ri centrifugësh që mund të pasurojë uraniumin gjashtë herë më shpejt se sa tipet e



vjetra të centrifugëve.

Në Uashington, zëdhënësi i Departamentit të Shtetit Crowley tha se Shtetet e Bashkuara kanë arritur në konkluzionin se Irani ka “qëllime armiqësore” me aktivitetet e tij bërthamore, pasi një program bërthamor me synime paqësore nuk ka nevojë për centrifugë më të shpejtë.

Netanjahu i bën bisht takimit ndërkombëtar për armët bërthamore

Kryeministri hebre, Netanjahu është tërhequr nga takimi për sigurinë bërthamore që do të mbahet në Uashington javës që vjen, duke iu druajtur faktit të mundshëm se delegatët myslimanë mund t’i kërkojnë Izraelit të heqë dorë nga arsenalin e tij bërthamor. Netanjahu, që ka vendosur të dërgojë zëvendësin e tij në konferencën e 12-13 prillit, e cila do të zhvillohet në Uashington, ka hequr dorë nga pjesëmarrja kur ka marrë vesh se disa vende, mes të cilave Egjipti dhe Turqia, po planifikojnë që të këmbëngulin për këtë në lidhje me Izraelin, duke nënshkruar traktatin e armëve joproliferike. Duke qendruar jashtë kësaj marrëveshjeje të vitit 1970, Izraeli nuk detyrohet të heqë dorë nga arsenalin bërthamor apo nga mundësia e krijimit të inspektorëve ndërkombëtarë për të inspektuar reaktorin e Dimonës. Sipas ekspertëve, ky reaktor ka prodhuar deri tani 80 deri në 100 mbushje bërthamore.

Pjesëmarrja e Netanjahut në takimin në të cilin do të

merrnin pjesë 47 vende, do të kishte qenë e paprecedent. Në fakt, kryeministrat hebrenj u janë shmangur gjithmonë konferencave të tilla apo forumeve për situatën bërthamore në botë, duke shpresuar t’i mbajnë jashtë vëmendjes së të huajve sekretet e tyre bërthamore. Ndërkohë, marrëdhëniet mes Shteteve të Bashkuara dhe Izraelit janë përkeqësuar kohët e fundit pas një sërë incidentesh që kanë ndodhur mes tyre në përpjekjet e amerikanëve për të gjeneruar bisedimet e paqes. Edhe herën e fundit që Netanjahu ishte në Shtetet e Bashkuara ka pasur një takim shumë të tensionuar me Presidentin amerikan Obama në lidhje me planin për të vazhduar ndërtimet në Jerusalemin Lindor. Vetë Obama nuk kishte planifikuar ndonjë takim me Netanjahun gjatë konferencës. Për sa i përket një burimi zyrtar të Egjiptit, delegacioni i këtij vendi deklaroi se nuk kishte ndër mend që të bënte ndonjë kërkesë si ajo që pretendon Netanjahu dhe ky i fundit u akuzua për shmangie të diskutimit të çështjes palestineze.



N.T.P. MAHMUT-HOLDING

Samettin Taç - Nazim Taç

Dewilux®
SPECIALIST IN PAINT
NGJYRA DHE LLAQE E SPECIALIZUAR

**NGJYRNA - LLAQE - PJESE TË MOBILAVE DHE MEDIJAPAN
BOYA - VERNIK - MOBILYA AKSESUARI VE MEDIJAPAN**

- ➔ SAMET LLAGERA PËR FIOKA
- ➔ MEDIJAPAN
- ➔ KËND MALLTERIT
- ➔ KËND ME RRJET
- ➔ KËNDE KNAUFIT NGA ALUMINI
- ➔ RRJETA PËR FASADË



YapoS



Lagja Arbanë Prizren
mahmut_holding@hotmail.com

Mob: +377 044 242 468
+377 044 230 751
+377 044 339 452
+377 044 390 538
Turk/Mob: +90 537 887 1210



BRENDSHME DHE
TE JASHTME
INTERIOR &
EXTERIOR



BOJRA AMERIKANE

Adresat: Kompleksi Bexhisteni, në Rus / Shkodër, Koplik,
Lezhë, Tiranë, së shpejti edhe në Kosovë
Mobil: +355 67 2288016 email: ethnic12alb85@yahoo.com

**Firma ILIRIA sh.p.k.
me qendër në Shkodër**

Pajisje për ambjente lokale
Prodhim dyer e dritare
Dhoma fëmijësh, Pajisje kuzhine
Pajisje zyrash, Dhoma gjumi

Mobil: 00355 (0) 69 2523565



KAMA
PRIZREN



Tel: 029 242 132 / Mob: 044/049 280 502
Rr. Sheshi i Lidhjes nr. 7 / E-mail: kamaciciban@hotmail.com

ORDINANCA SPECIALISTIKE GJINEKOLOGJIKE

"GJENEZA"

Dr. Bleta Baruti Domi
Gjinekologe - Obstetër



Rr. "M. Frashëri" nr. 82 GJAKOVË
(përballë Medresës Madhe - Rr. e Çabratit)
Tel. 044 253 604; 0390 329 404
email: bleta_gyn@hotmail.com

*Këtu mund të ishte
reklama juaj!*



Office: Tel. ++381 (0) 390/324 026
Fax: ++381 (0) 390/324 135
Mob: +377 (0) 44/134 498
Mob: +386 (0) 49/134 498
Mob: +377 (0) 44/204 150
Mob: +386 (0) 49/204 150
e-mail: info@wearandgojeans.com
wearandgojeans@hotmail.com
www.wearandgojeans.com
Rr./Str. "Skenderbeu" p.n. n.n
Gjakovë - Kosovë

WEAR & GO
Jeanswear Company

Prodhojmë të gjitha llojet e
veshjeve të jashtme nga Tekstili !!!

*Këtu mund të ishte
reklama juaj!*

*Këtu mund të ishte
reklama juaj!*

ORARI I PUNES
ÇDO DITË
09 - 22

cct Ramstore

Palma Tradë

Palma Tradë

Caffe - Pizza & Restaurant
EMPORIUM

Exclusive
CERTIFIED

Ramstore

Kids
Club

MIK
FASHION STYLE

Vasidora ATHENS

BEAUTY
SHOP


JYSK
BED · BATH · HOME

Actual Club

BRAND OF AMERICA
BIG STAR

info: 044 343 790 Tetovë • www.palma.com.mk • www.cct.com.mk

PROGRESI
BOTIME



Adresa Shqipëri

L: Vasil Shanto / Rr: Çajupi / Shkodër

Tel: +355 69 20 76768 / +355 67 20 86767

e-mail: revistaetika@progresibotime.com

Adresa Kosovë

Ardian Zurnaciu / Marash / Prizren

Tel: +377 44 337582

e-mail: kosova@progresibotime.com



N.P. "LUX DEKOR" - Prizren

NRB: 80249179, adresa: rr. Tirana p.n. (zona industriale ish - Voqare)
e-mail: luxdekor4@hotmail.com, tel/fax.: + 381 29 242 174, mob.: (vula + 377)&(lpko + 386) 198 709, 141 253



prodhues i KUZHINAVE



regallave, dhoma të fjetjes, komod



paradhoma dhe të gjitha llojet e orendive shtëpiake dhe zyrtare



prodhues i KUZHINAVE

Lux Dekor është firmë private e specializuar për prodhimin e KUZHINAVE si dhe orendive të ndryshme shtëpiake dhe të zyrtare, bën shitjen e materialit - iverëplaka, mdf, folje për vakumpress, dhe të aksesuarëve përcjellëse për mobiljeri. Bën prodhimin e balloreve - mveshjen me ultrplast - Laminat, si dhe plastifikimin VAKUMPRES - BALLONPRESS të balloreve me folje të pvc-se në dimensione të kerkuara nga KLIENTI, GRAVIRIMIN e fronteve me makinë CNC, kandimin - qitjen e shiritëve pvc dhe abs, prerjen e pllakave, të gjitha keto kryhen me makina të persosur kualitet dhe cilësi të lart.



Industria Ushqimore
"ABI & ELIF 19"
Zona Industriale rr. Tirana nr. 9.
20000 Prizren, Kosovë
tel&fax: +38129242433
tel&fax: +38129222322
tel&fax: +38129244005
e-mail: info@abielif19.com
<http://www.abielif19.com>

